



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Programi i Studimit të Ciklit të Parë

Bachelor në “Inxhinieri Mekatronike”

ofruar nga

Universiteti Privat “Albanian University”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Dr. Gazment Qatipi

Dr. Eli Vyshka

Shkurt/2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
Bachelor në “Inxhinieri Mekatronike”

1	IAL aplikues:	Albanian University
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Inxhinierive (Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Inxhinieri Mekatronike”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 488, datë 04/10/2011
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Shkresë MASR nr. 3784/2 prot, datë 06.06.2019 (Vendim Senati nr. 10, datë 20.03.2019)
6	Regjistrimi i Formës e së diplomës:	Urdhër i QSHA nr. 276, datë 09.06.2021
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Vendim BA Nr. 38, datë 12.03.2021, me kohëzgjatje 3 vite akademike, i vlefshëm deri më 30.09.2024.
8	Cikli i studimit:	Cikli i Parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kresite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit	Për vitin akademik 2023-2024: 18 PAE/10 PAK
18	Numri i studentëve	Student te regjistruar per vitin 2023-2024: 29
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Mekatronike" që ofrohet nga Departamenti i Inxhinierive, pjesë organike e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike është licencuar me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 488, datë 04/10/2011. Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Mekatronike", është program studimi i ciklit të parë ka në total 180 kredite dhe i përket nivelit të 6^{të} të kualifikimit sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimit.

Akreditimi i parë i këtij programi studimi është bërë me Vendim të Bordit të Akreditimit nr. 51, datë 10/07/2017.


Kohëzgjatja normale e studimeve është 3 vite, forma e studimit është me kohë të plotë dhe gjuha zyrtare e studimeve është gjuha shqip.

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike përbëhet nga 3 departamente:

- 1) Departamenti i Inxhinierive (përgjegjës për programin Bsc në Inxhinieri Mekatronike)
- 2) Departamenti i Art Dizajn
- 3) Departamenti i Shkencave Ekonomike

Sipas rregullores së PS, Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Mekatronike" ka për qëllim të hedhë bazat shkencore dhe përgatitjen teoriko - praktike të nevojshme për ushtrimin e profesionit si inxhinier në fushën e mekatronikës, i cili do të kontribuojë në drejtim të mirëmbajtjes apo të prodhimit të sistemeve të thjeshta mekatronike. Kjo përgatitje e përgjithshme gjatë periudhës trevjeçare u krijon mundësinë studentëve të integrohen në tregun e punës dhe gjithashtu, formon bazat e nevojshme për të thelluar studimet dhe për të përfituar kompetenca më specifike mbi tema më të profilizuara që mund të trajtohen gjatë studimeve të specializuara.

Rregullorja e programit të studimit është miratuar në Senat në 2019.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Vlerësimi i jashtëm i këtij programi studimi është përgatitur nga një grup ekspertësh të kontratuar nga ASCAL. Për hartimin e raportit, veç Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (më tej RVB), dokumentave mbështetës të sjella nga IAL "Albanian University" në Dosjen e Vetëvlerësimit (DVV), grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) u bazua edhe në vizitën dy ditore që ai kreu në institucion në datat 24-25 Tetor 2024. Gjithashtu ai mori në shqyrtim edhe dokumenta të tjera dhe informacion të nxjerrë nga takimet dhe intervistat që u kryen gjatë vizitës në institucion, si për shembull me drejtues të departamentit, personelin akademik dhe studentët, përfaqësues të Zyrës së Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, së Sekretarisë, Bibliotekës, etj.

Në bazë të Raportit të vlerësimit të jashtëm janë: Ligji nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", disa elementë të Ligjit për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve nr. 10247/2010, Standardet e Cilësisë të aprovuara në Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë miratuar me Vendim nr. 824, datë 24.12.2021 të Këshillit të Ministrave (sipas shtojcës nr. 3 që i bashkëlidhet këtij vendimi për standardet shtetërore për sigurimin e cilësisë për programet e studimit Bachelor), si dhe aktet ligjore e nënligjore përkatëse.

Metodologjia e ndjekur për shkrimin e këtij raporti është analizimi i dokumentave të sjella nga AU në DVV, dhe informacioni i marrë gjatë vizitës në vend. Vlerësimi i programit u përqëndrua në analizën e përmbajtjes së kurrikulës dhe lëndëve, shpërndarjes së krediteve dhe orëve, literaturës që përdoret, përshtatshmërisë së personelit akademik për lëndët që mbulojnë, sigurimit të cilësisë, etj. Koordinator teknik i ASCAL gjatë procesit të vlerësimit të jashtëm është Rajna Lila.

Universiteti Privat "Albanian University" është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm periodik të programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri Mekanike", përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 4/4 Prot, datë 07.02.2025. AU kthen përgjigje dhe komentet për draft RVJ në ASCAL më datë 13.02.2025, me anë të shkresës me Nr.77/1 Prot, datë 13.02.2025 "Kthim përgjigje shkresës nr.4/4, datë 07.02.2025".

Ekspertët e vlerësimit u njohën me komentin dhe japin argumentat si më poshtë:

Komenti i përket rubrikës SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT, ku AU sqaron se: "Institucioni ka zgjeruar jo vetëm metodat e tërthorta për vlerësimin e cilësisë, ashtu sic është cituar edhe në vlerësimin e GVJ-së, por duhet theksuar edhe metodat e drejtëpërdrejta, bazuar kjo edhe në rregulloren e njesisë së SBC, neni 8, (Evidencë nr.6.10, cituar në RVB), përkatësisht:

- Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (psh provimi i shtetit për profesionet e rregulluara);
- Dëgjime në auditor;
- Vlerësimi me nota/pikë

- Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module;
- Vlerësimi i detyrave të studentëve (detyra kursi, për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet);
- Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;

Arsyetimi i AU qëndron, por GVJ është mbështetur në përgjigjen e vetë institucionit në këtë pikë. Raporti në këtë pikë ndryshon në: **GVJ konstaton se ky rekomandim është plotësuar plotësisht.**

Edhe në faqen 90 shtohet ky paragraf.

SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

Akreditim periodik i programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri Mekatronike" është zyrtarizuar me VBA nr. 38, datë 12.03.2021, me kohëzgjatje 3 vite akademike, i vlefshëm deri më 30.09.2024. Në këtë vendim janë lënë 5 rekomandime. IAL ka dërguar në ASCAL një plan veprimin për përmbushjen e tyre me shkresë nr. 391 prot, datë 03.09.2021.

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në VBA nr. 38, datë 12.03.2021, janë:

- Institucioni, të marrë masa për uljen e ngarkesës mësimore në numër orësh dhe lëndësh, të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi.
- Institucioni, të krijojë një fond specifik të dedikuar për kualifikimin e mëtijshëm të personelit akademik, pa tituj dhe grada shkencore.
- Institucioni, të përcaktojë koordinatoren e programit të studimit, i cili do të jetë përgjegjës për zhvillimin e programit dhe të praktikave profesionale.
- Të rrisë numrin e orëve në auditor për leksion dhe seminare, për këtë program studim, duke respektuar kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi.
- Të zgjeroj gamën e metodave të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për vlerësimin e cilësisë me qëllim implementimin sa më të mirë të rezultateve të mësimdhënies për këtë program studimi.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

- Institucioni, të marrë masa për uljen e ngarkesës mësimore në numër orësh dhe lëndësh, të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi.

Përgjigja e Institucionit në RVB

Institucioni ka shprehur gatishmërinë për përmbushjen e këtij rekomandimi, duke shpallur dy herë në vit (në fillim të vitit akademik dhe përpara fillimit të semestrit të dytë) nevojat për staf të ri akademik me tituj dhe grada shkencore, sipas specifikave të çdo programi studimi [Evidencë R.1, R.2]. Kandidatët, të cilët plotësojnë këto kriterë, kanë munguar. Vlen këtu për t'u theksuar edhe pamundësia për dhënien e gradave shkencore dhe titujve akademikë për personelin akademik efektiv, i cili përmbush standardet ligjore, si rezultat i pezullimit të procedurave, në pritje të daljes dhe vënies në zbatim të akteve nënligjore përkatëse.

Në këtë kuadër, Institucioni ka aplikuar për hapjen e një programi të ri, "Doktoratë" në "Standardizimi: Integrimi europian, transferimi i teknologjisë dhe inovacioni" pranë

Departamentit të Inxhinierive (për të cilin së fundmi është marrë përgjigje jo pozitive), dhe është angazhuar në krijimin në nivel institucional të strukturave specifike për dhënien e gradave shkencore dhe titujve akademik, në përputhje me kërkesat e ligjit 80/2015 dhe akteve nënligjore në fuqi.

Vlerësimi i GVJ

Nga përgjigja në RVB, dhe në dokumentacionin e sjellë për procedurat e aplikuara për rekrutim të stafit rezulton se:

- për vitin 2021-2022 - deklarohet 1 vend vakant me gradën Dr. në fushën e Mekatronikës/ Mekanikës dhe nuk është aprovuar asnjë pedagog (në dy thirrje të realizuara nga Universiteti).
- për vitin 2022-2023 deklarohet 1 vend vakant me gradë Dr. në fushën e Mekatronikës/ Mekanikës dhe nuk është aprovuar asnjë pedagog (në dy thirrje të realizuara nga Universiteti).
- për vitin 2023-2024 nuk deklarohet vend vakant, në fushën e Mekatronikës/ Mekanikës.

Nga analiza e ngarkesave mësimore të stafit (Tabela 4) rezulton se pedagogët që janë angazhuar në këtë program studimi kanë ngarkesë shumë të madhe në këtë program apo në programe të tjera që AU zhvillon, e cila reflektohet në numrin e madh të lëndëve/moduleve dhe të orëve mësimore, që mbulojnë në një vit. Konkretisht:

- ✓ **8 pedagogë me tituj/grada** - mbulojnë nga **8 - 13 lëndë** në një vit. Ngarkesa në orë mësimore e tyre deklarohet nga **441** deri në **652** orë mësimore.
- ✓ **4 pedagogë me kualifikimin Msc.** (ose Dr. në proces) mbulojnë nga **7** deri **12 lëndë** në një vit (njëri prej tyre është deklaruar PNA/laborant dhe mbulon 7 lëndë). Ngarkesa në orë mësimore e tyre deklarohet nga **447** deri në **550** orë mësimore.

Gjithashtu GVJ konstatoi se me mbingarkesë janë edhe koordinatorët e programeve (që për programin e studimit Bsc. në Inxhinieri Mekatronike ka ndryshuar çdo vit).

Prandaj GVJ konstaton se ky rekomandim nuk është plotësuar.

b. Institucioni, të krijojë një fond specifik të dedikuar për kualifikimin e mëtijshëm të personelit akademik, pa tituj dhe grada shkencore.

Përgjigja e Institucionit në RVB

Institucioni ka mbështetur intensivisht aplikimet e stafit akademik të brendshëm pa grada shkencore dhe tituj akademikë, brenda dhe jashtë vendit, duke pasur gjatë viteve të fundit rezultate pozitive në këtë drejtim (një lektor ka marrë titullin akademik Prof. Asoc. Dr., dhe 2 asistent lektorë kanë filluar ndjekjen e doktoratës [Tabela 2].

Vlerësimi i GVJ

Nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, (3.1.a., 3.1.b dhe 3.1.c) deklarimeve në RVB, rezulton se janë planifikuar/realizuar trajnime në fushën e pedagogjisë, psikologjisë dhe menaxhimit të mësimit që i shërben cilësisë, në fushën e standardeve të cilësisë, në rregullat e aplikimit në projekte, në nevojat emocionale të studentëve, për procesin e akreditimit, etj.

Gjithashtu, sipas Tabelës 18 dhe 19 në RVB, rezulton se nga shkolla nuk janë dedikuar fonde për kualifikimin e mëtijshëm të stafit akademik. Por nga takimi me stafin akademik GVJ mësoi se

disa pedagogë janë mbështetur me fonde nga projekte të tjera, me të cilat janë realizuar disa pjesëmarrje në konferenca jashtë vendit, si në Norvegji, etj.

Prandaj GJV konstaton se ky rekomandim është plotësuar/pjesërisht.

c. Institucioni, të përcaktojë koordinatoren e programit të studimit, i cili do të jetë përgjegjës për zhvillimin e programit dhe të praktikave profesionale.

Përgjigja e Institucionit në RVB

Në mbledhjen e Departamentit të zhvilluar në datën 13.10.2021 janë propozuar dhe miratuar koordinatorët e programit të studimit dhe i janë përcjellë Dekanit me shkresë nr. 975, datë 13.10.2021 [Evidencë R.3].

Vlerësimi i GJV

Nga dokumentacioni i bashkëngjitur në DVV (Ref R3) rezulton se çdo vit janë përcaktuar koordinatorët e programit të studimit. Në një rast është përgjegjësi i laboratorit (Personel Ndihmës Akademik), që është edhe pedagog me 7 lëndë. GJV konstaton se janë përcaktuar çdo vit edhe koordinatorët e grup lëndëve (dok 2.4.a) dhe udhëheqësit e praktikave (dok 2.2) dhe mendojmë se kjo ndihmon në koordinimin e procesit mësimor në këtë program studimi.

Prandaj GJV konstaton se ky rekomandim është plotësuar.

d. Të rrisë numrin e orëve në auditor për leksion dhe seminare, për këtë program studim, duke respektuar kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi.

Përgjigja e Institucionit në RVB

Për plotësimin e rekomandimeve të lëna nga Bordi i Akreditimit, Departamenti i Inxhinierive ka ngritur Grupin e Ekspertëve që shqyrtojnë këtë çështje [Evidencë R.4.a]. Ky i fundit ka konstatuar se raporti orë në auditor/ECTS për leksione (7.5 orë/ECTS, kufiri 6-12), seminare (8 orë/ECTS, kufiri 6-8) dhe ushtrime (15 orë/ECTS, kufiri 12-18), është në përputhje me udhëzimin nr.15, datë 04.04.2008 (udhëzimi i fundit i cili përcakton ngarkesën orë/ECTS sipas veprimtarive), duke i orientuar kështu programet e studimit drejt vizionit "learning by doing" [Evidencë R.4.a] dhe mbështetet edhe tek Vendimi nr.13, datë 07.04.2021 i Senatit Akademik të Albanian University, nr. Prot. 248/7 [Evidencë R.4.b].

Vlerësimi i GJV

Nga përgjigja e Institucionit në RVB dhe nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se mbështetur në Grupin e ekspertëve që ka ngritur, institucioni **nuk e ka pranuar** këtë rekomandim dhe nuk ka ndryshuar numrin e orëve. Ky rekomandim e ka bazën në faktin që programi i studimit në vitin 2021 rezultonte se kishte orë totale në auditor [citojmë]: gjithsej 1875, që përbëjnë 41.67% të fondit total të orëve të këtij programi studimi. Orët jashtë auditorit (studim individual) përbëjnë 58.33% të ngarkesës totale.

Ndërkohë sugjerimi që orët në auditor për çdo kredit (në lëndët në fushat inxhinierike) të aprovohen në Senat është plotësuar me Vendimin nr.13/2021 të Senatit akademik.



GVJ nuk mund të diskutojë rekomandimet e Bordit të Akreditimit dhënë në vendimin e tij të vitit 2021.

Prandaj GVJ konstaton se ky rekomandim nuk është plotësuar.

- e. Të zgjeroj gamën e metodave të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për vlerësimin e cilësisë me qëllim implementimin sa më të mirë të rezultateve të mësimdhënies për këtë program studimi.*

Përgjigja e Institucionit në RVB

Institucioni, nëpërmjet Zyrës së Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë realizon sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në bashkëpunim me grupet e sigurimit të cilësisë në nivel departamenti si dhe me Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave. NjSBC përdor një sërë metodash për përmirësimin e cilësisë, konkretisht zhvillon dy herë në vit, në fund të çdo semestri, pyetësin e studentëve dhe një herë në vit fokus grupet për monitorimin e ecursisë së procesit mësimor, evidentimin e pakënaqësive dhe marrjen e sugjerimeve nga ana e studentëve. Krahas tyre, Zyra e Karrierës dhe Alumnit në bashkëpunim me NjSBC-në kanë hartuar një pyetësor për studentët "Alumni", i cili është implementuar në Janar 2022. Të dhënat këtij pyetësori shërbejnë për të njohur impaktin që ka procesi i mësimdhënies në tregun e punës si dhe tregojnë përqindjen e punësimit të studentëve brenda profilit të diplomës [Evidencë R.5.a, b].

Vlerësimi i GVJ

Mendojmë se arsyetimi i Institucionit (më sipër) dhe dokumentacioni i bashkëngjitur në DVV tregojnë se ky rekomandim është plotësuar për metodat e tërthorta, sepse janë realizuar pyetësorë ku janë përfshirë edhe studentët "Alumni", që kanë dalë në tregun e punës. Ndërkohë nuk është shkruar për metodat e drejtpërdrejta si vlerësimi i didaktikës, vëzhgimet në auditor, etj.

Prandaj GVJ konstaton se ky rekomandim është plotësuar kryesisht.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Inxhinieri Mekatronike”.

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit Bsc. në “Inxhinieri Mekatronike” (më tej IM) që në hapjen e tij në AU, ka shërbyer në ndihmë të formimit të Inxhinierëve të rinj, në shërbim të ekonomisë së vendit, duke kontribuar dhe shërbyer interesit kombëtar.
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Nga rregullorja e programit, nga Statuti i AU dhe Rregullorja e Albanian University GJV konstaton se Programi i studimit Bsc. në IM është hartuar në zbatim të vizionit dhe misionit të Universitetit. Fusha e studimit të PS përputhet me fushën e veprimtarisë së departamentit të Inxhinierive dhe Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomikë të këtij institucioni. [Evidencë Tabela 3; Evidencë 1.1.a, b, c]; [Evidencë 1.2, Neni 2, fq. 1, Neni 7, fq. 3]; [Evidencë 1.3, Neni 36, fq. 32].
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	GVJ konstaton se për zhvillimin e programeve në fushat inxhinierike ka një strategji zhvillimi dhe sipas RVB [cit]: <i>Programet e studimit të ofruara nga Departamenti i Inxhinierive janë hartuar në përputhje me strategjinë për zhvillim të Institucionit. Departamenti i Inxhinierive zhvillon veprimtaritë e tij në përputhje me planin strategjik të zhvillimit institucional, si dhe planin e masave në kuadër të realizimit të objektivave strategjike institucionale.</i> Megjithatë GVJ konstaton se për fushën e Mekatronikës ofrohet vetëm cikli i parë i studimeve (sipas kërkesave të Procesit të Bolonjës, për të siguruar një formim të plotë të studentëve ofrohen dy cikle studimi). Por, Departamenti Inxhinierive ofron për studentët përveç programeve Bsc. (5 programe) edhe 2 Programe Msc. dhe 1 Program MP, ku studentët e këtij programi që po vlerësohet mund të kryejnë

	studimet e ciklit të dytë, duke plotësuar edukimin e tyre me 2 cikle studimi. <i>[Evidencë 1.4.a];</i> <i>[Evidencë 1.4.b,c].</i>
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Nga verifikimi i dokumentacionit dhe nga vizita në institucion GVJ konstaton se Departamenti i Inxhinierive ka përvojën e duhur për ofrimin e programeve të fushës inxhinierike. Ky program është 13 vjeçar dhe ka kaluar disa procese vlerësimi. Programi mësimor “Bachelor në IM” mbulohet nga pedagogët e departamentit/Fakultetit dhe nga pedagogë të ftuar, të cilët kanë kualifikimin/gradën apo titujt akademikë. <i>Megjithatë siç do të analizohet më poshtë stafi akademik efektiv është i ngarkuar me shumë lëndë /module dhe për pasojë me shumë orë mësimore. Pra kapacitetet njerëzore nuk janë të plota. Duke qenë se kjo problematikë ka qenë edhe në rekomandimet e VBA nr. 38, datë 12.03.2021, GVJ mendon se ky kriter është i paplotësuar.</i> Departamenti i Inxhinierive ka infrastrukturën e nevojshme për realizimin e këtij programi studimi. <i>[Evidencë Tabela Aneks RVB Bsc. IM [Tabela 2], [Tabela 6], [Tabela 16],</i> <i>[Evidencë 1.5 1.5 Përshkrimi i Laboratoreve të Depart të Inxhinierive].</i>
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Nga verifikimi GVJ konstaton se programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë bazë dhe njësisë kryesore. Programi i studimit “Bachelor në IM” ofrohet nga Departamenti i Inxhinierive/Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike. Departamenti i Inxhinierive ofron 8 programe studimi, të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë, me karakter inxhinierik. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike përfshin fusha akademike dhe kërkimore – shkencore në shkenca ekonomike, shkenca inxhinierike dhe dizajn. Në RVB institucioni deklaroi se [cit]: <i>Në përputhje me Udhëzimin e MAS nr. 31, datë 15.11.2022 mbi kodifikimin e programeve të studimit, Institucioni është angazhuar në përgatitjen e kodifikimit dhe dorëzimin brenda afateve të përcaktuara.</i> Nuk ka asnjë dokument ku shprehet kodi i programit të studimit. Sipas VKM nr. 310, datë 11.05.2022 dhe Udhëzimit të MAS nr. 31, datë 15.11.2022 kodi i programit të studimit bachelor në Inxhinieri Mekatronike duhet të jetë 63 BA 0710 S (ku 710 - Inxhinieri dhe

	profesione inxhinierike të papërcaktuar më tej)), pasi Inxhinieri Mekatronike nuk jepet si fushë e veçantë. [Evidencë 1.6, Rregullore FSHAE - 20.04.2022 [Neni 1, 7].
--	--

Konkluzione:

- ✓ *Albanian University e ofron këtë program studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.*
- ✓ *Programi i studimit Bsc. në "Inxhinieri Mekatronike" që në hapjen e tij në AU, ka shërbyer në ndihmë të formimit të Inxhinierëve të rinj, në shërbim të ekonomisë së vendit, duke kontribuar dhe shërbyer interesit kombëtar.*
- ✓ *Fusha e studimit të programit të studimit përputhet me fushën e veprimtarisë së Departamentit të Inxhinierive dhe Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike të këtij institucioni.*
- ✓ *Për fushën e Mekatronikës ofrohet vetëm cikli i parë i studimeve, por Departamenti Inxhinierive ofron 2 programe Msc. dhe 1 program MP, ku studentët e këtij programi që po vlerësohet mund të kryejnë studimet e ciklit të dytë, duke plotësuar edukimin e tyre me 2 cikle studimi.*
- ✓ *Stafi akademik efektiv është i ngarkuar me shumë lëndë /module dhe për pasojë me shumë orë mësimore. Pra kapacitetet njerëzore nuk janë të plota. Duke qënë se kjo problematikë ka qënë edhe në rekomandimet e VBA nr. 38, datë 12.03.2021, GVJ mendon se ky kriter është i paplotësuar (standardi 1.1, Kriteri 4).*

Rekomandime/Sugjerime:

1. *Të rriten kapacitete akademike për Departamentin e Inxhinierive, për të eliminuar mbingarkesën e pedagogëve*
2. *Të shikohet mundësia e hartimit dhe licencimit të një programi të ciklit të dytë në fushën e mekatronikës (sugjerim), nëse studimi i tregut të punës jep të dhëna pozitive në këtë drejtim (Komisioni për kurrikulat dhe mësimin).*

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së	Nga vizita në institucion dhe nga DVV, GVJ konstaton se ka një bashkëpunim dhe harmonizim të punës akademike dhe administrative midis personelit akademik dhe administrativ të Departamenteve, Fakulteteve, që ka siguruar ecurinë pozitive të programit lidhur me mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe aktivitetet jashtë kurrikulës. Struktura e detyrave administrative të stafit akademik përmban detyrat e: ✓ Përgjegjësit të departamentit;

përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	✓ Përgjegjësit të lëndës/ëve, ✓ Koordinatorëve të grupeve mësimore, ✓ Koordinatorit të programit të studimit, ✓ Grupit të sigurimit të cilësisë në nivel departamenti. Në RVB deklarohet [cit]: <i>Detyrat e stafit janë të përcaktuara qartë në rregulloret përkatëse të zyrave. Secila zyrë raporton në mënyrë periodike mbi veprimtarinë e kryer në instancat nga të cilat varet, duke garantuar transparencë dhe bashkëpunim të frytshëm midis strukturave të institucionit.</i> GVJ konstaton se në rregulloren e departamentit rezultojnë se janë përshkruar detyrat për secilin grup të mësipërm. Raportimi për përmbushjen e detyrave bëhet në mënyrë periodike. <i>[Evidencë 1.6 Rregullore FSHAE - 20.04.2022];</i> <i>[Evidencë 2.3 Rregullore Departamenti - VS. 20 - 30.07.2021].</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Nga DVV dhe takimet në AU, GVJ konstaton se institucioni ka realizuar vazhdimisht marrëveshje bashkëpunimi me Institucione homologe të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Këto marrëveshje bëhen në kuadër të kërkimit shkencor të stafit dhe të zhvillimit të kapaciteteve të tyre, në kuadër të programeve Erasmus+, etj. Nga të dhënat në Tabelën 5 rrëdhiten 16 marrëveshje bashkëpunimi të AU me institucione homologe në Itali, Turqi, Norvegji, Bullgari, etj. <i>[Evidencë 1.1.c; Tabela 5].</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Nga DVV dhe takimet në AU, GVJ konstaton se institucioni ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me Institucione/ndërmarrje të ndryshme në kuadër të zhvillimit të praktikave mësimore dhe të zhvillimit të kapaciteteve, si dhe për të ndihmuar studentët në gjetjen e një vendi pune, etj. Nga të dhënat në Tabelën 5 rrëdhiten 30 marrëveshje bashkëpunimi, që i përkasin Departamentit të Inxhinierive, nga të cilat 14 marrëveshje i takojnë programit të studimit “Bsc. në IM”, ku realizohen praktikat profesionale. Nga Raportet analitike të zhvillimit të praktikave profesionale rezultojnë se disa prej marrëveshjeve nuk kanë afatet e vlefshmërisë së tyre. <i>[Evidencë 1.1.c; Tabela 5];</i> <i>[Evidencë 1.7.a Raport analitik Marrëv praktika D Inxh 2021-2022]</i> <i>[Evidencë 1.7.b Raporti analitik marrëv- praktika DI 2022 - 2023];</i> <i>[Evidencë 1.7.c Raporti analitik marrëv- praktika DI 2023 - 2024].</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse	Departamenti i Inxhinierive harton në mënyrë periodike raportin analitik në lidhje me përfitimet e marrëveshjeve të bashkëpunimit, në

për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	kuadër të realizimit të praktikave profesionale. Gjatë vizitës në institucion u evidentua kujdesi për këtë pjesë të rëndësishme të programit të studimit. Nga Raportet analitike të zhvillimit të praktikave profesionale rezulton se disa prej marrëveshjeve nuk kanë afatet e vlefshmërisë së tyre. [Evidencë 1.7.a Raport analitik Marrëv praktika DI 2021-2022] [Evidencë 1.7.b Raporti analitik marrëv praktika DI 2022 - 2023]; [Evidencë 1.7.c Raporti analitik marrëv praktika DI 2023 - 2024].
---	--

Konkluzione:

- ✓ *Albanian University ka siguruar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.*
- ✓ *GVJ konstaton se ka një bashkëpunim dhe harmonizim të punës akademike dhe administrative midis personelit akademik dhe administrativ të Departamentit, të këtij me departamentet e tjera të Fakultetit, që ka siguruar ecurinë pozitive të programit lidhur me mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe aktivitetet jashtë kurrikulës;*
- ✓ *GVJ konstaton se institucioni ka realizuar vazhdimisht marrëveshje bashkëpunimi me Institucione homologe të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, në kuadër të kërkimit shkencor të stafit dhe të zhvillimit të kapaciteteve të tyre, në kuadër të programeve Erasmus+, etj.*
- ✓ *Nga të dhënat rradhiten 30 marrëveshje bashkëpunimi, që i përkasin Departamentit të Inxhinierive, nga të cilat 14 marrëveshje i takojnë programit të studimit "Bsc. në IM", ku realizohen praktikatat profesionale.*
- ✓ *Nga Raportet analitike të zhvillimit të praktikave profesionale rezulton se disa prej marrëveshjeve nuk kanë afatet e vlefshmërisë së tyre. (Standardi 1.2, Kriteri 4).*

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.											
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve										
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Nga dokumentacioni për licencim, akreditime si dhe nga dosja e paraqitur nga Institucioni rezulton se programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Mekatronike" ka të dhënat e mëposhtme: <table> <tr> <td>✓ Cikli i studimit:</td><td>Cikli i Parë</td></tr> <tr> <td>✓ Kohëzgjatja e PS:</td><td>3 vite</td></tr> <tr> <td>✓ Kreditet në total (ECTS):</td><td>180 kresite (ECTS)</td></tr> <tr> <td>✓ Forma e studimit:</td><td>Me kohë të plotë</td></tr> <tr> <td>✓ Gjuha (shqip/tjetër):</td><td>Shqip</td></tr> </table> Ky program studimi është i organizuar në module dhe është i vlerësuar në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Sasia e krediteve të grumbulluara gjatë një viti, nga një student që ndjek këtë program studimi është 60 kredite. Diploma "Bachelor" mbrohet me provim formimi ose punim (tezë) diplome (për studentët me mesatare mbi 8). [Evidencë Tabela Aneks RVB BSc.IM.]; [Evidencë 2.1.a Kurrikula Bsc. IM – 04.2019]; [Evidencë 2.1.b Plani mësimor Bsc. IM – 04.2019].	✓ Cikli i studimit:	Cikli i Parë	✓ Kohëzgjatja e PS:	3 vite	✓ Kreditet në total (ECTS):	180 kresite (ECTS)	✓ Forma e studimit:	Me kohë të plotë	✓ Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
✓ Cikli i studimit:	Cikli i Parë										
✓ Kohëzgjatja e PS:	3 vite										
✓ Kreditet në total (ECTS):	180 kresite (ECTS)										
✓ Forma e studimit:	Me kohë të plotë										
✓ Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip										
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një	Sipas rregullores së PS, Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Mekatronike" ka për qëllim të hedhë bazat shkencore dhe përgatitjen teoriko - praktike të nevojshme për ushtrimin e profesionit si inxhinier në fushën e mekatronikës, i cili do të kontribuojë në drejtim të mirëmbajtjes apo të prodhimit të sistemeve të thjeshta mekatronike. Kjo përgatitje e përgjithshme gjatë periudhës trevjeçare u krijon mundësinë studentëve të integrohen në tregun e punës dhe gjithashtu, formon bazat e nevojshme për të thelluar studimet dhe për të përfutur kompetenca më specifike mbi tema më të profilizuara që mund të trajtohen gjatë studimeve të specializuara. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të programit të studimit Bachelor në IM, si: plani mësimor, syllabuset e lëndëve, Rregullorja e programit të studimit, si dhe në takimet me personelin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi se ky program studimi synon t'u ofrojë studentëve njohuri të thelluara teorike dhe aftësi/kompetenca të përparuara profesionale:										

fushë të specializuar studimi ose profesionale.	✓ me të cilat do të përballen në tregun e punës. ✓ të mjaftueshme edhe për të ndjekur ciklin e dytë të studimit (më lart kemi shkruar se mund të vazhdojnë në programe të ngjashme inxhinierike). Në takimet me drejtuesit e Fakultetit u deklarua se ky program studimi është bashkëkohor dhe i krahasueshëm me programe studimi të ngjashme në universitete të tjera. <i>[Evidencë H.1 Rregullore mësimore Bsc. IM - 03.2019];</i> <i>[Evidencë Tabela Aneks RVB Bsc.IM];</i> <i>[Evidencë 2.1.a Kurrikula Bsc. IM – 04.2019];</i> <i>[Evidencë 2.1.b Plani mësimor Bsc. IM – 04.2019];</i> <i>[Evidencë Syllabuset e lëndëve/moduleve - gjithsej 42].</i>
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Në kurrikulën e PS Bachelor në “Inxhinieri Mekatronike”, si në planin mësimor, syllabuset e lëndëve si dhe në rregulloren mësimore përkatëse janë përcaktuar Kategoritë e Veprimtarive Formuese (A-E), me ngarkesat përkatëse në kredite, përkatësisht: A) LËNDË BAZË - 33 kredite/18% (15% - 20%) B) LËNDË KARAKTERIZUESE - 96 kredite/54% (50% - 55%) C) LËNDË NDËRDISIPL/INTEG - 23 kredite /13% (12% - 15%) D) LËNDË PLOTËSUESE - 22 kredite/12% (10% - 15%) E) DETYRIME PËRMBYLLËSE - 6 kredite/3% (3%-5%) Për çdo lëndë/modul përcaktohen: ✓ Lëndët në planin mësimor kanë nga 3 deri në 6 kredite ✓ Format e ndryshme të mësimdhënies që janë: - Leksione; - Seminare - Ushtrime - Detyrë kursi; - Orë Laboratorike - Praktika profesionale, praktika në terren apo stazh - Provimi përfundimtar/tezë diplome <i>[Evidencë H.1 Rregullore mësimore Bsc. IM - 03.2019];</i> <i>[Evidencë Tabela Aneks RVB Bsc.IM];</i> <i>[Evidencë 2.1.a Kurrikula Bsc. IM – 04.2019];</i> <i>[Evidencë 2.1.b Plani mësimor Bsc. IM – 04.2019];</i> <i>[Evidencë Syllabuset e lëndëve/moduleve - gjithsej 42].</i>
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e	GVJ konstaton se në planin mësimor janë përcaktuar, përkatësisht në Kategorinë D dhe E: 1) Praktika profesionale me 4 kredite;

praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	2) Detyrimet përmbyllëse, që mund të jetë provim ose tezë diplome, me 6 kredite. Ngarkesa në kredite përbush kërkesat ligjore dhe nënligjore për to. <i>[Evidencë H.1 Rregullore mësimore Bsc. IM - 03.2019];</i> <i>[Evidencë 2.1.a Kurrikula Bsc. IM – 04.2019];</i> <i>[Evidencë 2.1.b Plani mësimor Bsc. IM – 04.2019];</i> <i>[Evidencë Syllabuset e praktikës profesionale dhe detyrimeve përmbyllëse].</i>
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	N/A
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	GVJ konstaton se hartuesit e RVB nuk kanë dhënë një përgjigje për këtë kërkesë ligjore, që kërkon që ky program të ketë afërsi me programe të tjera që ofrohen në Shqipëri apo Europë në masën 70%, për të lehtësuar jo vetëm transferimet e studentëve por edhe për të siguruar që diplomat me të njëjtën emërtesë kanë të paktën formim të njëjtë .
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Institucioni deklaron: <i>Në përputhje me Udhëzimin e MAS Nr. 31, datë 15.11.2022 mbi kodifikimin e programeve të studimit, Institucioni është angazhuar në përgatitjen e kodifikimit dhe dorëzimin brenda afateve të përcaktuara.</i> Sipas VKM nr. 310/2022 dhe Udhëzimit të MAS nr. 31/2022, kodi i programit të studimit bachelor në Inxhinieri Mekanike duhet të jetë 63 BA 0710 S (ku 710-Inxhinieri dhe profesione inxhinierike të pa përcaktuar më tej), pasi Inxhinieri Mekanike nuk jepet si fushë e veçantë.
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në	N/A Ky program nuk ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, vendas apo të huaj.



përputhje me legjislacionin në fuqi.				
Konkluzione				
✓ <i>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi;</i>				
✓ <i>Nga dokumentacioni për licencim, akreditime si dhe nga dosja e paraqitur nga Institucioni rezulton se programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Mekatronike” ka të dhënat e mëposhtme:</i>				
➤ Cikli i studimit: Cikli i Parë ➤ Kohëzgjatja e PS: 3 vite ➤ Kreditet në total (ECTS): 180 kresite (ECTS) ➤ Forma e studimit: me kohë të plotë ➤ Gjuha (shqip/tjetër): Shqip				
✓ <i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të programit të studimit Bachelor në IM, si: plani mësimor, syllabuset e lëndëve, Rregullorja e programit të studimit, si dhe në takimet me personelin akademik dhe studentët, GVJ konstatoi se ky program studimi synon t'u ofrojë studentëve njohuri të cilat i përgjigjen kërkesave të tregut të punës dhe u mundëson atyre për të ndjekur ciklin e dytë të studimit.</i>				
✓ <i>Në kurrikulën e PS Bachelor në “Inxhinieri Mekatronike”, si në planin mësimor, syllabuset e lëndëve si dhe në rregulloren mësimore përkatëse janë përcaktuar Kategoritë e Veprimtarisë Formuese (A-E), me ngarkesën përkatëse në kredite, sipas normativës së përcaktuar në aktet ligjore.</i>				
✓ <i>GVJ konstaton se në planin mësimor janë përcaktuar: 4 kredite, për realizimin e praktikës profesionale dhe 6 kredite, për detyrimet përmbyllëse, që mund të jetë provim i përgjithshëm përfundimtar ose tezë diplome</i>				
✓ <i>GVJ konstaton se kodifikimi nuk është realizuar akoma.</i>				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike dhe Departamenti i Inxhinierive përmbushin detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Ato zhvillojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me aktet rregullatore të Institucionit, të cilat reflektojnë në vazhdimësi përputhjen me aktet ligjore dhe nënligjore të AL. FSHAE përmbëhet nga 3 departamente, numri minimal i kërkuar për njësitë baze. Njësia kryesore, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike sipas të dhënave në vite ka pasur këtë strukturë akademike:

Fakulteti i SHAE	Viti akademik 2021-2022		Viti akademik 2022-2023		Viti akademik 2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Departamenti i Inxhinierive	17	19	18	18	21	18
Departamenti i Shk.Ekonomike	13	21	14	16	13	15
Departamenti i Art Dizajnit	7	8	7	8	9	6
Total	37	48	39	42	45	39

Ndërsa të dhënat për **Departamentin e Inxhinierive** në vite janë si më poshtë, ku rezulton se plotësohet kërkesa ligjore për numrin minimal të titujve dhe gradave në një departament (>3):

Departamenti i Inxhinierive	Viti akademik 2021-2022		Viti akademik 2022-2023		Viti akademik 2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof. Dr.	-	2	-	1	-	2
Prof. As. Dr.	1	5	1	4	2	5
Dr/PhD	7	11	7	12	7	10
Msc(Dr.proces)	-	-	1	-	3	-
Msc.	9	1	9	1	13	2
Total	17	19	18	18	21	19

Në tre vitet e fundit akademike, numri i personelit akademik efektiv në departament ka qenë mbi 7, nga të cilët personeli me tituj/gradë shkencore ka qenë mbi 3. Struktura akademike e Departamentit të Inxhinierive mbulon organizimin për 5 PS të ciklit të parë, Bachelor, dhe 3 programe studimi të ciklit të dytë, Master i Shkencave (2) dhe Master Profesional (1). Aktivizimi i personelit akademik me kohë të pjesshme mundëson që të plotësohet ngarkesa mësimore.

Me Vendim të Bordit të Akreditimit VBA nr. 01, datë 24.01.2020 "Për Akreditimin Institucional të Institucionit të Arsimit të Lartë, Universiteti Privat "Albanian University", për rastin tonë edhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, është akredituar me kohëzgjatje 3 (tre) vite. Vlefshmëria e akreditimit të Institucionit është deri më 23/01/2023.

[Evidence: Tabela Aneks RVB Bsc.IM].

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik

Departamenti i Inxhinierive përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Për personelin ndihmës akademik, administrativ. Të dhënat janë si më poshtë:

Departamenti i Inxhinierive	Personeli ndihmës akademik dhe administrativ (*)		
	Viti akademik 2021-2022	Viti akademik 2022-2023	Viti akademik 2023-2024

/administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	12 11 11 (*) Në këtë kategori janë përfshirë: përgjegjës departamenti, asistente departamenti, kryesekretare FSHAE, sekretare mësimore, administratore FSHAE, punonjëse biblioteke FSHAE, përgjegjës IT, specialistë IT, laborantë. Sipas Nenit 44 të statutut dhe Nenit 31 të Rregullores së AU, personeli ndihmës akademik me karakter mësimor (laborantët, asistentët) shërbejnë si asistentë pedagogë për praktikat mësimore. Në fakt rezulton se Personeli ndihmës akademik është i ngarkuar edhe në mësimdhënie. [psh Msc. J.K, personel ndihmës akademik deklarohet laborant dhe njëkohësisht staf akademik me 7 lëndë]. [Evidence Tabela Aneks RVB Bsc.IM].
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Siç konstaton GVJ, në FSHAE janë përcaktuar çdo vit koordinatorë të rinj të programeve të studimit, edhe të PS “Bsc në Inxhinieri Mekanike”, ku në disa raste një pedagog është koordinator i disa programeve. Ato janë pjesë e stafit mësimdhënës dhe në disa raste janë të mbingarkuar me lëndë/orë mësimore. Detyra e Koordinatorit të programit të studimit nuk është përcaktuar në asnjë akt ligjor të AU, si Statut, rregullore. Nga takimi me drejtuesit GVJ u informua se Koordinatori i Programit është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e praktikave profesionale, ndërsa për ecurinë në tërësi të PS është përgjegjës drejtuesi i departamentit. Departamenti ka bërë ndarjen e lëndëve në grup - lëndë dhe ka ngritur emërtuar Koordinatorët e grup-lëndëve: › grup-lëndët e formimit bazë (Matematikë, Fizikë, Kimi, Gjuhë e huaj, Ekonomi). › grup-lëndë të fushës së Inxhinierisë Mekanike. › grup-lëndë të fushës së Inxhinierisë Elektronike. › grup-lëndë të fushës së Inxhinierisë Elektrike. › grup-lëndë të fushës së Inxhinierisë Kompjuterike/Teknologjisë së Informacionit. Koordinatorët e grup-lëndëve, mbajnë gradën shkencore “Doktor” dhe i raportojnë përgjegjësit të departamentit në lidhje me mbarëvajtjen e grup-lëndëve. [Evidence: 1.2 Statuti Albanian University]; [Evidence: 1.3 Rregullore Albanian University]; [Evidence: 1.6 Rregullore FSHAE - 20.04.2022]; [Evidence: 2.4.a Koordinatorët e grup-lëndëve DI].
Konkluzione:	



- ✓ Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike dhe Departamenti i Inxhinierive përmbushin detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për këto njësi
- ✓ Universiteti Privat "Albanian University", për rastin tonë edhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike është akredituar me kohëzgjatje 3 (tre) vite. Vlefshmëria e akreditimit të Institucionit është deri më 23/01/2023.
- ✓ Sipas Rregullores së AU, personeli ndihmës akademik me karakter mësimor (laborantët, asistentët) shërbejnë si asistentë pedagogë për praktikat mësimore. Personeli ndihmës akademik, i deklaruar si laborantë janë të ngarkuar edhe në mësimdhënie [Standardi 2.2, kriteri 2].
- ✓ Departamenti ka bërë ndarjen e lëndëve në grup - lëndë dhe ka ngritur emërtuar Koordinatorët e grup-lëndëve, që janë pedagogë përfaqësues të fushave përkatëse, mbajnë gradën shkencore "Doktor" dhe i raportojnë përgjegjësit të departamentit në lidhje me mbarëvajtjen e grup-lëndëve.
- ✓ Në FSHAE janë përcaktuar çdo vit koordinatorë të rinj të programeve të studimit, pra edhe të PS "Bsc. në Inxhinieri Mekatronike", ku në disa raste një pedagog është koordinator i disa programeve. Detyra e Koordinatorit të programit të studimit nuk është përcaktuar në asnjë akt ligjor të AU, si Statut, rregullore.

Rekomandime /sugjerime

- ✓ Të përcaktohet në dokumenta rregullatore (psh Rregullore), detyra e Koordinatorit të programit të studimit dhe kualifikimi minimal që duhet të ketë kjo detyrë (tituj/gradë/apo kualifikim Msc/MP).

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	


Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Nga shqyrtimi i Dosjes së Vetëvlerësimit, takimet me drejtues dhe me strukturat e tjera, GVJ konstaton se Fakulteti/Departamenti kanë informacion të plotë, të nevojshëm për programin e studimit. Në Dosje janë, duke i përmbledhur këto dokumenta: ✓ Plani mësimor i programit të studimit, syllabuset e lëndëve (42), Procedura e rishikimit të kurrikulave -programet e studimit Bachelor; ✓ Statuti Albanian University; Rregullore Albanian University; Plani strategjik institucional 2023 – 2028; ✓ Rregullorja e programit të studimit, Rregullore mesimore; Rregullore FSHAE; Rregullore Departamenti; ✓ Rregullore e regjistrimeve dhe transferimeve; Manual per realizimin e mësimi online; Rregullore e sekretarisë mësimore; Rregullore e Zyrës së Kordinimit dhe Mbështetjes së Studentëve; Rregullore e Zyrës së Karrieres dhe Alumnit; Rregullore për mbarëvajtjen e kurrikulave dhe procesit mësimor në AU; Rregullore NJSBC;

	✓ Lista e personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, të aktivizuar në vite në mësimdhënie në këtë program studimi; Ngarkesa mësimore stafi akademik; CV e stafit akademik; Procedurë rekrutimi, Kontratë PAE; Kontratë PAK; ✓ Koordinatorët e programeve të studimit; Koordinatorët e grup-lëndëve; ✓ Raporte vjetore; Raporte analitike të marrëveshjeve për praktikant; Raport mbi studimin e tregut; ✓ Rezultatet e pyetjeësorëve drejtuar studentëve; Rezultatet e pyetësorit drejtuar personelit akademik; Punësimi i studentëve Alumni; ✓ Infrastruktura, laboratorët, Lista e librave në Bibliotekë; Lista e Marrëveshjeve për praktikant mësimore; <i>[Evidencë: Lista e evidencave mbështetëse Bsc. IM].</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/ moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Në Dosje është paraqitur plani i detajuar mësimor, në të cilin janë përfshirë të gjitha informacionet e nevojshme në lidhje me numrin e krediteve, ndarja e krediteve sipas aktiviteteve formuese, orët mësimore në auditor dhe orët mësimore jashtë auditorit, ngarkesa javore për çdo disiplinë/modul, si dhe forma e shlyerjes përfundimtare të lëndës. Nga Planin mësimor rezultojnë këto të dhëna: 1) Planin ka 3 vite/6 semestra/ 60 kredite në vit 2) Për çdo lëndë/modul përcaktohen: ✓ Ngarkesa përkatëse në kredite: lëndët në planin mësimor kanë nga 3 deri në 6 kredite; ✓ Ngarkesa në orë mësimore, bazuar në sasinë e krediteve (1 kredit është i barabartë me 25 orë mësimore (punë e studentit në auditor dhe jashtë tij); ✓ Format e ndryshme të mësimdhënies dhe ngarkesa në orë mësimore që janë: Leksionet, Seminaret, Ushtrimet, Laboratorët, Detyra kursi/ Projekte, Praktika profesionale dhe Provimi /Diploma. ✓ Për 4500 orë në total, ngarkesa në auditor është 1875 orë dhe jashtë tij është 2625 orë mësimore. <i>[Evidencë H.1 Rregullore mësimore Bsc. IM - 03.2019];</i> <i>[Evidencë 2.1.a Planin mësimor për Programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri Mekatronike"].</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme	Mbështetur në Dosjen e vetëvlerësimit, RVB dhe takimet në institucion GVJ konstaton se kriteret e pranimit të studentëve janë transparente dhe janë shpallur në rregulloren e "Regjistrimeve dhe

për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	transferimeve” të “Albanian University”. Në Rregulloren e programit të studimit Bachelor në IM jepen kriteret specifike të pranimit, transferimit të studimeve dhe ekuivalentimit të studimeve. [Evidencë 2.5 Rregullore e regjistrim dhe transferimeve - VS 25]; [Evidencë H.1 Rregullore mësimore Bsc. IM - 03.2019].
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	GVJ konstaton se: ✓ Syllabuset e lëndëve, janë hartuar sipas modelit/formatit të aprovuar në aktet ligjore, ku jepen: stafi që harton syllabusin, kreditet, viti/sem kur duhet të zhvillohet, temat mësimore për leksionet/ seminarëve, orët faktike për secilën prej temave, detyrimet lidhur me lëndën, etj. Frekuentimi / ndjekja e programit, mënyra e vlerësimit të dijeve, literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse. ✓ Vlerësimi i dijeve të studentëve është i vazhduar dhe nota përfundimtare është rezultat i disa elementëve, si më poshtë: ➤ 5% - pjesëmarrja dhe aktivizimi në orët e ushtrimeve ➤ 5% - detyra e kursit ➤ 10% - pjesëmarrja dhe vlerësimi në laboratorë ➤ 20% - provimi i ndërmjetëm/moduli ➤ 60% - provimi përfundimtar ✓ Për frekuentimin e studentëve IAL ka vendosur: ➤ Për leksionet detyrimi është - 75% ➤ Për seminarët detyrimi është - 75% ➤ Për praktikën/laboratorët - 100 % [Evidencë H.1 Rregullore mësimore Bsc. IM - 03.2019]; [Evidence: 42 syllabuse].
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	1) Nga takimet me drejtuesit dhe stafin akademik, GVJ konstatoi se janë bërë përditësime, përmirësime të vazhdueshme të programit. Megjithatë në akreditimin periodik të mëparshëm ekspertët e jashtëm dhe Bordi i Akreditimit dhanë këtë rekomandim për institucionin: <i>e. Të rrisë numrin e orëve në auditor për leksion dhe seminare, për këtë program studim, duke respektuar kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi.</i> GVJ konstaton se Institucioni, mbështetur në Grupin e ekspertëve që ka ngritur, <i>nuk e ka pranuar</i> këtë rekomandim dhe nuk ka ndryshuar numrin e orëve. GVJ nuk mund të diskutojë rekomandimet e Bordit të Akreditimit dhënë në vendimin e tij të vitit 2021. GVJ konstaton se ky rekomandim nuk është plotësuar dhe programi nuk është përditësuar në syllabuse.



	Nga takimi me stafin akademik rezultoi se janë implementuar disa ndryshime në seminare dhe orë laboratorike në drejtim të aplikimit të softeve inxhinierike. Por këto ndryshime nuk janë reflektuar në syllabuse. Ndërkohë sugjerimi që orët në auditor për çdo kredit (në lëndët në fushat inxhinierike) të aprovohen në Senat është plotësuar me Vendimin nr.13/2021 të Senatit Akademik. 2) Gjithashtu GVJ konstaton se, ngarkesa e lëndëve Matematikë (5 lëndë), Fizikë (2 lëndë), dhe Kimi (1 lëndë) që së bashku kanë 36 kredite, është e madhe. Mendojmë se duhen reduktuar/sistemuar njohuritë që jepen në këto 8 lëndë, duke futur lëndë të profesionit (psh të Robotikës, Automatikës, si fusha që përafrohen me këtë program studimi). Mund të rishikohet edhe heqja e lëndës së Kimisë, sepse mjaftojnë njohuritë e marra në shkollë të mesme [Standardi II.3, Kr. 5]. 3) Nga takimi me stafin akademik u konstatua se në disa lëndë (psh Matematikë) janë shtuar njohuritë për softet inxhinierike të fushës së programit të studimit, për të të rritur aftësitë e studentëve në drejtim të dixhitalizimit të njohurive, por nuk janë reflektuar në syllabuset përkatëse. [Evidence: 2.7.a Rishikime syllabuse - v.a. 2021 - 2022]; [Evidence: 2.7.b Rishikime syllabuse - v.a. 2022 – 2023]; [Evidence: 2.7.c Rishikime syllabuse - v.a. 2023 – 2024]; [Evidence: 2.6 Procedura e rishikimit të kurrikulave PS Bachelor /2019].
Konkluzione ✓ Programi i studimit Bsc në Inxhinieri Mekatronike është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë; ✓ Fakulteti/Departamenti kanë informacion të plotë, të nevojshëm për programin e studimit. ✓ Në Dosje është paraqitur plani i detajuar mësimor, në të cilin janë përfshirë të gjitha informacionet e nevojshme në lidhje me numrin e krediteve, ndarja e krediteve sipas aktiviteteve formuese, orët mësimore në auditor dhe orët mësimore jashtë auditorit, ngarkesa javore për çdo disiplinë/modul, si dhe forma e shlyerjes përfundimtare të lëndës. ✓ Kriteret e pranimit të studentëve janë transparente dhe janë shpallur në rregulloren e "Regjistrimeve dhe transferimeve" të "Albanian University". ✓ Syllabuset e lëndëve janë hartuar sipas modelit/formatit të aprovuar në aktet ligjore. ✓ Institucioni, mbështetur edhe në mendimin e Grupit të ekspertëve që ka ngritur për këtë qëllim, nuk ka ndryshuar numrin e orëve, pra nuk e ka pranuar rekomandimin e Bordit të Akreditimit [cit]: e. Të rrisë numrin e orëve në auditor për leksion dhe seminare, për këtë program studim, duke respektuar kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi.	

- ✓ Gjithashtu GVJ konstaton se, ngarkesa e lëndëve Matematikë (5 lëndë), Fizikë (2 lëndë) dhe Kimi (1 lëndë) që së bashku kanë 36 kredite, është e madhe për këtë program studimi [Standardi II.3, Kriteri 5].

Rekomandime/sugjerime:

- 1) Të reflektohet për plotësimin e rekomandimit të mëparshëm të BA, sepse mendojmë që forcon bazën teorike të programit të studimit;
- 2) Gjithashtu GVJ sugjeron, që grupi i Rishikimit të Kurrikulës të rishikojë ngarkesën e lëndëve Matematikë, Fizikë dhe Kimi, që së bashku kanë 36 kredite. Mendojmë se duhen reduktuar/sistemuar njohuritë që jepen në këto 8 lëndë, duke futur lëndë të profesionit (psh të Robotikës, Automatikës, si fusha që përafrohen me këtë program studimi). Mund të rishikohet edhe heqja e lëndës së Kimisë sepse mjaftojnë njohuritë e marra në shkollë të mesme.
- 3) Rekomandohet gjithashtu të shtohen edhe njohuritë për softet inxhinierike të fushës së programit të studimit, për të rritur aftësitë e studentëve në drejtim të dixhitalizimit të njohurive (aty ku janë tashmë të implementuara të reflektohen në syllabuset përkatëse).

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Mekatronike” ka emërtim që tregon përmbajtjen e tij si dhe qëllimin për të përgatitur studentët me bazat shkencore teoriko-praktike, të nevojshme për t’u integruar në tregun e punës. Mendojmë gjithashtu se përgatitja e tyre hedh baza edhe për studime të mëtejshme në ciklin e dytë. Nga takimi me studentë GVJ mësoi se një pjesë e studentëve dëshironin të studjonin në programet Master, ndërsa një pjesë tjetër të punësoheshin në profesion. [Takimi me studentet, takimi me stafin akademik].
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënës.	Në vitin e parë zhvillohen kryesisht lëndë të formimit bazë, nëpërmjet të cilave, studentët marrin njohuritë bazë në fushat e matematikës, fizikës, kimisë, informatikës, programimit. Në vitin e dytë dhe të tretë merren njohuri të lidhura ngushtësisht me fushën e studimit. Kreditet janë shpërndarë në raporte të përafërta në përqindje në fushën mekanike dhe në fushat elektrike/elektronike. Renditja e lëndëve /moduleve, vendosja e tyre në semestra /vite ndjek formimin gradual të studentëve, për të mënjeluar vështirësitë në përvetësimin e tyre. Po ashtu edhe në syllabuset e lëndëve temat paraardhëse shërbejnë si bazë për marrjen e njohurive në temat

	pasardhëse. Lëndët/ modulet në planin mësimor, sasia e krediteve/orëve mësimore në dispozicion, temat mësimore në syllabuset e tyre mendojmë se realizojnë objektivat formuese dhe rezultatet e të nxënit. <i>[Evidencë 2.1.aPlani mësimor për Programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri Mekatronike"];</i> <i>[Evidence: 42 syllabuse].</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	GVJ konstaton se institucioni në RVB dhe gjatë takimit me drejtuesit deklaroi [cit]: <i>Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Mekatronike" është organizuar në përputhje me modele të ngjashme kombëtare dhe ndërkombëtare të kësaj fushe</i>. Në modelin kombëtar Institucioni i është referuar UPT dhe programit të studimit me të njëjtin emërtim që ai ofron. 1) Për 4500 orë mësimore në total: > ngarkesa në auditor është 1875 orë mësimore, ose 42% të orëve totale të këtij programi studimi > Ngarkesa jashtë auditorit është 2625 orë mësimore, ose 58% të orëve totale të këtij programi studimi. 2) Referuar Raportit teori - praktikë nëse krahasojmë orët mësimore në auditor rezulton se: > 780 orë mësimore janë leksione ose 42% të orëve totale > 1097 orë mësimore janë në praktikë ose 58% të orëve totale. 3) Ndërsa për raportin teori-praktikë nëse krahasojmë kreditet në auditor rezulton se: > 103 kredite janë leksione ose 57% të krediteve totale > 77 kredite janë në praktike ose 43% të orëve totale. ku në kreditet /orët në praktikë, janë përfshirë seminare/ ushtrime/ laboratorë/ praktikë profesionale/detyra/projekte dhe punimi i diplomës. Pra në teori - praktikë raportet janë janë të përmbysuara nëse i referohemi orëve mësimore apo krediteve. GVJ konstaton se nuk është plotësuar rekomandimi i dhënë nga Bordi i Akreditimit në vendimin e tij në vitin 2021, dhe nga analiza e mësipërme mendojmë se DUHET rivendosur ai rekomandim, pra, për të rritur numrin e orëve në auditor për leksione dhe seminare, për këtë program studimi, duke respektuar kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi, për të përmirësuar raportin 42% / 58% të ngarkesës në auditor përkundrejt ngarkesës jashtë auditorit. <i>[Evidencë H.1 Rregullore mësimore Bsc. IM - 03.2019];</i>



	<i>[Evidencë 2.1.a. Plani mësimor për Programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri Mekatronike"].</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Institucioni ka përcaktuar në kurrikulën e tij objektivat formues dhe kompetencat profesionale që synohen të arrihen në përfundim të programit të studimit. A) Objektivat formues që janë: <i>Ky program studimi ka për qëllim të hedhë bazat shkencore dhe përgatitjen teoriko-praktike të nevojshme për ushtrimin e profesionit si inxhinier në fushën e mekatronikës, i cili do të kontribuojë në drejtim të mirëmbajtjes apo të prodhimit të sistemeve të thjeshta mekatronike. Kjo përgatitje e përgjithshme gjatë periudhës trevjeçare u krijon mundësinë studentëve të integrohen në tregun e punës dhe gjithashtu, formon bazat e nevojshme për të thelluar studimet dhe për të përfutur kompetenca më specifike mbi tema më të profilizuara që mund të trajtohen gjatë studimeve të specializuara.</i> B) Mundësitë, shprehjet dhe kompetencat profesionale që janë: <i>aftësia për të zhvilluar veprimtarinë në institucione dhe firma të ndryshme ku ka sisteme mekatronike të aplikuara;</i> <i>aftësia për të konceptuar dhe realizuar sisteme mekatronike të thjeshta;</i> <i>aftësia për të zhvilluar veprimtari të drejtëpërdrejtë në industrinë e prodhimit;</i> <i>aftësia për të ndërhyrë në drejtim të mirëmbajtjes së sistemeve mekatronike të aplikuara në sektorin komunal, transport apo pajisjet elektroshtëpiake;</i> <i>aftësia për të drejtuar kualifikimin apo edhe përgatitjen e teknikëve dhe kuadrove të ardhshëm në këtë fushë, pas një periudhe stazhi në profesion.</i> C) Studentët e diplomuar në programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri Mekatronike" mund të punësohen në: ➤ <i>ndërmarrje të mëdha, ku mund të futen sipas nevojës në grupe pune të ngarkuar me detyra të përcaktuara qartë;</i> ➤ <i>ndërmarrje të vogla private, ku mund të ngarkohen edhe me detyra drejtuese të administrimit të plotë të tyre;</i> ➤ <i>firma të ndryshme private të niveleve të ndryshme, të pajisura me sisteme automatike si: në industritë ushqimore etj.;</i> ➤ <i>firma të ndryshme, ku prodhohen pajisje dhe makineri të konsumit të gjerë, të kontrolluara elektronikisht apo me sisteme kontrolli automatik;</i> ➤ <i>në shkollat e mesme profesionale, etj.</i> Në këtë program studimi mundësohet transferimi në programe të ngjashme brenda dhe jashtë vendit, vazhdimi i studimeve në ciklin e dytë, si dhe punësimi i të diplomuarve në përputhje me fushën e

	studimit. Kjo arrihet nga fakti që elementët e veprimtarive formuese janë të shumta, të detajuara që përshtaten me çdo program që është ndërtuar sipas parimeve të Bolonjës. <i>[Evidencë 2.1.b Plani mësimor Bsc. IM – 04.2019];</i> <i>[Evidencë 2.1.a Kurrikula Bsc. IM – 04.2019].</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Institucioni AU ka në organigramë “Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave”, një strukturë që merret me përditësimin e kurrikulave. Departamenti i Inxhinierive angazhohet në përmirësimin e syllabuseve në përmbajtje dhe literaturë, brenda limitit 20% të lejuar, në përputhje me nevojat e tregut dhe zhvillimet teknologjike. Nga drejtuesit dhe vizita në bibliotekë GVJ konstatoi se në funksion të përditësimeve të syllabuseve pasurohet në vazhdimësi edhe Biblioteka e Departamentit. <i>[Evidencë: 2.7.a Rishikime syllabuse - v.a. 2021 - 2022];</i> <i>[Evidencë: 2.7.b Rishikime syllabuse - v.a. 2022 – 2023];</i> <i>[Evidencë: 2.7.c Rishikime syllabuse - v.a. 2023 – 2024];</i> <i>[Evidencë: 2.6 Procedura e rishikimit të kurrikulave PS Bachelor/2019];</i> <i>[Evidencë: 2.10 Komision rishikim kurrikule MP 2024];</i> <i>[Evidencë: 6.6 Rregullore Mbarëvajtja e kurrikulave/procesit mës në AU];</i> <i>[Evidencë: 2.8.b Kërkesë pasurimi i bibliotekës v.a. 2023 - 2024].</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Programi i studimit në dokumentat kurrikulare përmban mundësitë, shprehjet dhe kompetencat profesionale që programi i studimit garanton, përkatësisht: - aftësia për të zhvilluar veprimtarinë në institucione dhe firma të ndryshme ku ka sisteme mekatronike të aplikuara; - aftësia për të konceptuar dhe realizuar sisteme mekatronike të thjeshta; - aftësia për të zhvilluar veprimtari të drejtëpërdrejtë në industrinë e prodhimit; - aftësia për të ndërhyrë në drejtim të mirëmbajtjes së sistemeve mekatronike të aplikuara në sektorin komunal, transport apo pajisjet elektroshtëpiake; - aftësia për të drejtuar kualifikimin apo edhe përgatitjen e teknikëve dhe kuadrove të ardhshëm në këtë fushë, pas një periudhe stazhi në profesion. <i>[Evidencë 2.1.b Plani mësimor Bsc. IM – 04.2019];</i> <i>[Evidencë 2.1.a Kurrikula Bsc. IM – 04.2019].</i>

Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimit të studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Programi Bsc në IM ka një përmbajtje ku informacionet janë të harmonizuara si në fushën mekanike, elektrike dhe elektronike, duke i mundësuar studentëve që përfundojnë këtë program studimi vijimin e studimeve në Programe master në fushat e mësipërme. Studentët e diplomuar në programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Mekatronike” mund të punësohen në: ➤ ndërmarrje të mëdha, ku mund të futen sipas nevojës në grupe pune të ngarkuar me detyra të përcaktuara qartë; ➤ ndërmarrje të vogla private, ku mund të ngarkohen edhe me detyra drejtuese të administrimit të plotë të tyre; ➤ firma të ndryshme private të niveleve të ndryshme, të pajisura me sisteme automatike si: në industritë ushqimore etj.; ➤ firma të ndryshme, ku prodhohen pajisje dhe makineri të konsumit të gjerë, të kontrolluara elektronikisht apo me sisteme kontrolli automatik; ➤ në shkollat e mesme profesionale, etj. Nga takimi me studentët ato deklaruan se kishin dëshirë të punonin në ndërmarrje ku kërkohej shërbimi i tyre inxhinierik. [Evidencë 2.1.a Kurrikula Bsc. IM – 04.2019].
--	--

Konkluzione:

- ✓ *Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, Nivelin 6 të kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxëniet dhe vazhdimet të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.*
- ✓ *GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Mekatronike” ka emërtim që tregon përmbajtjen e tij si dhe qëllimin për të përgatitur studentët me bazat shkencore teoriko-praktike, të nevojshme për t’u integruar në tregun e punës. GVJ mendon gjithashtu se përgatitja e tyre hedh baza edhe për studime të mëtejshme në ciklin e dytë.*
- ✓ *Lëndët/modulet në planin mësimor, sasia e krediteve/orëve mësimore në dispozicion, temat mësimore në syllabuset e tyre mendojmë se realizojnë objektivat formuese dhe rezultatet e të nxëniet.*
- ✓ *Në këtë program studimi mundësohet transferimi në programe të ngjashme brenda dhe jashtë vendit, vazhdimi i studimeve në ciklin e dytë, si dhe punësimi i të diplomuarve në përputhje me fushën e studimit.*
- ✓ *Raporti teori-praktikë nëse i referohemi orëve mësimore apo krediteve, është përkatësisht: 42% me 58% dhe 57% me 43%, ku në kreditet /orët në praktikë, janë përfshirë seminare/ ushtrime/ laboratorë/ praktikë profesionale/ detyra/ projekte dhe punimi i diplomës.*
- ✓ *Institucioni AU ka në organigramë ‘Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave’, një strukturë që merret me përditësimin e kurrikulave. Departamenti i Inxhinierive angazhohet në përmirësimin e syllabuseve në përmbajtje dhe literaturë, brenda limitit 20% të lejuar, në përputhje me nevojat e tregut dhe zhvillimet teknologjike.*



- ✓ Programi i studimit në dokumentat kurrikulare përmban mundësitë, shprehitë dhe kompetencat profesionale që programi i studimit garanton.
- ✓ Programi Bsc në IM ka në përmbajtje harmonizim të fushës mekanike, elektrike dhe elektronike, duke i mundësuar studentëve që përfundojnë këtë program studimi vijimin e studimeve në Programe master në fushat e mësipërme.

Rekomandime/sugjerime:

- 1) GVJ e rivendos rekomandimin e dhënë nga Bordi i Akreditimit në vendimin e tij (2021), për të rritur numrin e orëve në auditor për leksione dhe seminare, për këtë program studimi, duke respektuar kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi, për të përmirësuar raportin 42% / 58% të ngarkesës në auditor përkundrejt ngarkesës jashtë auditorit.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Departamenti i Inxhinierive në mënyrë periodike zhvillon studimin e tregut të punës, në mënyrë që të përmirësojë kurrikulat e programeve të studimit të ofruara, në përputhje me kërkesat e tregut. Sipas Statutit të AU dhe Rregullores përkatëse pranë AU, veprojnë në funksion të Zhvillimit të Kurrikulave dhe procesit mësimor: (1) Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin; (2) Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave (3) Njësia e brendshme e sigurimit të cilësisë. Këto kanë dhe detyrën e sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë në programin e studimit. Institucioni përfshin edhe aktorë të tjerë në fushën e inxhinierisë mekatronike, për të ndjekur trendet më të fundit të teknologjisë dhe për të përditësuar programin në përputhje me nevojat e tregut. Në rishikimin e kurrikulave të Departamentit të Inxhinierive, në Grupin e Ekspertëve janë angazhuar edhe ekspertë të jashtëm nga biznesi. [Evidencë 2.10 Komision rishikim kurrikule MP 2024]; [Evidencë 6.7 Vlerësime specifike në fushën akademike të PS]; [Evidencë 2.9.a Raport mbi studimin e tregut - DI - Korrik 2019]; [Evidencë 2.9.b Raport mbi studimin e tregut - DI - Dhjetor 2021].
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me	Gjatë takimeve në institucion dhe nga informacioni në RVB Grupi i vlerësimit të jashtëm mësoi se Institucioni përfshin përfaqësuesit e Këshillit Studentor në strukturat vendimmarrëse të tij, si në mbledhjet e Departamentit, në mbledhjet e Senatit Akademik, që ata

studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	të bëhen pjesë e diskutimeve dhe konsultimeve për përmirësimin e programeve të studimit. Një nga mënyrat e vlerësimit të cilësisë së programit të studimit Bsc. në IM është edhe zhvillimi i pyetësorëve me studentët e tij (në çdo fund semestri), të cilët japin mendimin e tyre për ecurinë e programit të studimit, laboratorët, cilësinë e mësimdhënies, etikën e stafit akademik dhe administrativ, etj. GVJ u njoh me raportet e hartuara nga Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë, që analizojnë rezultatet e këtyre pyetësorëve. Gjithashtu institucioni organizon edhe diskutime me fokus grupe, të cilat përsëri merren në konsideratë për të përmirësuar këtë program studimi. Në fokus grupet që janë realizuar në 2023 studentët e inxhinierisë kanë kërkuar që ato të lejohen të punojnë individualisht në orët laboratorike. <i>[Evidencë 6.8.a Fokus Grupe - 2022];</i> <i>[Evidencë 6.8.b Fokus Grupe - 2023];</i> <i>[Evidencë 6.8.c Fokus Grupe - 2024];</i> <i>[Evidencë 6.9.a Rezultatet e pyet. të studentëve Sem.I 2021-2022];</i> <i>[Evidencë 6.9. b Rezultatet e pyet. të studentëve Sem.II 2021-2022];</i> <i>[Evidencë 6.9.c Pyetësorët e studentëve 2022-2023];</i> <i>[Evidencë 6.9.d Rezultatet e pyet. të studentëve Sem I 2023-2024];</i> <i>[Evidencë 6.9.e Rezultatet e pyet. për personelin akad 2023-2024].</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Institucioni përfshin aktorë të tjerë në fushën e inxhinierisë mekatronike, për të ndjekur trendet më të fundit të teknologjisë dhe për të përditësuar programin në përputhje me nevojat e tregut. Në rishikimin e kurrikulave të Departamentit të Inxhinierive, në Grupin e Ekspertëve janë angazhuar edhe ekspertë të jashtëm nga biznesi. <i>[Evidencë 2.10 Komision rishikim kurrikule MP 2024].</i>
Konkluzione ✓ <i>Albanian University ka përfshirë studentët dhe organizmat e tjera në përmirësimin e programit të studimit dhe realizimin e tij në përputhje me objektivat.</i> ✓ <i>Institucioni/Departamenti ndjek trendet e teknologjisë në përputhje me nevojat e tregut. Në rishikimin e kurrikulave të Departamentit të Inxhinierive, në Grupin e Ekspertëve janë angazhuar edhe ekspertë të jashtëm nga biznesi;</i>	



- ✓ Institucioni përfshin përfaqësuesit e Këshillit Studentor në strukturat vendimmarrëse të tij, si në mbledhjet e Departamentit, në mbledhjet e Senatit Akademik, që të bëhen pjesë e diskutimeve dhe konsultimeve për përmirësimin e programit/eve të studimit.
- ✓ Një nga mënyrat e vlerësimit të cilësisë së programit të studimit Bsc. në IM është edhe zhvillimi i pyetësorëve me studentët e tij (në çdo fund semestri), të cilët japin mendimin e tyre për ecurinë e programit të studimit, laboratorët, cilësinë e mësimdhënies, etikën e stafit akademik dhe administrativ, etj. GVJ u njoh me raportet e hartuara nga Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë, që analizojnë rezultatet e këtyre pyetësorëve.
- ✓ Gjithashtu institucioni organizon edhe diskutime me fokus grupe, të cilat përsëri merren në konsideratë për të përmirësuar këtë program studimi. Në fokus grupet që janë realizuar në 2023 studentët e inxhinierisë kanë kërkuar që të lejohen ato të punojnë individualisht në orët laboratorike.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1				
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Bazuar në planin mësimor, syllabusët dhe në vizitën në institucion, GVJ konstaton se programi i studimit është hartuar me forma mësimdhënie dhe mësimnxënie që përfshijnë: Leksione, Ushtrime, Seminare, Laboratorë, Detyra/ Projekte të kursit dhe Praktika profesionale.			
	Nga Tabela e planit mësimor konstatohet se në 3 vitet akademike, format e ndryshme të mësimdhënies/ngarkesa në orë mësimore janë të ndara në:			
	Format e mësimdhënies	Kredite	Orë në auditor / për 1 kredit	Orë në auditor gjithsej
	Leksione	103	7.5 orë	780
	Seminare	4	8 orë	32
	Ushtrime	41	15 orë	620
	Laboratore	14	23 orë	335

	<table><tr><td>Detyrë kursi/Projekte</td><td>8</td><td>2 orë</td><td>16</td></tr><tr><td>Praktika profesionale</td><td>4</td><td>20 orë</td><td>80</td></tr><tr><td>Provimi /Diploma</td><td>6</td><td>2 orë</td><td>12</td></tr><tr><td>Në total</td><td>180</td><td></td><td>1875</td></tr><tr><td>Orë jashtë auditorit</td><td></td><td></td><td>2625</td></tr></table>	Detyrë kursi/Projekte	8	2 orë	16	Praktika profesionale	4	20 orë	80	Provimi /Diploma	6	2 orë	12	Në total	180		1875	Orë jashtë auditorit			2625
Detyrë kursi/Projekte	8	2 orë	16																		
Praktika profesionale	4	20 orë	80																		
Provimi /Diploma	6	2 orë	12																		
Në total	180		1875																		
Orë jashtë auditorit			2625																		
	Raportet e orëve mësimore për çdo formë të mësimdhënies janë përcaktuar me Vendim Senati në 2021. Institucioni dhe Departamenti i Inxhinierive ka organizuar, leksione të hapura, Konferenca shkencore me pjesëmarrjen e studentëve dhe vizita në institucione. Vizitat janë kryer pranë qendrave industriale të cilat kanë të integruara sisteme mekatronike, si Teci i Vlorës. <i>[Evidencë: R.4.b Miratim orë për ECTS - programe DI /VSA. 13, 2021];</i> <i>[Evidencë: 3.8.a Axhenda - Konferenca e III - IIST - 2021];</i> <i>[Evidencë: 3.8.b Axhenda - Konferenca e IV - IIST - 2022];</i> <i>[Evidencë: 3.8.c Axhenda - Konferenca e V - IIST - 2023];</i> <i>[Evidencë: 3.9.a Poster Forumi Studentor “Transformimi digjital në kohën e sfidave” /2021];</i> <i>[Evidencë: 3.9.b Programi Forumi II Studentor “Transformimi digjital në kohën e sfidave” /2022].</i>																				
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Nga takimi me stafin akademik të programit të studimit, GVJ konstatoi se pedagogët respektonin syllabuset që i përmbanin të gjithë format e mësimdhënies. Përveç tyre ato përpiqeshin të implementonin edhe forma të tjera si vizitat në ndërrmarje të ndryshme, materiale didaktike nga interneti, për t’a bërë lëndën sa më të kuptueshme dhe të qartë për studentin. Edhe nga takimi me studentët u konfirmua se personeli akademik ndihmon në lehtësimin për vështirësitë e mësimnxënies. <i>[Evidencat: 3.4.a. b. c. d. e. Vizita TEC Vlorë 2019 – 2024];</i> <i>[Evidencë 3.4.f. Udhëzues video për platformën Microsoft Teams].</i>																				
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	GVJ mbështetur në RVB, dokumentacionin shoqërues dhe në takimet me sta fin dhe drejtuesit konstaton se NJSBC organizon trajnime në kuadër të mësimdhënies, për rezultatet e pritshme të të nxënit, metodat e vlerësimit të studentëve. Këto aktivitete kanë qëllim të përmirësojnë kompetencat didaktike, pedagogjike të stafit akademik të rekrutuar																				

	dhe me pak përvojë në mësimdhënie. Këto trajnime realizohen në çdo fillim të vitit akademik. Megjithatë, në CV e asistent/ pedagogëve mungojnë të dhëna për trajnime në fushën e pedagogjisë, didaktikës që stafi akademik ka kryer. Pra trajnimet mund të jenë kryer, por ato nuk janë reflektuar në CV e tyre. <i>[Evidencë: 3.1.a Axhenda e trajnimeve të stafit ak 2021-2022];</i> <i>[Evidencë: 3.1.b Axhenda e trajnimeve të stafit ak 2022-2023];</i> <i>[Evidencë: 3.1.c Axhenda e trajnimeve të stafit ak 2023-2024].</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Për kompetencën në mësimdhënie dhe aftësinë për të nxitur mendimin krijues GVJ ju referua CV-ve të PAE dhe PAK. Nga këto dokumenta rezulton se CV e pedagogëve janë të plota dhe japin të gjithë aftësitë e tyre në profesion. Shumica e tyre kanë shumë vite eksperiencë në mësimdhënie, apo në drejtim të strukturave akademike (Departament/ Fakultet/ apo Universitet). Në RVB dhe në takimin me stafin akademik GVJ konstaton se Personeli akademik i angazhuar pranë Departamentit të Inxhinierive dhe programit Bsc. në IM, ofron cilësi në mësimdhënie, duke ndërthurur njohuritë teorike të leksioneve dhe seminareve me ato praktike, përmes simulimeve dhe eksperimenteve në laboratorë. Gjithashtu përmes përdorimit të platformës online Microsoft Teams pedagogët venë në dispozicion të studentëve materiale të ndryshme mësimore, teste vetëvlerësuese, detyra kursi, etj, duke nxitur studentët të studiojnë vazhdimisht. Në orët e seminareve/ ushtrimeve dhe laboratorëve, punohet me në qendër studentët, që nxisin autonominë e studentit, të zgjidhë probleme të ndryshme inxhinierike në fushën e tij specifike të studimit, duke i aftësuar ata për punë. Edhe në takimin me studentët ato theksuan aftësitë mësimdhënëse të pedagogëve të tyre. <i>[Evidencë: 4.2 CV stafi akademik Bsc. IM - v.a 2023 - 2024];</i> <i>[Evidencë: 3.2 Klasat Microsoft Teams - Dep i Inxhinierive];</i> <i>[Evidencë: 3.3 Shembull pyetësori në MF - Bsc. IM - Sem. I];</i> <i>[Evidencë: 3.4.a Manual për mësimin online 2020 - 2021].</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe	Departamenti i Inxhinierive nxit pedagogët që të përmirësojnë vazhdimisht mësimdhënien, nëpërmjet përmirësimit të formave të mësimdhënies, përveç atyre tradicionale. Siç është shkruar edhe në Kriterin 2 Standardi 2.5, GVJ konstatoi se Institucioni përfshin përfaqësuesit e Këshillit Studentor në strukturat vendimmarrëse të tij, si në mbledhjet e Departamentit, në



duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	mbledhjet e Senatit Akademik, që të bëhen pjesë e diskutimeve dhe konsultimeve për përmirësimin e programeve të studimit. Një nga mënyrat e vlerësimit të cilësisë së programit të studimit Bsc. në IM është edhe zhvillimi i pyetësorëve me studentët e tij (në çdo fund semestri), të cilët japin mendimin e tyre për ecurinë e programit të studimit dhe për format e mësimdhënies. Studentët shprehin mendimet e tyre mbi procesin mësimor dy herë në vit, në fund të çdo semestri, përmes pyetësorëve të organizuar online në Microsoft Forms duke ruajtur anonimitetin. GVJ u njoh me raportet e hartuara nga Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë, që analizojnë rezultatet e tyre. Gjithashtu edhe në diskutimet me fokus grupe, diskutohen edhe format e mësimdhënies, për t'i përmirësuar dhe pasuruar. Në fokus grupet që janë realizuar në 2023 studentët e inxhinierisë kanë kërkuar që të lejohen ato të punojnë individualisht në orët laboratorike. <i>[Evidencat 6.8. a. b. c. Fokus Grupe (2022-2024)];</i> <i>[Evidencat 6.9. a. b. c. d. Rezultatet e pyetësorëve të studentëve (2021-2024)];</i> <i>[Evidencë 6.9.e Rezultatet e pyet. për personelin akad 2023-2024].</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Bazuar në Statutin e Universitetit janë ngritur dhe funksionojnë këto struktura: 1. Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin 2. Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave 3. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë Institucioni përmes këtyre strukturave mbështet Departamentin e Inxhinierive dhe stafin akademik në zhvillimin e metodave bashkëkohore në mësimdhënie, siç është edhe mësimi online. Institucioni ka zhvilluar trajnime të ndryshme për përdorimin e instrumenteve informatikë në funksion të mësimdhënies dhe ka përgatitur udhëzues të ndryshëm të vënë në dispozicion të pedagogëve dhe studentëve. Edhe në Kriterin 3 më lart kemi theksuar se NJSBC organizon trajnime në kuadër të mësimdhënies, për rezultatet e pritshme të të nxënit, metodat e vlerësimit të studentëve. Këto aktivitete kanë qëllim të përmirësojnë kompetencat didaktike, pedagogjike të stafit akademik të rekrutuar dhe me pak përvojë në mësimdhënie. Këto trajnime realizohen në çdo fillim të vitit akademik. <i>[Evidencë 1.3, Statuti i AU, neni 25, 67];</i> <i>[Evidencë 1.4, Rregullore e AU, nenet 14, 15, 16];</i> <i>[Evidencë 2.6 Procedura e rishikimit të kurrikulave PS Bachelor - 04.2019];</i>



	[Evidencë 6.6 Rregullore për mbarëvajtjen e kurrikulave dhe procesit mësimor në AU]; [Evidencë 3.4.a Manual për realizimin e mësimi online 2020 - 2021]; [Evidencë 3.4.c Udhëzues video për përdorimin e platformës Microsoft Teams].
--	---

Konkluzione

- ✓ AU ka garantuar në procesin e të nxënës, metodat dhe praktikën me të qendrë studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve, aftësimin profesional e shkencor të studentëve; Programi i studimit është hartuar me formë mësimdhënie dhe mësimnxënie që përfshijnë: Leksione, Ushtrime, Seminare, Laboratore, Detyra/ Projekte të kursit dhe Praktika profesionale.
- ✓ Raportet e orëve mësimore për çdo formë të mësimdhënies janë përcaktuar me Vendim Senati në 2021.
- ✓ GVJ konstatoi se pedagogët përpqeshin të implementonin edhe formë të tjera si vizitat në ndërrmarje të ndryshme, materiale didaktike nga interneti, për t'a bërë lëndën sa më të kuptueshme dhe të qartë për studentin.
- ✓ NJSBC organizon trajnime në kuadër të mësimdhënies, për rezultatet e pritshme të të nxënës, metodat e vlerësimit të studentëve. Këto aktivitete kanë qëllim të përmirësojnë kompetencat didaktike, pedagogjike të stafit akademik të rekrutuar dhe me pak përvojë në mësimdhënie.
- ✓ Personeli akademik i angazhuar pranë programit Bsc. në IM, ofron cilësi në mësimdhënie, duke ndërthurur njohuritë teorike të leksioneve dhe seminareve me ato praktike, përmes simulimeve dhe eksperimenteve në laboratorë;
- ✓ Një nga mënyrat e vlerësimit të cilësisë së programit të studimit Bsc. në IM është edhe zhvillimi i pyetësorëve me studentët e tij (në çdo fund semestri), të cilët japin mendimin e tyre për ecurinë e programit të studimit, dhe për format e mësimdhënies.
- ✓ Bazuar në Statutin e Universitetit janë ngritur dhe funksionojnë këto struktura:
 - 1) Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin
 - 2) Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave
 - 3) Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë


Institucioni përmes këtyre strukturave mbështet Departamentin e Inxhinierive dhe stafin akademik në zhvillimin e metodave bashkëkohore në mësimdhënie, siç është edhe mësimi online.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në	GVJ konstaton se institucioni nëpërmjet, Rregullores së FSHAE, Rregullores së Departamentit të Inxhinierive dhe Rregullores së programit të studimit ka standardizuar vlerësimin e njohurive tek studentët.



Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<u>Në nenin 38 të Rregullores së FSHAE shkruhet:</u> 1. Në syllabusin e çdo lënde përcaktohen dhe dispijlohen format e ndryshme të kontrollit të njohurive, të cilat [...]. 2. Në sesionin e parë provimi përfundimtar i lëndës ka 60 pikë, në seksionet e tjera provimi ka 100 pikë. <u>Në nenin 22 të Rregullores së Departamentit shkruhet:</u> Mësimdhënia përfshin larmi formash të mësimi dhe kontrollit të dijeve përmes raporteve të caktuara, të parashikuara në planet mësimore, programet e lëndëve, dhe rregulloren mësimore të çdo programi studimi. <u>Në nenin 24 të Rregullores së Programit të Studimit shkruhet:</u> “Vlerësimi i njohurive të studentit (notës përfundimtare) mbështetet në vlerësimin gjatë gjithë zhvillimit të lëndës, ku nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të elementëve të mëposhtëm: ➤ Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive në seminare, punë laboratorike, detyra/projekte kursi 20 pikë (20%). ➤ Provimi i ndërmjetëm 20 pikë (20%), ➤ Provimi përfundimtar 60 pikë (60%), - Specifikime më të detajuara, në përputhje me përmbajtjen e çdo lënde jepen në syllabuset e lëndëve. - Vlerësimi i tezës së provimit përfundimtar është pjesë e vlerësimit përfundimtar. Vlerësimi përfundimtar bëhet pas përfundimit të procesit të korrigjimit të provimit, si dhe pas mbledhjes së rezultateve të grumbulluara nga studenti përgjatë semestrit (seminare/ ushtrime, testim përgjatë semestrit, laboratore, detyra ose projekte kursi, etj.), nën përgjegjësinë e titullarit të lëndës. - Shkalla e vlerësimit për përvetësimin e dijes nga studentët bëhet sipas sistemit me note (notat 4 deri 10), me pikë ose me përqindje (100 pikë ose 100%) dhe me shkronja (sistemi ECTS me shkronjat nga A deri F). Studenti, i cili në përfundim të vitit akademik nuk merr 50% të lëndëve (së bashku me sesionin e vjeshtës), nuk kalon në vitin akademik pasardhës, por mbetet në stazh. Në çdo syllabus është zbatuar kjo pikë e rregullores. [Evidencë 1.3 Rregullore Albanian University]; [Evidencë 1.6 Rregullore FSHAE - 20.04.2022]; [Evidencë 2.3 Rregullore Departamenti - VS. 20 - 30.07.2021]; [Evidencë Syllabuset e lëndëve/moduleve (42 syllabuse)].
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët	Nga RVB, nga takimet me stafin dhe studentët, GVJ konstaton se Departamenti merr masa që studentët të njihen me format e



informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/ modulit.	vlerësimit që në orët e para të mësimet. Kjo realizohet nga pedagogët e lëndës, gjatë njohjes me përmbajtjen/syllabusin e saj.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Nga vëzhgimi i GVJ del se në çdo syllabus është zbatuar rregullorja e Programit, në tre forma: <u>Forma 1</u> > Pjesëmarrja dhe aktivizimi në orët e ushtrimeve 5% > Dorëzimi i detyrës së kursit 5% > Vlerësimi dhe pjesëmarrja në laboratorë 10% > Provimi i ndërmjetëm/Moduli 20% > Provimi përfundimtar 60% <u>Forma 2</u> > Pjesëmarrja dhe aktivizimi në orët e ushtrimeve 10% > Vlerësimi dhe pjesëmarrja në laboratorë 10% > Provimi i ndërmjetëm/Moduli 20% > Provimi përfundimtar 60% <u>Forma 3</u> > Pjesëmarrja dhe aktivizimi në orët e ushtrimeve 20% > Provimi i ndërmjetëm/Moduli 20% > Provimi përfundimtar 60% Këto forma i japin mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. <i>[Evidencë Syllabuset e lëndëve/moduleve (42 syllabuse)].</i>
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Departamenti i Inxhinierive nxit pedagogët që të përmirësojnë vazhdimisht mësimdhënien, nëpërmjet përmirësimit të formave të mësimdhënies, përveç atyre tradicionale. Siç është shkruar edhe në Kriterin 2 Standardi 2.5 dhe në Kriterin 5, Standardi 3.1, GVJ konstatoi se Institucioni përfshin përfaqësuesit e Këshillit Studentor në strukturat vendimmarrëse të tij, si në mbledhjet e Departamentit, në mbledhjet e Senatit Akademik, që të bëhen pjesë e diskutimeve dhe konsultimeve për përmirësimin e programeve të studimit. Një nga mënyrat e vlerësimit të cilësisë së programit të studimit Bsc. në IM është edhe zhvillimi i pyetësorëve me studentët e tij (në çdo fund semestri), të cilët japin mendimin e tyre për ecurinë e programit të studimit dhe për format e mësimdhënies. Studentët shprehin mendimet e tyre mbi procesin mësimor dy herë në vit, në fund të çdo semestri, përmes pyetësorëve të organizuar online në Microsoft Forms, duke ruajtur anonimitetin. GVJ u njoh me raportet e hartuara

	nga Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë, që analizojnë rezultatet e tyre. Gjithashtu edhe në diskutimet me fokus grupe, diskutohen edhe format e mësimdhënies, për t'i përmirësuar dhe pasuruar. Në fokus grupet që janë realizuar në 2023 studentët e inxhinierisë kanë kërkuar që të lejohen ato të punojnë individualisht në orët laboratorike. [Evidencë: 6.8.a Fokus Grupe - 2022]; [Evidencë: 6.8.b Fokus Grupe - 2023]; [Evidencë: 6.8.c Fokus Grupe - 2024]; [Evidencë: 6.9.a Rezultatet e pyetësorëve të st. Sem.I 2021-2022]; [Evidencë: 6.9. b Rezultatet e pyetësorëve të student. Sem.II 2021-2022]; [Evidencë: 6.9.c Pyetësorët e studentëve 2022-2023]; [Evidencë: 6.9.d Rezultatet e pyetësorit të stud Sem I 2023-2024]; [Evidencë: 6.9.e Rezultatet e pyetësorit për pers akad 2023-2024].
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Shumëllojshmëria e metodave të mësimdhënies së pari është vendosur në syllabuset e lëndëve; Së dyti pedagogët kanë gjetur edhe metoda të tjera për studentët e këtij programi studimi, të cilët kanë kryer vizita me interes për formimin e tyre profesional, të tilla si Vizita në TEC-in e Vlorës si dhe leksione të hapura, etj. Së treti, siç deklarohet në RVB: <i>Institucioni përmes postës elektronike zyrtare ofron mundësinë e përdorimit të platformës Office 365, duke vënë në dispozicion të stafit dhe studentëve infrastrukturën e nevojshme për përdorimin e instrumenteve informatikë për rritjen e cilësisë në mësimdhënie.</i> Aktivitetet mësimdhënëse të shumëllojshme nxisin autonominë e studentit, hap pas hapi, derisa është në gjendje të zgjidhë probleme të ndryshme inxhinierike në fushën e tij specifike të studimit në formë të pavarur. [Evidencë: 3.4.a. Vizita TEC Vlorë 2019 – 2020]; [Evidencë: 3.4.b. Vizita TEC Vlorë 2020 – 2021]; [Evidencë: 3.4.c. Vizita TEC Vlorë 2021 – 2022]; [Evidencë: 3.4.d. Vizita TEC Vlorë 2022 – 2023]; [Evidencë: 3.4.e. Vizita TEC Vlorë 2023 – 2024]; [Evidencë: 3.4.f. Udhëzues video për platformën Microsoft Teams].
Konkluzione ✓ <i>Institucioni ka hartuar rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</i> ✓ <i>AU nëpërmjet: Rregullores së FSHAE, Rregullores së Departamentit të Inxhinierive dhe Rregullores së programit të studimit ka standardizuar vlerësimin e njohurive tek studentët.</i> ✓ <i>Në Rregullores së Programit të Studimit shkruhet (neni 24):</i>	

"Vlerësimi i njohurive të studentit (notës përfundimtare) mbështetet në vlerësimin gjatë gjithë zhvillimit të lëndës, ku nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të elementëve të mëposhtëm:

- *Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive në seminare/punë laboratorike/detyra/projekte kursi 20 pikë (20%).*
- *Provimi i ndërmjetëm 20 pikë (20%).*
- *Provimi përfundimtar 60 pikë (60%)*

✓ *Pika e parë varet nga lloji i lëndës dhe gjendet në tre forma:*

Forma 1

- *Pjesëmarrja dhe aktivizimi në orët e ushtrimeve 5%*
- *Dorëzimi i detyrës së kursit 5%*
- *Vlerësimi dhe pjesëmarrja në laboratorë 10%*

Forma 2

- *Pjesëmarrja dhe aktivizimi në orët e ushtrimeve 10%*
- *Vlerësimi dhe pjesëmarrja në laboratorë 10%*

Forma 3

- *Pjesëmarrja dhe aktivizimi në orët e ushtrimeve 20%*

✓ *Specifikime më të detajuara, jepen në syllabuset e lëndëve. Shkalla e vlerësimit për përvetësimin e dijes nga studentët bëhet sipas sistemit me notë (notat 4 deri 10), me pikë ose me përqindje (100 pikë ose 100%) dhe me shkronja (sistemi ECTS me shkronjat nga A deri F).*

✓ *Studenti, i cili në përfundim të vitit akademik nuk merr 50% të lëndëve (së bashku me sesionin e vjeshtës), nuk kalon në vitin akademik pasardhës, por mbetet në stazh.*

✓ *Departamenti i Inxhinierive nxit pedagogët që të përmirësojnë vazhdimisht mësimdhënien, nëpërmjet përmirësimit të formave të mësimdhënies, përveç atyre tradicionale.*

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga vizita në Institucion, takimi me drejtuesit dhe vizita në sekretarinë mësimore GVJ konstatoi se testimi/vlerësimi i njohurive teorike dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik (40%) dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar së bashku me Provimin përfundimtar (60%), sipas formulës së mesatares së ponderuar. Pedagogët mbajnë të dhëna të detajuara për çdo student dhe në fund të lëndës dorëzojnë në sekretari tabelën përmbledhëse të vlerësimit, ku secili element i vlerësimit. Sipas rregullores së programit [cit]:

	Pika 16. Në fletën e provimit pasqyrohet vlerësimi i plotë i studentit në atë lëndë; së bashku me fletën e provimit pedagogu dorëzon në Sekretarinë Mësimore edhe tabelën shoqëruese të vlerësimeve gjithëvjetrore (procesverbalin paraprak) të dijeve të studentëve sipas syllabusit të lëndës. Fleta e provimit shoqëruar me pasqyrimin e vlerësimit gjithëvjetor përbën dokumentin zyrtar që vërteton dhënien e provimit dhe vlerësimin e plotë vjetor (semestral) të studentit. Në përmbajtjen e saj nuk duhet të ketë asnjë korigjim. Kjo tabelë diskutohet edhe me studentët përpara dorëzimit, për transparencë. <i>[Evidencë: Syllabuset e lëndëve/moduleve (42 syllabuse)].</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Provimet /testimet elektronike nuk janë pjesë e sistemit në këtë program studimi. GVJ konstatoi se me përdorimin e sekretarisë online Pitagora, studentët njihen me rezultatet e provimeve përmes këtij soft-i, individualisht. Për të shmangur abuzimin dhe për të rritur transparencën tezat e provimeve përfundimtare sekretohen dhe pas korigjimit nga pedagogu/ët e lëndës, hapet barkodi në Departament. <i>[Evidencë: H.1 Rregullore mësimore Bsc. IM - 03.2019].</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Nga vizita në Institucion, takimi me drejtuesit dhe vizita në sekretarinë mësimore GVJ konstatoi se testimi/vlerësimi i njohurive teorike dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik (40%) dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar së bashku me Provimin përfundimtar (60%). Provimi përfundimtar i lëndës bëhet duke u mbështetur në bazën ligjore në fuqi dhe vlerësimi përfundimtar i studentit bëhet sipas formulës së mesatares së ponderuar. <i>[Evidencë: H.1 Rregullore mësimore Bsc. IM - 03.2019];</i> <i>[Evidencë: Syllabuset e lëndëve/moduleve (42 syllabuse)].</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Nga takimet me stafin dhe drejtuesin e departamentit GVJ konstatoi se pedagogët përmes metodave të ndryshme të vlerësimit të studentëve, nxisin procesin e nxënies dhe vetëkorigjimit tek ata. Në orët e ushtrimeve dhe orët laboratorike pedagogët ndjekin punën e studentëve dhe vlerësimin në shumë raste e bëjnë duke përfshirë studentët e tjerë. Në nenin 23 të Rregullores së PS jepen detaje për vlerësimin e provimeve dhe feedback-ut që studenti mund të marrë [cit]:

	1. [Pas] Vlerësimi i provimeve bëhet i njohur studentëve nëpërmjet sekretarisë mësimore të programit të studimit përkatës. Teza e provimit duhet të përmbajë përveç vlerësimit dhe firmën e pedagogut apo pedagogëve që e kanë korrigjuar. 2. Studenti ka të drejtë të njihet me tezën e provimit pas korrigjimit pasi të bëhet edhe ç'sekretimi i tyre. <i>Ai ka të drejtë të njihet me pikët totale të vlerësimit në tezë si dhe me pikët në çdo rubrikë.</i> Nëse studenti konstaton se ka rubrika të pakorrigjura apo pikë të pallogaritura në vlerësimin total, ai ka të drejtë të reklamojë provimin në një kërkesë me shkrim, e cila depozitohet pranë sekretarisë mësimore të programit të studimit përkatës, brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve. 3. Pas reklamimit të provimit nga ana e studentit për arsyet e përmendura më lart, Dekani i Fakultetit përkatës ngre një komision <i>ad hoc</i> në përbërjen e të cilit bëjnë pjesë edhe pedagogët të cilët kanë korrigjuar provimet. <i>[Evidencë: H.1 Rregullore mësimore Bsc. IM - 03.2019];</i> <i>[Evidencë: Syllabuset e lëndëve/moduleve (42 syllabuse)].</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	GVJ konstaton se Departamenti ka në Rregulloren e programit nenin 21 dhe nenin 22 që rregullojnëurvejimin e provimit dhe sanksionojnë veprimet e ndaluara nga studentët gjatë provimit [cit]. 1. Gjatë provimit nuk lejohet përdorimi i materialeve që gjykohen të papërshtatshme nga pedagogu i lëndës përkatëse, i cili përpara fillimit të provimit ose në tezën e provimit citon materialet që lejohen të përdoren gjatë kohës së zhvillimit të provimit; 2. Çdo përdorim ose mbajtje e materialeve përveç atyre të lejuara sjell përjashtim të studentit nga provimi dhe pavlefshmëri të tezës së provimit, në të cilën bëhet shënimi përkatës. Përsa i përket temave të diplomave, pas përzgjedhjes nga ana e studentit, në bashkëpunim me udhëheqësin, departamenti bën kontrollin e saj në bazën e të dhënave të departamentit dhe më pas konfirmon zhvillimin e saj nga studenti. <i>[Evidencë: H.1 Rregullore mësimore Bsc. IM - 03.2019];</i> <i>[Evidencë 3.5.a, b. Shembull Procedurë Diplome Bsc. IM 22-23].</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	GVJ konstaton se Departamenti ka në Rregulloren e programit nenin 23 që rregullon afatet kohore të korrigjimit të provimeve [cit]. 1. Korrigjimi i provimeve bëhet nën përgjegjësinë e një pedagogu titullar brenda 7 ditësh nga dita e përfundimit të provimit. 2. Pas korrigjimit, provimet depozitohen pranë departamentit ku bëhet ç'sekretimi i tezës. Vlerësimi i provimeve bëhet i njohur

	studentëve nëpërmjet sekretarisë mësimore të programit të studimit përkatës. Teza e provimit duhet të përmbajë përveç vlerësimit dhe firmën e pedagogut apo pedagogëve që e kanë korrigjuar. Nga takimi me studentët ato ishin të kënaqur me zbatimin e rregullores për afatet e provimeve dhe vlerësimin e pedagogëve. <i>[Evidencë: H.1 Rregullore mësimore Bsc. IM - 03.2019];</i> <i>[Evidencë: Syllabuset e lëndëve/moduleve (42 syllabuse)].</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Në nenin 23 të Rregullores së PS jepen garantimi i të drejtës së studentit për t'u njohur me vlerësimin e pedagogut, apo rishikimin e vlerësimit [cit]. 1. [.....] 2. Pas korrigjimit, provimet depozitohen pranë departamentit ku bëhet ç'sekretimi i tezës. Vlerësimi i provimeve bëhet i njohur studentëve nëpërmjet sekretarisë mësimore të programit të studimit përkatës. Teza e provimit duhet të përmbajë përveç vlerësimit dhe firmën e pedagogut apo pedagogëve që e kanë korrigjuar. 3. Studenti ka të drejtë të njihet me tezën e provimit pas korrigjimit pasi të bëhet edhe ç'sekretimi i tyre. Ai ka të drejtë të njihet me pikët totale të vlerësimit në tezë si dhe me pikët në çdo rubrikë. Nëse studenti konstaton se ka rubrika të pakorrigjura apo pikë të pallogaritura në vlerësimin total, ai ka të drejtë të reklamojë provimin në një kërkesë me shkrim, e cila depozitohet pranë sekretarisë mësimore të programit të studimit përkatës, brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve. 4. Pas reklamimit të provimit nga ana e studentit për arsyet e përmendura më lart, Dekani i Fakultetit përkatës ngre një komision <i>ad hoc</i> në përbërjen e të cilit bëjnë pjesë edhe pedagogët të cilët kanë korrigjuar provimet. <i>[Evidencë: H.1 Rregullore mësimore Bsc. IM - 03.2019];</i> <i>[Evidencë 3.6 Format kërkesë për rishikimin e tezës].</i>
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Në nenin 23 të Rregullores së PS jepen garantimi i të drejtës së studentit për ankimim, apo rishikimin e vlerësimit, për shqyrtimin e të cilit ka një procedurë të përcaktuar [cit]. 1. [.....] 2. [.....] 3. [.....] 4. Pas reklamimit të provimit nga ana e studentit për arsyet e përmendura më lart, Dekani i Fakultetit përkatës ngre një

	komision <i>ad hoc</i> në përbërjen e të cilit bëjnë pjesë edhe pedagogët të cilët kanë korrigjuar provimet. [Evidencë: H.1 Rregullore mësimore Bsc. IM - 03.2019]; [Evidencë 3.6 Format kërkesë për rishikimin e tezës].
--	---

Konkluzione

- ✓ Institucioni siguron vlerësim bazuar në meritën e çdo studenti, duke përfshirë dhe procesin e ankimit.
- ✓ Testimi/vlerësimi i njohurive teorike dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik (40%) dhe reflektohet edhe në vlerësimin përfundimtar së bashku me Provimin përfundimtar (60%), sipas formulës së mesatares së ponderuar.
- ✓ Së bashku me fletën e rezultateve të provimit pedagogu dorëzon në Sekretarinë Mësimore edhe tabelën shoqëruese të vlerësimeve gjithëvjetoje të dijeve të studentëve, sipas syllabusit të lëndës.
- ✓ Provimet /testimet elektronike nuk realizohen në këtë program studimi. GVJ konstatoi se me përdorimin e sekretarisë online (soft-i Pitagora), studentët njihen me rezultatet individuale të provimit përmes. Për të shmangur abuzimin dhe për të rritur transparencën tezat e provimeve përfundimtare sekretohen nga sekretaria.
- ✓ Provimi përfundimtar i lëndës mbështetet në bazën ligjore në fuqi. Vlerësimi përfundimtar i studentit bëhet sipas formulës së mesatares së ponderuar.
- ✓ Pedagogët përmes metodave të ndryshme të vlerësimit të studentëve, nxisin mësimnxënien dhe vetëkorrigjimin tek ata. Në orët e ushtrimeve dhe orët laboratorike pedagogët udhëheqin punën e studentëve dhe në shumë raste vlerësimin e bëjnë duke përfshirë studentët e tjerë.
- ✓ Në Rregulloren e PS, [neni 21, 22] rregulloheturvejimi i provimit dhe sanksionohen veprimet e ndaluara gjatë provimit nga studentët, si dhe afatet kohore të korrigjimit të provimeve nga pedagogu.
- ✓ Rregullorja e PS [neni 23] garanton të drejtën e studentit për ankimim, apo rishikimin e vlerësimit, për shqyrtimin e të cilit ka një procedurë të përcaktuar.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësi të profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Institucioni në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies, ka ngritur strukturat përkatëse, të cilat janë: Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave, si dhe Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin.

	Praktikat më të mira, që evidentohen gjatë analizës mësimore, u bëhen të ditur të gjitha njësive bazë nëpërmjet një raporti që hartohet nga NJSBC. GVJ konstaton se program i studimit Bachelor në “Inxhinieri Mekatronike” është hartuar t’u ofrojë studentëve (1) njohuri të karakterit shkencor të mbështetura në lëndë të formimit bazë; (2) njohuri në fushën e inxhinierisë elektrike, (3) njohuri në fushën e inxhinierisë elektronike dhe (4) njohuri në fushën e inxhinierisë mekanike. Sfida e këtij program është harmonizimi i këtyre tre fushave, që edhe në teknologjinë e zbatuar i gjen të harmonizuara. Prandaj mendojmë se kjo kurrikulë është një bazë që duhet plotësuar duke ndjekur ciklin e dytë të studimit (Master i shkencave ose Master Profesional). Gjithashtu ky program synon t’u përgjigjet kërkesave të formimit profesional, për tregun e punës, në mënyrë që studentët të zotërojnë aftësitë analitike për të trajtuar problematika të ndryshme inxhinierike. Përmirësimi i programit me rekomandimet/sugjerimet e dhëna në këtë Raport në Standardin II.3 (më lart) do të forconte këtë program në drejtim të thellimit të mëtejshme të njohurive. <i>[Evidencë: 1.2 Statuti Albanian University];</i> <i>[Evidencë: 1.3 Rregullore Albanian University].</i> <i>[Evidencë: H.1 Rregullore mësimore Bsc. IM - 03.2019].</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Mekatronike” është një program i formimit inxhinierik ku studentët zhvillojnë aftësi të veçanta në fushat e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, sepse: a) marrin njohuri në fushën e teknologjisë së informacionit, në lëndët përkatëse, për shkak të vetë natyrës së programit të studimit si program inxhinierik. b) Studentët në vitin e parë të studimeve, zhvillojnë lëndën “Gjuhë e huaj” me 8 ECTS, në të cilën thellojnë dhe pasurojnë njohuritë e tyre në gjuhën angleze. c) Detyrat e kursit, që zhvillohen në lëndët inxhinierike, rrisin aftësitë komunikuese dhe ndërvepruese të studentëve, punën në grup dhe aftësitë të paraqitjes së një projekti. <i>[Evidencë: 2.1.a Kurrikula Bsc. IM – 04.2019];</i> <i>[Evidencë: 2.1.b Plani mësimor Bsc. IM – 04.2019].</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e	GVJ mbështetur në RVB dhe në Dosjen e dokumentave dhe në takimin me stafin akademik konstaton se kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, gjatë lëndëve që zhvillohen në semestër, janë të



studimit dhe syllabuset e çdo lëndë, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	përkthyer në syllabuset e tyre, tek objektivat dhe kompetencat që lënda synon në përfundim të saj. Këto aftësi dhe kompetenca, që fitojnë studentët: a) Vlerësohen gjatë gjithë lëndës (me anë të vlerësimit të vazhduar të studentëve - shih më lart) b) Përforcohen në orët e ushtrimeve, orët laboratorike, apo detyrat e kursit; c) Në fund të lëndës, bëhet një përmbledhje e argumenteve kryesorë, për të ndihmuar studentët në përgatitjen për provimin përfundimtar. d) Në fund të çdo semestri, stafi akademik harton raportin semestral, në të cilin raporton për realizimin e objektivave të mësimdhënies. <i>[Evidencë: Tabela Aneks RVB Bsc. IM - model syllabusi];</i> <i>[Evidencë: 3.7.a Shembull raporti semestral PAE - BSc];</i> <i>[Evidencë: 3.7.b Shembull raporti semestral PAK - BSc].</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	GVJ konstaton se kurrikula e programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri Mekatronike" është hartuar duke ndërthurur orët teorike në auditor me orët praktike në laboratorë, dhe praktikën mësimore. Për nxitjen e punës në grup, një pjesë e detyrave të kursit organizohen në grupe studentësh për të nxitur debatin, vetëkorrigjimin, aftësinë në ndarjen e detyrave, ballafaqimin e rezultateve dhe diskutimin e tyre. Institucioni vë në dispozicion laboratorët për realizimin e ideve novatore të studentëve. Gjatë viteve të fundit janë organizuar konferenca studentore dhe publikime në revistën e universitetit "Optime" https://albanica.al/optime/ dhe stafi akademik ka ndihmuar dhe nxitur studentët për të marrë pjesë në to. Departamenti i Inxhinierive ka zhvilluar bashkëpunime në kuadër të programeve Erasmus+ dhe CEEPUS, që kontribuojnë në rritjen e mobiliteteve dhe shkëmbimin e eksperiencave me Institucionet partnere kombëtare dhe ndërkombëtare. Universiteti AU është pjesë e projektit INNOVET Living Labs, financiar nga GIZ. Në kuadër të këtij projekti studentë të Inxhinierisë Mekatronike kanë realizuar disa punime novatore në bashkëpunim me nxënës të shkollës "Beqir Çela" dhe kanë zhvilluar disa vizita të ndërsjella në laboratorët eksperimentalë të secilit prej institucioneve. <i>[Evidencë: 2.1.a Kurrikula Bsc. IM – 04.2019];</i> <i>[Evidencë: 2.1.b Plani mësimor Bsc. IM – 04.2019];</i>

	[Evidencë: 3.8.a Axhenda - Konferenca e III - IIST - 2021]; [Evidencë: 3.8.b Axhenda - Konferenca e IV - IIST - 2022]; [Evidencë: 3.8.c Axhenda - Konferenca e V - IIST - 2023]; [Evidencë: 3.9.a Poster Forumi Studentor "Transformimi digjital në kohën e sfidave" + lista pjesëmarrës 2021]; [Evidencë: 3.9.b Programi Forumi II Studentor "Transformimi digjital në kohën e sfidave" 2022]; [Evidencë: 3.9.c Programi Konferenca Ndërkombëtare Innovation and Sustainability Challenges for a better future]; [Evidencë: 3.10.a Përfsh e student/excursion/UTS në rrjetin CEEPUS]; [Evidencë: 3.10.b Lista e ap për mobilitet 2020 në CEEPUS]; [Evidencë: 3.11.a ICLA-AUMem Bashkë zbatim projektesh 2018]; [Evidencë: 3.11.b ICLA_AU_MoU_signed 2024]; [Evidencë: 3.11.c MOU agreement & Activity Plan ICLA AU role/GIZ].
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	GVJ mësoi gjatë vizitës dhe nga dokumentacioni në DVV që Departamenti i Inxhinierive organizon leksione të hapura, duke ftuar pedagogë/ specialistë të fushave të ndryshme të inxhinierisë, për të njohur studentët me studimet më të fundit të tyre. Me studentët e këtij programi zhvillohen çdo vit vizita në TEC-in e Vlorës, në kuadër të praktikave. Në kuadër të bashkëpunimit Erasmus+ me Universitetin Arktit të Norvegjisë (UiT), në vitin 2023, një pedagog i DI zhvilloi një leksion të hapur në këtë universitet, ndërsa një anëtar i stafit ndoqi një trajnim. [Evidencë: 1.1.a Raporti vjetor - DI - v.a. 2021 - 2022]; [Evidencë: 1.1.b Raporti vjetor - DI - v.a. 2022 - 2023]; [Evidencë: 1.1.c Raporti Sem. I - DI - v.a. 2023 -2024].
Konkluzione ✓ Institucioni në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies, ka ngritur strukturat përkatëse, të cilat janë: Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave, si dhe Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin. Praktikant më të mira, që evidentohen gjatë analizës mësimore, u bëhen të ditur të gjitha njësive bazë nëpërmjet një raporti që hartohet nga NJSBC. ✓ GVJ konstaton se program i studimit Bachelor në "Inxhinieri Mekatronike" është hartuar t'u ofrojnë studentëve (1) njohuri të karakterit shkencor të mbështetura në lëndë të formimit bazë; (2) njohuri në fushën e inxhinierisë elektrike, (3) njohuri në fushën e inxhinierisë elektronike dhe (4) njohuri në fushën e inxhinierisë mekanike. Sfidat e këtij programi është harmonizimi i këtyre tre fushave, që edhe në teknologjinë e zbatuar i gjen të harmonizuara. Prandaj mendojmë se kjo kurrikulë është një bazë e mirë që duhet plotësuar duke ndjekur ciklin e dytë të studimit (Master i shkencave ose Master Profesional).	

- ✓ Gjithashtu ky program synon t'u përgjigjet kërkesave të formimit profesional, për tregun e punës, në mënyrë që studentët të zotërojnë aftësitë analitike për të trajtuar problematika të ndryshme inxhinierike. *Përmirësimi i programit me rekomandimet/sugjerimet e dhëna në këtë Raport në Standardin II.3 (më lart) do të forconte këtë program në drejtim të thellimit të mëtijshme të njohurive*
- ✓ Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Mekatronike" është një program i formimit inxhinierik ku studentët zhvillojnë aftësi të veçanta në fushat e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit
- ✓ Aftësitë dhe kompetencat, që fitojnë studentët vlerësohen në këto forma:
 - Vlerësohen gjatë gjithë lëndës (me anë të vlerësimit të vazhduar të studentëve);
 - Përforcohen në orët e ushtrimeve, orët laboratorike, apo detyrat e kursit;
 - Në fund të lëndës, bëhet një përmbledhje e argumenteve, në ndihmë të studentëve për provimin përfundimtar;
 - Në fund të çdo semestri, stafi akademik harton raportin semestral, për realizimin e objektivave të mësimdhënies.
- ✓ Për nxitjen e punës në grup, një pjesë e detyrave të kursit organizohen në grupe studentësh për të nxitur debatin, ballafaqimin e rezultateve dhe diskutimin e tyre. Institucioni vë në dispozicion laboratorët për realizimin e ideve novatore të studentëve. Gjatë viteve të fundit janë organizuar konferenca studentore dhe publikime në revistën e universitetit "Optime"

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Institucioni ka hartuar një material përkrahës me procedurën e temës së diplomës që nga përzgjedhja deri në dorëzimin përfundimtar të saj. Megjithatë të gjitha rregullat i ka përmbledhur në Rregulloren e programit të studimit. GVJ konstaton se përmes saj dhe praktikës shumëvjeçare të PS, në fillim të vitit akademik, studentëve u jepet informacion për dy format për vlerësimin përfundimtar, që janë: - provim i përgjithshëm formimi - temë diplome (për studentët që kanë mesatare mbi 8) <u>Për provimin e përgjithshëm të formimit:</u> jepet baza e të dhënave me pyetjet e provimit të formimit. Pyetjet hartohen nga pedagogët e lëndëve përkatëse. <u>Për temën e diplomës:</u> Udhëheqësi përcaktohet nga Departamenti përkatës, ndërsa tema e diplomës përcaktohet nga student, në bashkëpunim me udhëheqësin. Udhëheqësi ka detyrimin për të

	ndjekur studentin gjatë gjithë periudhës së punimit të temës së diplomës. Departamenti përcakton edhe afatet e dorëzimit të punimit final duke përcaktuar në të njëjtin kohë edhe oponentin e tezës. Njohja me informacionet e duhura të studentëve të vitit të tretë, mundësohet brenda muajit të parë nga data e fillimit të vitit akademik. <i>[Evidencë: H.1 Rregullore mësimore Bsc. IM - 03.2019, neni 29];</i> <i>[Evidencë: 1.6 Rregullore FSHAE 2022 - neni 41].</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Nga dokumentacioni në dosje dhe nga vizita në institucion GJV konstaton se pyetjet e provimit të formimit hartohen nga pedagogët e lëndëve përkatëse, dhe merren nga temat e shtjelluara gjatë zhvillimit të lëndës. Kjo bazë të dhënash u vihet në dispozicion studentëve që në muajin e parë të shkollës. Ndërsa studentëve që në përfundim të studimeve mund të arrijnë mesataren mbi 8) pra janë 'kandidatë' për të zhvilluar një temë diplome u vihet në dispozicion materiali përshkruar me procedurën e temës së diplomës që nga përzgjedhja deri në dorëzimin përfundimtar të saj. <i>[Evidencë: 3.5.b Shembull Procedurë Diplome Bsc. IM- 22-23];</i> <i>[Evidencë: 3.12.a Pyetjet e provimit të formimit Bsc. IM 23- 24];</i> <i>[Evidencë: 3.12.b Shembull teze provim formimi Bsc. IM -23-24].</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohurive dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Nga rregulloren e fakultetit FSHAE (neni 41) përshkruan se specifikat e provimit i ka Rregullorja e programit të studimit. Në rregulloren e PS në Nenin 30 "Procedura e mbrojtjes së Diplomës" rezultojnë: 1. <i>Studenti merret në provimin e diplomës nga një komision që quhet Komisioni i Diplomimit (si në mbrojtjen e diplomës, ashtu dhe në provim). Përbërja e komisionit propozohet nga departamenti dhe miratohet nga Dekani.</i> 2. <i>Procedura e mbrojtjes së diplomës Bachelor në "Inxhinieri Mekatronike" mbështetet në Rregulloren e Përgjithshme të Albanian University. Janë të pranishëm studenti, i cili paraqet punimin e tij, udhëheqësi që harton një relacion dhe propozon vlerësimin për studentin, si dhe oponenti, i cili harton dhe ai një relacion, pyet studentin si dhe propozon notën përfundimtare për punimin e diplomës. Vlerësimi përfundimtar jepet nga Komisioni i Diplomimit.</i> 3. <i>Data e provimit të formimit miratohet nga Dekani dhe zhvillohet në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të Institucionit. Në sallë janë të pranishëm një numër i lartë pedagogësh përurvejimin e studentëve, numër që përcaktohet nga Departamenti përkatës. Tezat korrigjohen nga Komisioni i</i>




	<i>Diplomimit, që është miratuar nga Dekani dhe rezultatet bëhen publike në sekretarinë përkatëse.</i> Teza e provimit përfundimtar hartohet si një përzgjedhje e pyetjeve nga baza e të dhënave të provimit të formimit, ku janë përcaktuar më parë lëndët mbi të cilat studenti do të testohet, si dhe pesha që zë secila prej tyre në totalin e provimit përfundimtar. Nga vizita në institucion rezulton se në tezën e provimit përfundimtar, ka një ndarje afërsisht proporcionale të pyetjeve ndërmjet tre formimeve kryesore inxhinierike që përbënë mekatronikën: mekanike, elektrike, elektronike. <i>[Evidencë: H.1 Rregullore mësimore Bsc. IM - 03.2019, neni 30];</i> <i>[Evidencë: 1.6 Rregullore FSHAE 2022 - neni 41].</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Në nenin 29 të rregullores së PS shkruhet: ➤ <i>Diploma "Bachelor" mund të mbyllet me mbrojtjen e një punimi diplome për studentët që kanë mesatare mbi 8.</i> ➤ <i>Udhëheqësi përcaktohet nga Departamenti përkatës, ndërsa tema e diplomës përcaktohet nga studenti në bashkëpunim me udhëheqësin.</i> ➤ <i>Udhëheqësi ka detyrimin për të ndjekur studentin gjatë gjithë periudhës së punimit të temës së diplomës.</i> ➤ <i>Departamenti përcakton edhe afatet e dorëzimit të punimit final duke përcaktuar në të njëjtin kohë edhe oponentin e tezës.</i> ➤ <i>Departamenti përcakton dhe afishon grafikun e kontrollit të masës së realizimit të punës nga ana e studentit. Kontrollat e diplomës janë të detyrueshme. Mos kryerja e pajustifikuar e tyre, sipas kalendarit përkatës, i heq studentit të drejtën e paraqitjes për mbrojtjen e temës së diplomës në sesionin e parë. Ai mund të paraqitet në sesionet pasardhëse, pasi të ketë shlyer të gjitha detyrimet për kontrole, të përcaktuara sipas kalendarit të rradhës.</i> Siç del nga rregullorja por edhe nga dokumentat e dosjes rezulton se procedura e mbrojtjes së diplomës është rregulluar në të gjitha fazat e saj. <i>[Evidencë: H.1 Rregullore mësimore Bsc. IM - 03.2019, neni 30];</i> <i>[Evidencë: 4.4 Tema diploma Bsc. - 2021 – 2024];</i> <i>[Evidencë: Shembull Procedurë Diplome Bsc. IM- 2022 – 2023].</i>
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	GVJ konstatoi se Institucioni ishte i pajisur me disa laboratorë që mundësonin punën e pavarur të studentëve që ishin në fazën e punimit të diplomës. Departamenti i Inxhinierive vë në dispozicion të studentëve si laboratorët e tij ashtu edhe stafin ndihmës akademik/laborantët, si

	dhe ambientet e Institucioneve me të cilat bashkëpunon për realizimin me sukses të projekteve të diplomës. <i>[Evidencë: 1.5 Përshkrimi i Laboratoreve të Departamentit të Inxhinierive].</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Në përfundim të provimit të formimit/mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë, vlerësim, i cili paraqitet në listën e notave, që i vihet në dispozicion studentit me përfundimin e studimeve. Në nenin 24 të Rregullores së programit të studimit përcaktohet: <i>Shkalla e vlerësimit për përvetësimin e dijës nga studentët bëhet sipas sistemit me note (notat 4 deri 10), me pikë ose me përqindje (100 pikë ose 100%) dhe me shkronja (sistemi ECTS me shkronjat nga A deri F).</i> <i>Vlerësimi me notë është i detyrueshëm, në kuptimin që përfundimi i një vlerësimi duhet të shprehet detyrimisht edhe me notë. Notat kaluese konsiderohen nga 5 e lart, pikët nga 41 e lart dhe shkronjat nga A deri E.</i> <i>[Evidencë: H.1 Rregullore mësimore Bsc. IM - 03.2019, neni 24].</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në rregulloren e FSHAE tregohet se studenti kur mbaron të gjitha detyrimet pajiset me diplomën, dhe suplementin e diplomës sipas modeleve të aprovuar zyrtarisht. Modeli i diplomës është miratuar me Urdhër i QSHA nr. 276, datë 09.06.2021. Modeli i suplementit të diplomës është aprovuar nga Ministria përgjegjëse e Arsimit. Studentëve të interesuar, me kërkesë të tyre, ju vihet në dispozicion një kopje e plotë e programit mësimor dhe syllabuset e lëndëve të zhvilluara, të firmosura nga titullari i Institucionit. <i>[Evidencë: 3.13 Shembull procedure kërkesë programi mësimor dhe syllabuset e lëndëve IM].</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Në Rregulloren e programit të studimit në nenin 11 jepen rregullat e regjistrimit të një kandidati për student. <i>Kandidati që regjistrohet ka të drejtë të ndjekë studimet në vitin akademik përkatës, nëse dorëzon brenda afateve të shpallura të gjithë dokumentacionin e nevojshëm juridik, si dhe nënshkruan kontratën e regjistrimit me institucionin; kështu ai fiton statusin e studentit.</i> Dosja e studentit me të gjithë dokumentacionin ruhet në sekretarinë mësimore. Të dhënat e studentëve të diplomuar ruhen dhe përditësohen periodikisht, në veçanti lidhur me vijueshmërinë e punësimit të tyre

	pas diplomimit, duke i vënë në dispozicion të strukturave përkatëse nëse kërkohen. [Evidencë: 5.2 Rregullore e Zyrës së Kord dhe Mbështetjes së Stud]; [Evidencë: 5.3 Rregullore e Zyrës së Karrierës dhe Alumnit].
--	--

Konkluzione

- ✓ Institucioni ndjek një procedurë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.
- ✓ Përmes rregullores së programit të studimit dhe praktikës shumëvjeçare të PS, në fillim të vitit akademik, studentëve u jepet informacion për dy format për vlerësimin përfundimtar, që janë: provimi i përgjithshëm formimi ose temë diplome (për studentët që kanë mesatare mbi 8).
- ✓ Pyetjet e provimit të formimit hartohen nga pedagogët e lëndëve përkatëse, dhe kjo bazë të dhënash u vihet në dispozicion studentëve që në muajin e parë të shkollës. Në tezën e provimit përfundimtar, ka një ndarje afërsisht proporcionale të pyetjeve ndërmjet tre formimeve kryesore inxhinierike që përbëjnë mekatronikën: mekanike, elektrike, elektronike.
- ✓ Për studentët që janë 'kandidatë' për të zhvilluar një temë diplome u vihet në dispozicion materiali përshkrues me procedurën e temës së diplomës që nga përzgjedhja deri në dorëzimin përfundimtar të saj.
- ✓ Në rregulloren e PS në nenin 29 jepen të gjitha rregullat që ndiqen për mbrojtjen e tezës së diplomës.
- ✓ Departamenti i Inxhinierive vë në dispozicion të studentëve si laboratorët e tij ashtu edhe dhe stafin ndihmës akademik /laborantët, si dhe ambientet e Institucioneve me të cilat bashkëpunon për realizimin me sukses të projekteve të diplomës.
- ✓ Në Rregulloren e programit të studimit [Neni 24] përcaktohet: Shkalla e vlerësimit për përvetësimin e dijës nga studentët bëhet sipas sistemit me note (notat 4 deri 10), me pikë ose me përqindje (100 pikë ose 100%) dhe me shkronja (sistemi ECTS me shkronjat nga A deri F).
- ✓ Në rregulloren e FSHAE tregohet se studenti kur mbaron të gjitha detyrimet pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës sipas modeleve të aprovuar zyrtarisht.
- ✓ Dosja e studentit më të gjithë dokumentacionin ruhet në sekretarinë mësimore. Të dhënat e studentëve të diplomuar ruhen dhe përditësohen periodikisht, në veçanti lidhur me vijueshmërinë e punësimit të tyre pas diplomimit, duke i vënë në dispozicion të strukturave përkatëse nëse kërkohen.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret

Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

Vlerësimi i ekspertëve

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion të Grupit të vlerësimit, për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike, që ofrohet nga Departamenti i Inxhinierive (DI) i Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike (FSHAE), Albanian University, Tiranë (AUT), në të tre vitet akademike është realizuar nga personel akademik efektiv, gjithsej 18 dhe nga personel akademik me kontratë, kryesisht nga UPT (10-13). Pedagogët, si PAE ashtu edhe PAK, i përmbushin kërkesat ligjore në fuqi. Kualifikimi i tyre për 3 vite (2021-2024) është si më poshtë vijon:

Tituj / Grada	2021-2022		2022-2023		2023-2024		2024-2025 Sem 1	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof. Dr.	-	1	0	0	-	0	-	-
Prof. As. Dr.	2	4	2	3	3	4	3	4
Dr. / Phd	7	8	7	7	5	6	5	3
Dr. Proc.	-	-	1	0	3	-	4	-
Msc.	9	0	8	0	7	0	8	-
Totali	18	13	18	10	18	10	20	7

**Per vitin 2024-2025 sipas dokumentit të sjelle nga institucioni pas vizites. Ky dokument rferohet vetem per simestrin e parë.*

Gjykojmë që personeli akademik i angazhuar në programin e studimit, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik, sipas përcaktimeve ligjore (pika 6 neni 59 i Ligjit nr. 80/2015), personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës.

Grupi i vlerësimit (mbi bazën e CV e veprimtarisë kërkimore-shkencore të tyre) konstaton se niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike, janë në përputhje me këtë program studimi, natyrën dhe specifikën e lëndëve të tij.

[Evidencë: Anekset Tabelat përmbledhëse, tabelat 6.1, 6.2, 6.3];

[Evidencë: 4.2 CV e stafit akademik 2023-2024].

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	GVJ evidenton se ngarkesa mësimore <i>nuk respekton plotësisht</i> shpërndarjen sipas Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL”, pika II. 1, i ndryshuar me Udhëzim nr. 36, datë 23.11.2018 dhe me Udhëzim nr. 37, datë 04.12.2018, sepse sipas Tabelës 4, pjesa më e madhe e stafit të brendshëm realizon nga 441-652 orë mësimore, duke tejkaluar me 40-250 orë mbi kufirin maksimal (e lejueshme nga udhëzimi), <i>por, numri i lëndëve që zhvillon një pjesë e pedagogëve është nga 8-10, ndërkohë që lejohen deri në 6 lëndë në vit (sipas udhëzimit) dhe jo më shumë se 3 në semester.</i> Ndarja e ngarkesës mësimore prej drejtuesit të departamentit DI, për anëtarët e saj, bëhet në përputhje të plotë me kompetencat profesionale dhe prioritetet për punën kërkimore që secili parashikon individualisht dhe në nivel grupi mësimor, në fillim të çdo viti akademik. Përveç angazhimit në mësimdhënie në auditor, personeli akademik ka për detyrë të zhvillojë orë për konsultime, për praktikë mësimore, etj. Kjo ngarkesë e realizuar paraqitet në fund të çdo semestri nga çdo anëtar stafi. [Evidencë: Anekset Tabelat përmbledhëse, tabela 4]; [Evidencë: 4.1 a Ngarkesa mësimore Bsc. IM 2021-2022]; [Evidencë: 4.1 b Ngarkesa mësimore Bsc. IM 2022-2023]; [Evidencë: 4.1 c Ngarkesa mësimore Bsc. IM 2023-2024].
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	GVJ konstaton se në periudhën 2021-2024 AU/FSHA/DI ka treguar qëndrueshmëri të personelit akademik në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike. GVJ vlerëson që AU e konsideron qëndrueshmërinë e stafit si një faktor kyç të suksesit për shkak të cilësisë në përzgjedhje dhe përputhja e eksperiencës personale me profilet e lëndëve që zhvillon; respektimi i dyanshëm i kontratës, etj. GVJ evidenton se AU respekton dhe përmbush kërkesat dhe detyrimet kontraktuale bazuar në legjislacionin në fuqi (financiare, sigurimet shoqërore dhe kodin e punës) për personelin. Çdo anëtar i stafit është i kualifikuar në fushën specifike të caktuar. [Evidencë: 4.3 a Kontrata e punës e stafit akademik PAE]; [Evidencë: 4.3 b Kontrata e punës e stafit akademik PAK]; [Evidencë: Anekset Tabelat përmbledhëse, tabelat 1.1-1.3, 2.1-2.3, 6.1-6.3, 7, 8].
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që	GVJ mbi bazën e DVV evidenton se AU në përputhje me Statutin; dhe Rregulloret ka hartuar procedura të veçanta për rekrutimin e stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme. Procedurat e rekrutimit dhe të vlerësimit të stafit akademik bëhen mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura paraprakisht.

garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	GVJ sipas dokumentacionit të paraqitur konstaton se procedura fillon me përcaktimin e nevojave për staf akademik prej vetë njësisë bazë. Departamenti i Inxhinierive në fillim të çdo viti akademik në mbledhjen e tij miraton nevojat konkrete për staf të ri. Përcaktimi i kriterëve specifike në referencë të specifikave e kërkesave të lëndës/grup lëndëve për mbulimin e të cilave kërkohet ky staf, që propozohen nga njësisë bazë DI, garanton përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. Drejtuesi i njësisë bazë DI ia percjell drejtuesit të njësisë kryesore numrin e vendeve të lira dhe kriteret për PAK, në zbatim të rregullores përkatëse. Këto gjithashtu bëhen publike në faqen web të AU si dhe afishohen në ambientet e tij. GVJ nga takimet në institucion konstaton se pas një periudhë kohore, kërkesat që kanë ardhur në përmbushje të thirrjes shqyrtohen nga një komision i përbërë prej 5 anëtarë, ku bëjnë pjesë Dekani, përgjegjësi i departamentit, 1 anëtar i DI me eksperiencë të gjatë dhe i fushës përkatëse, 1 përfaqësues i zyrës së BNJ i propozuar nga BA dhe 1 përfaqësues i zyrës së Kurrikulave. Ky komision përcakton fituesit sipas kriterëve të aplikimit. Lista me fituesit dërgohet tek struktura përkatëse e AU. Pasi përmbyllet procedura e mësipërme kandidati fitues nënshkruan kontratën me Rektoren. Këto procedura dhe dokumenta u konstatuan të rregullta nga GVJ në dosjet e personelit në Zyrën e Burimeve Njerëzore të AU. [Evidencë: 1.2 Statuti, nenet 33-38]; [Evidencë: 1.3 Rregullore AU, neni 30]; [Evidencë: 1.6 Rregullore FSHAE, nenet 19-20]; https://albanianuniversity.edu.al/sq/vende-vakante-5/ [Evidencë: R.1.a Procedurë rekrutimi v. 2021-2022]; [Evidencë: R.1.b Procedurë rekrutimi para fillimit të sem II 2021-2022]; [Evidencë: R.1.c Procedurë rekrutimi 2022-2023]; [Evidencë: R.1.d Procedurë rekrutimi para fill. të sem II të 2022-2023]; [Evidencë: R.1.e Procedurë rekrutimi para fillimit të sem I 2023-2024]; [Evidencë: R.1.f Procedurë rekrutimi para fillimit të sem II 2023-2024].
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e	Sipas RVB, tabelave të përmbledhura dhe takimeve në institucion rezultojnë se DI ka 2 dy personel ndihmës akademik, ku njëri është edhe personel akademik.

orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	GVJ konstaton se personeli akademik/administrativ përzgjidhet me konkurs dhe vlerësimi bëhet në bazë të përmbushjes së kritereve të shpallura dhe ekspertizës profesionale. Nisur nga natyra e programeve që DI ofron, një rëndësi të veçantë në procesin e rekrutimit i jepet atyre kandidatëve të cilët kanë një përvojë të gjatë e të suksesshme në profesion dhe janë unikë në fushën e tyre të specializimit. Punësimi i personelit ndihmës-akademik ashtu si edhe i atij akademik në AU kryhet në përputhje me Statutin [neni 44] dhe Rregulloren [neni 31], me konkurrim, përmes thirrjeve të hapura. Shpallja e thirrjeve bëhet në faqen zyrtare. Nga vëzhgimi i bërë në faqen zyrtare web GVJ konstaton se janë lehtësisht të aksesueshme. https://albanianuniversity.edu.al/sq/vende-vakante-5/ [Evidencë: Anekset Tabelat përmbledhëse, tabelat 2.1-2.3]; [Evidencë: 1.2 Statuti, neni 44]; [Evidencë: 1.3 Rregullore AU, neni 31].
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarë në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Nga takimet në institucion dhe faqes web të AU GVJ evidenton se struktura përgjegjëse për menaxhimin e burimeve është Zyra e Burimeve Njerëzore, detyra e të cilës është mbledhja, ruajtja dhe përditësimi i të dhënave të personelit të angazhuar në programin e studimit Bsc. në Inxhinieri Mekatronike. Përgjegjësi i zyrës së BNJ përgatit një informacion të detajuar për evidencat e punonjësve. Gjithashtu dokumentacioni për ngarkesën e personelit akademik e ndihmës akademik (laborant) ruhet dhe në arkivën e dep. DI. Nga shikimi i kontratës individuale të punës nga GVJ u verifikua se jepet detyrimet dhe përgjegjësitë e palëve. Të dhënat për personelin e angazhuar në programin e studimit Bsc. në Inxhinieri Mekatronike përditësohen çdo vit. [Evidencë: 1.2 Statuti, neni 13]; [Evidencë: Anekset Tabelat përmbledhëse, tabelat 1, 2]; [Evidencë: 4.2 CV e stafit akademik v. 2023-2024].
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale,	Sipas të dhënave në evidencat, evidentojmë se AU ka nënshkruar 30 marrëveshje me kompani që operojnë në vendin tone, nga të cilat 13 për praktikën e programit Bsc. në Inxhinieri Mekatronike dhe një numër marrëveshjesh me universitete të huaja, me institucione shtetërore e ente të ndryshme private. Përsa i përket kryerjes së praktikës profesionale, si pjesë e programit të studimit, mendojmë se AU ka eksperiencë të gjerë për praktikën, prandaj evidentojmë se edhe praktikën e programit të studimit Bsc. në Inxhinieri Mekatronike, realizohen me efektivitet.



punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	AU vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike të profilit mekatronik. [Evidencë: Anekset Tabelat përmbledhëse, tabela 5]; [Evidencë: H.1 Rregullore e PS Bsc. Inxhinieri Mekatronike, neni 27].
Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Në përputhje me organizimin dhe praktikën e punës në veprimtarinë e njësisë kryesore Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike FSHAE dhe njësisë bazë Departamenti i Inxhinierive DI përgjegjës për programin e studimit Bsc. në Inxhinieri Mekatronike angazhojnë personel akademik që ndjek realizimin e praktikave profesionale si edhe një person të enteve dhe subjekteve publike e private që përgjigjet për studentin. Çdo pedagog mund të mbikëqyrë deri në 20 studentë (në përputhje me VKM me nr. 418, date 10.05.2017). Nga DVV, GVJ konstaton se subjekti pritës cakton një person mbikëqyrës për çdo student që kryen praktikën. Ky person është pikë kontakti me FSHAE/DI. Në fund të praktikës profesionale studenti përgatit një relacion përfundimtar për punën e kryer dhe përvojën në subjektin pritës. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës, e ndihmon studentin në përmbushjen e detyrimeve/relacionin përfundimtar të praktikës, e kontrollon dhe informon për mbarëvajtjen e tij. [Evidencë: 2.2 Miratim udhëheqës për praktikat v. 2023-2024].
Konkluzione ✓ GVJ vlerëson që personeli akademik që mbulon programin e studimit Bsc. në Inxhinieri Mekatronike përmbush standardet për nivelin e kualifikimit dhe fushën akademike-kërkimore të përgjithshme dhe specifike në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit. ✓ Numri i lëndëve që zhvillon një pjesë e pedagogëve është nga 8-10, ndërkohë që lejohen deri në 6 lëndë në vit dhe jo më shumë se 3 në semestër, sipas udhëzimit të MAS për ngarkesën mësimore. ✓ Rekrutimi i stafit akademik e ndihmës-akademik në Albanian University bëhet në mbështetje të Legjislacionit të Punës në Republikën e Shqipërisë dhe në përputhje me kriteret e diktuar nga ligji 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Statuti dhe Rregullorja e universitetit, si edhe kriterëve specifike që propozohen nga Departamenti i Inxhinierive. ✓ GVJ konstatoi se AU / FSHAE / DI mbledhin/ruajnë dhe përditësojnë çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. ✓ AU ka garantuar marrëveshje bashkëpunimi për praktikat profesionale me kompani e biznese private. Programi i studimit Bsc. në Inxhinieri Mekatronike vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve	



në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike të profilit mekatronik.

- ✓ *Personeli në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale, në bazë të marrëveshjeve, ndihmon studentët në përmbushjen e detyrimeve për praktikën profesionale.*

Rekomandim/Sugjerim:


Rekomandojmë që Universiteti AU, fakulteti FSHAE dhe departamenti DI të bëjnë një rishpërndarje të lëndëve për pedagog me deri në 3 lëndë për semestër, duke bashkuar nën të njëjtin emërtim lëndë të ngjashme e në vijim të njera-tjetrës, me ndarje në pjesë 1, 2 ose duke rritur kreditet e lëndëve profesionale, e kështu edhe orët mësimore për to, me qëllim plotësimin e ngarkesës së pedagogëve të profileve inxhinierike.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Nga vëzhgimi në vend dhe dokumentacioni GJV konstaton se FSHAE ka në dispozicion ambiente të mjaftueshme për zhvillimin e procesit mësimor. DI e zhvillon veprimtarinë e tij në godinën e rrugës së Kavajës, ambientet në përdorim janë: 5 (pesë) sallat e leksioneve me një sipërfaqe prej 340.12 m²; 7 klasa seminaresh me 311.08 m², një sallë për aktivitete promovuese me 78 m², 6 laboratore për lëndët në harmoni me specifikat e tyre dhe 2 dy laborator informatike, në total 2111.07 m² në këtë godinë. Totali në përdorim nga FSHAE duke marrë parasysh sipërfaqet në përdorim dhe pjesën proporcionale të sipërfaqeve të përbashkëta është 2111.07 m². Numri i studentëve aktivë për vitin akademik 2023 – 2024 është 650. <i>Raporti i sipërfaqes është 3.25 m²/student.</i> Normativa 5 m²/student, e përcaktuar për IAL e profileve inxhinierike sipas VKM nr. 418, datë 10.5.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre” mund të arrihet duke marrë në konsideratë pjesën proporcionale të ambienteve në përdorim në nivel institucioni Albanian University siç janë mjediset në godinën qendrore, laborator i kimisë në godinën e Internacionalit. Evidentohet që mjediset e FSHAE për zhvillimin e veprimtarisë mësimore janë me kushte të përshtatshme higjeno-sanitare, të sigurisë nga zjarri, me ndriçim e ajrosje, ka izolim të mirë akustik, etj., duke i bërë efektivisht ambiente komode për mësimdhënien, si dhe në përputhje të mirë me standartet dhe normat e kërkuara për



	programet inxhinierike. Mirëmbajtja dhe pastrimi i ambienteve sigurohen sipas rregullave të vendosura në rregulloret e brendshme. [Evidencë: 4.5 Planimetritë - godina e rrugës së Kavajës]; [Evidencë: Anekset Tabelat përmbledhëse, tabela 16].
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Nga vizita në FSHAE, GVJ vëzhgon se mjediset janë të restauruara dhe sipas standardeve bashkëkohore. Auditorët e leksioneve janë të pajisura me videoprojektorë, kompjuter. Interneti në godinë disponohet nga rrjeti <i>wireless</i>. GVJ evidenton se FSHAE ka në dispozicion laboratorë që i shërbejnë procesit mësimor, por edhe atij kërkimor-shkencor. Të gjithë këto laboratorë rinovohen kohë pas kohe dhe janë të pajisur me pajisje elektronike dhe IT. [Evidencë: 1.5 Përshkrimi i laboratorëve të DI, FSHAE].
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Nga vëzhgimi në vend dhe dokumentacioni GVJ konstaton se FSHAE zotëron 6 laboratorë: i infrastrukturës së rrjetave, i elektroteknikës, i elektronikës analoge\ dixhitale, i matjeve elektrike dhe elektronike, i automatikës dhe kontrollit (dhe mekatronikës), i makinave elektrike, i instalimeve elektronike, i fizikës, i kimisë, sipas profileve inxhinierike përkatëse dhe 2 laboratorë për informatikën: 1 – 2 (i simulimeve), të shpërndara nëpër godinat e AU. Këto laboratorë përmbajnë aparaturat, pajisjet teknike dhe informatike, makete, etj., të nevojshme për të zhvilluar orët laboratorike dhe praktikat me studentët, për plotësimin e objektivave formues të programit të studimit Bsc. në Inxhinieri Mekatronike. Përgjithësisht sallat e laboratorëve janë të pajisur me hapësirën e nevojshme për zhvillimin normal të seminareve apo praktikave lëndore. Laboratorët mund të përdoren gjithashtu edhe për kërkime shkencore nga stafi i FSHAE. [Evidencë: 1.5 Përshkrimi i laboratorëve të DI, FSHAE].
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Nga vizita në institucion dhe DVV, GVJ evidenton se në ambientet e FSHAE janë 2 laboratorë për lëndët e IT, modern dhe të pajisur me programe profesionale. Në laboratorët për informatikën 1-2 (i simulimeve) janë të instaluara të gjitha programet (<i>softëare</i>) e nevojshme në fushën e inxhinierisë mekatronike. [Evidencë: 1.5 Përshkrimi i laboratorëve të DI, FSHAE].
Konkluzione ✓ GVJ vlerëson që Albanian University, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, Departamenti i Inxhinierive ka vënë në dispozicion të programit të studimit Bsc. në Inxhinieri	

Mekatronike, mjedise mësimore dhe infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës dhe për formimin praktik, të veçantë për natyrën inxhinierike të programit, etj.

- ✓ Aktiviteti mësimor zhvillohet në kabinetet e auditorët; laboratorët për lëndët specifike të programit dhe laboratorët për lëndët e informatikës dhe teknologjisë së informacionit; sallat e leksioneve janë të pajisura me videoprojektorë dhe lidhje me ëreless për internetin në të gjithë godinën, duke mundësuar përdorimin e metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies për studentët.
- ✓ Mjediset infrastrukturore deklarohen 3.25 m²/student. Normativa 5 m²/student, e përcaktuar për IAL e profileve inxhinierike sipas VKM nr. 418, datë 10.5.2017 mund të arrihet duke marrë në konsideratë pjesën proporcionale të ambienteve në përdorim në nivel institucioni Albanian University.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	GVJ nga vizita në institucion e takimet me studentët konstatojmë se literatura bazë dhe ndihmëse (fizike e elektronike), e shënuar edhe në syllabuset dhe vënë në dispozicion të studentëve është në gjuhën shqipe dhe/ose në anglisht, e cila synon marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit Bsc. në Inxhinieri Mekatronike. GVJ konstaton se AU garanton tekste mësimore dhe literaturë plotësuese, e cila sigurohet nga titullarët e lëndëve, mund të gjendet në Bibliotekën e AU apo në bibliotekat e fakulteteve të AU. Lëndët mbulohet kryesisht nga botimet në gjuhën shqipe të stafit, por krahas tyre ofrohet edhe literaturë tjetër në gjuhën shqipe ose të huaj Sipas DVV e takimeve, GVJ evidenton se kur lënda/moduli nuk ka tekst mësimor të botuar në gjuhën shqipe, stafi akademik i programit të studimit është i angazhuar në përgatitjen e cikleve të leksioneve, të cilat u janë vënë në dispozicion studentëve edhe në klasat virtuale të krijuara në platformën Microsoft Teams. [Evidencë: 2.4.b Syllabuset 2023-2024]; [Evidencë: 4.6 Lista e librave në bibliotekë 2022]; [Evidencë: 3.2 Klasat virtuale në platformën Microsoft Teams - DI].
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime	GVJ evidenton se pasurimi i vazhdueshëm dhe përditësimi i burimeve të literaturës pasqyrohet në syllabuset e lëndëve/moduleve, të cilat janë subjekt i miratimit vjetor nga njësia

të literaturës me botime të viteve të fundit.	bazë DI. FSHAE dhe njësitë e tij përbërëse, parashikojnë literaturën e nevojshme që duhet t'i shtohet fondit ekzistues për mbështetjen jo vetëm të aktiviteteve didaktike por edhe atyre shkencore. GVJ konstaton se për pasurimin e fondit, biblioteka bazohet edhe në kërkesat e përdoruesve. Përveç blerjeve, pasurimi i fondit bëhet edhe përmes dhurimeve dhe shkëmbimeve me bibliotekat e tjera duke u fokusuar në profilin teknik dhe shkencor të koleksionit të saj. <i>[Evidencë: 2.7. a Rishikim syllabuse v. 2021-2022];</i> <i>[Evidencë: 2.7. b Rishikim syllabuse v. 2022-2023];</i> <i>[Evidencë: 2.7. c Rishikim syllabuse v. 2023-2024].</i> <i>[Evidencë: 2.8 a Kërkesë për pasurimin e Bibliotekës së DI 2021-2022];</i> <i>[Evidencë: 2.8 b Kërkesë për pasurimin e Bibliotekës së DI 2023-2024].</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Sipas DVV, FSHAE dhe DI ka në dispozicion Bibliotekën në ambientet e godinës së rrugës së Kavajës. Nga vizita në vend, GVJ konstatoi se FSHAE ka riorganizuar dhe ka sistemuar ambientin e bibliotekës të pajisur me afro 120 tituj dhe 25 poste leximi/konsultimi të lidhura në një kompjuter qendror, të cilët vihen në dispozicion të studentëve dhe garantohet në mënyrë të barabartë për to. <i>[Evidencë: 4.5 Planimetritë - godina e rrugës së Kavajës].</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Sipas dokumentave të VV dhe nga vizita, GVJ konstaton se Biblioteka është e pajisur me një literaturë të pasur shqip dhe të huaj, me 120 tituj librash në fushat inxhinierike me 398 kopje. Ajo disponon libra, monografi, revista, manuale, etj. Nga takimet, GVJ evidenton se Biblioteka ofron edhe fotokopje e autorizuar e pjesëve të ndryshme të librit. Biblioteka përmban tituj për fusha të ndryshme studimi dhe kjo i vjen në ndihmë studentëve të Mekatronikës të cilët kanë lëndë të ndërruar nga fusha të tjera si të inxhinierisë mekanike, elektrike dhe elektronike, të cilët janë në dispozicion të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike. Nga takimet me drejtuesit, GVJ konstatoi se AU / FSHAE / DI bën përpjekje të konsiderueshme për furnizimin me botime periodike dhe elektronike për t'i shërbyer studentëve dhe pedagogëve. <i>[Evidencë: 4.6 Lista e librave në bibliotekë 2022].</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online	Studentët kanë hapësira të mjaftueshme dhe komode, lidhje në internet dhe mund të aksesojnë lehtësisht bibliotekat on-line. Libraritë online të këshilluara janë me drejtim kryesisht inxhinierik.

të fushës së programit të studimit.	[Evidencë: Anekset Tabelat përmbledhëse, tabela 17]. www.arch2o.com www.magazinelib.com https://z-lib.is/ http://bookboon.com/ http://www.e-booksdirectory.com/ https://www.intechopen.com/ https://www.oalib.com/ http://www.mdpi.com/ http://open.ieee.org/ http://online-journals.org/ https://farelectronica.it/web/ https://www.journals.elsevier.com/mechatronics/ https://www.journals.elsevier.com/information-and-software-technology/
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Nga vizita në Bibliotekë, GVJ konstatoi që ajo ofron kushtet logjistike dhe ergonomike. Studentët mund të shfrytëzojnë literaturën on-line, pasi biblioteka ofron lidhjen përmes internetit.
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka funksionon jo vetëm në oraret zyrtare, që njëkohësisht zhvillohen edhe mësimet në bachelor në Inxhinieri Mekatronike, por edhe pasditeve në oraret 16.00-20.00, si edhe ditën e shtunë në oraret 08.00-12.00.
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin e fondit fizik dhe atij online, cilat janë	Nga DVV dhe nga vizita në institucion, GVJ konstaton se qëllimet, objektivat dhe parimet e bibliotekës janë në funksion të programeve të studimit, studentëve, personelit akademik. Në një masë të konsiderueshme materialet që rekomandohen në syllabuset e lëndëve janë pjesë e bibliotekës. Përgjegjësit e programit të studimit hartojnë plane për shtimin e zërave të bibliotekës për literaturën e detyruar dhe të rekomanduar të përditësuar që kërkohen në mbështetje të bachelor në Inxhinieri Mekatronike. Pedagogët në mënyrë sistematike komunikojnë me punonjësen e bibliotekës për atë se sa kërkohen leksionet, librat apo botime të depozitohen në bibliotekë. Ambjenti i bibliotekës së FSHAE është i mjaftueshëm për personelin akademik dhe studentët. [Evidencë: 28.a Kërkesë për pasurimin e bibliotekës së DI 2021-2022];



kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	[Evidencë: 28.b Kërkesë për pasurimin e bibliotekës së DI 2023-2024].			
Konkluzione				
✓ <i>GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike, përmban literaturën e nevojshme të detyruar dhe të rekomanduar. Ajo është në mbështetje të mësimdhënies.</i> ✓ <i>AU ka ndërtuar edhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, si bibliotekën, mjedise të posaçme, etj.</i> ✓ <i>GVJ konstaton që Albanian University / Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike ndjekin një procedurë të qartë në lidhje me pasurimin e fondit të bibliotekës.</i> ✓ <i>AU ka krijuar kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike. Biblioteka vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor, po ashtu edhe në oraret e pasdites dhe në fundjavë.</i>				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Dokumentacioni për studentët e programit të studimit Bsc. në Inxhinieri Mekatronike, mbahet nga Sekretaria mësimore, si pjesë e punës së saj e përcaktuar në Rregullore. Nga sekretaria mësimore e FSHAE përdoret sistemi i menaxhimit informatik Pitagora. GJV, nga takimi në institucion evidenton se Sekretaria mësimore kryen procedurën e pranimi të dokumentacionit të përcaktuar dhe të regjistrimit të studentëve për herë të parë, në të gjitha programet e studimit, në të gjitha ciklet e studimit, sipas listave të paraqitura nga komisionet ad-hoc, të përcjella/miratuara nga Drejtuesi i njësisë kryesore, sipas udhëzimeve përkatëse të Ministrisë përgjegjëse për arsimin, dhe i administron dosjet përkatëse. Sipas ligjeve në fuqi, nga Sekretaria mësimore administrohen Regjistrat, dosjet me procesverbalet e çdo provimi apo detyrimi tjetër akademik sipas viteve akademike; dosjet e transferimeve dhe çregjistrimeve. Sekretaritë mësimore i plotësojnë këto regjistra në formë elektronike e fizike. https://au.pitagora.rash.al/login/ [Evidencë: 1.6 Rregullore e FSHAE nenet 16-18];

	[Evidencë: 4.7 Rregullore e sekretarisë mësimore në AU]; [Evidencë: 2.5 Rregullore e regjistrimeve dhe transferimeve në AU].
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Në AU struktura përgjegjëse për menaxhimin e burimeve është Zyra e Burimeve Njerëzore, që mbledh, ruan dhe përditëson të dhënat e personelit të angazhuar në realizimin e programit të studimit bazuar në ligjin e “Mbrotjes së të Dhënave Personale”. Në dosjen e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ ruhen dhe përditësohen të gjitha të dhënat e parashikuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi. Njëkohësisht të dhënat e personelit akademik dhe ndihmës-akademik ruhen edhe në Departamentin e Inxhinierive. Stafi akademik i përditëson vetë dosjet personale në lidhje me karrierën apo titujt e fituar në kohë. GVJ, nga shikimi i DVV, konstatoi se informacionet për partnerët e angazhuar në realizimin e programit të studimit bachelor në Inxhinieri Mekatronike ruhen edhe nga Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët, Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, Zyra e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike, etj, në funksion të asaj se për çfarë bashkëpunimi bëhet fjalë. Konstatohet se për programin Bsc. në Inxhinieri Mekatronike, pjesë e përpunimit të të dhënave është edhe parashikimi i ngarkesës mësimore për stafin efektiv dhe me kontratë, që do të angazhohet në këtë program. GVJ konstaton se në AU administrimi i dokumentacionit shkresor zyrtar bëhet nga Sektori i Arkivit dhe Protokollit sipas përcaktimeve në legjislacionin përkatës në fuqi. [Evidencë: 1.2 Statuti AU, neni 13]; [Evidencë: 5.2 Rregullore e Zyrës së Koord. dhe Mbështetjes për Stud]; [Evidencë: 5.3 Rregullore e Zyrës së Karrierës dhe Alumnit].
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Nga takimi në sekretarinë mësimore, GVJ konstaton se sistemi Pitagora siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për sekretarinë, pedagogët dhe studentët në bazë të kredencialeve personale. Sekretaria mësimore ka të drejta në sistemin Pitagora konform akteve rregullatore në fuqi për aktivitetin e saj. Studentët mund të shohin vetëm të dhënat personale dhe avancimin e tyre akademik.
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma	Sipas DVV, grupi i vlerësimit evidenton se sistemi i menaxhimit Pitagora është një platformë on-line, modulet e përfshira në të lejojnë gjenerimin e raporteve, të dhënave të përmbledhura dhe të

të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	detajuara për të gjithë studentët e regjistruar në programet e studimit të ofruara në FSHAE. Në këtë platformë paraqiten planet mësimore të miratuara për çdo vit akademik dhe për secilin nga programet e studimit. Në këtë program, bëhet ndarja e studentëve në grupe mësimore dhe lidhja e tyre me planin mësimor përkatës. Gjithashtu, edhe lëndët e zhvilluara janë të lidhura me stafin akademik që e zhvillon si lëndë. Kjo pasqyrohet edhe në raportet apo proces-verbalet e krijuara nga sekretaria mësimore në funksion të aktivitetit të saj. Pedagogu përdor sistemin për plotësimin e detyrimeve të studentëve (frekuentim, detyra/projekte kursi, hedhje notash). Sekretaria verbalizon dhe zyrtarizon procedurën, kontrollon historinë e studentit, nxjerr të dhëna sipas kërkesës, etj. Studenti mund të përdorë sistemin për të shikuar vlerësimin në provime, për plotësimin e pyetësorëve, anketave, etj. Nga dokumentat, GVJ evidenton se stafi dhe studentët e FSHAE janë të pajisur me adresa e-mail-i zyrtare. <i>Sipas DVV e takimeve në sekretari, GVJ konstaton se sistemi Pitagora nuk parashikom një modul për komunikimin interaktiv student-pedagog-sekretari.</i> Por, sipas DVV, GVJ konstaton se FSHAE ka përdorur platformën e Microsoft Teams, duke krijuar klasat virtuale për çdo klasë fizike, ku janë zhvilluar seancat mësimore online, platforma është përdorur për komunikime mes palëve, ngarkim detyrash/projektësh, njoftime, informacione, etj. [Evidencë: 4.7 Rregullore e sekretarisë mësimore në AU]; [Evidencë: 3.2 Klasat në platformën Microsoft Teams - DI]; [Evidencë: 3.4.a Manual për mësimin on-line 2020-2021]; [Evidencë: 3.4.c Video për mësimin on-line 2020-2021].
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	GVJ konstaton se përmes përdorimit të platformës Pitagora, sekretaria mësimore e FSHAE mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit	GVJ vërejtë se në faqen web të AU publikohen të gjitha informacionet për DI dhe programin e studimit bachelor në Inxhinieri Mekatronike. Informacionin ofrohet edhe në gjuhën angleze.

në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	https://albanianuniversity.edu.al/sq/fakulteti-i-shkencave-te-aplikuara-dhe-ekonomike-2/			
Konkluzione				
✓ <i>GVJ konstaton se FSHAE disponon sistemin e menaxhimit Pitagora të RASH për informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim dhe që mbahet nga sekretaria mësimore, ku përdorimi i platformës së informatizuar është komplementar me menaxhimin e dokumentacionit në kopje fizike konform akteve ligjore dhe nën ligjore në fuqi.</i> ✓ <i>Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit Bsc. në Inxhinieri Mekanike. Staf akademik dhe studentët kanë akses të dedikuar, sipas detyrave të tyre (hedhje notash, lexim notash, rregjistrim në provime, etj).</i> ✓ <i>FSHAE ka përdorur platformën e Microsoft Teams, duke krijuar klasat virtuale për çdo klasë fizike ku janë zhvilluar seancat mësimore online.</i>				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Në Statutin e Albanian University në nenin 19 “Senati Akademik” dhe nenin 22 “Bordi i Administrimit” në pikën “k” citohet se SA dhe BA miraton raportin e detajuar vjetor mësimor-kërkimor-shkencor dhe të veprimtarisë financiare dhe ja përçjell MAS, që përfshin edhe tarifat e shkollimit, administrimin e të ardhura financiare/bursave/fondeve kërkimore, etj. Raportet hartohen në bazë institucioni dhe jo të ndara sipas programeve specifike, për vetë natyrën e institucioneve jo publike të arsimit të lartë. Mbështetur në DVV dhe RVB, GVJ evidenton se AU është IAL private me vetëfinancim. Në burimet financiare të AU përfshihen: tarifat e shkollimit, projekte/grante ndërkombëtare, financimet nga ortakët e shoqërisë “UFO shpk”, në cilësinë e pronarit, të ardhurat nga shërbimet që IAL ofron për të tretë dhe burime të tjera të ligjshme. Administratori i përgjithshëm harton në mënyrë periodike raportin financiar të AU, që paraqitet për miratim si pjesë e raportit vjetor pranë SA dhe BA, ku pasqyrohen kostot financiare mesatare për student në nivel universiteti. Nëpërmjet planifikimit të buxhetit kjo strukturë siguron mbështetjen financiare për të paktën një cikël të plotë studimi. [Evidencë: 1.2 Statuti AU, nenet 19, 22];

	[Evidencë: 1.2 Statuti AU, neni 31].
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Sipas RVB, hartimi i programit financiar fillon në muajin shtator dhe miratohet në organet përkatëse brenda muajit dhjetor të vitit paraardhës, bazuar në kriteret e vendosura nga BA, duke mbështetur nevojat e paraqitura nga njësitë bazë dhe kryesore. Pasqyrat financiare të AU që përmbajnë: financimin e burimeve njerëzore, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura, etj, miratohen nga Bordi i Administrimit, (citim) <i>që është organi drejtues kolegjial administrativ më i lartë, i cili ka kompetenca vendimarrëse dhe mbikqyrëse mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare e administrative të UA, sipas Statutit (neni 22).</i> [Ref_23-1.3 Rregullore e AU, neni 6 Veprimtaria e BA].
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Siç deklarohet edhe në RVB: Mbajtja e llogarive, regjistrimeve dhe veprimeve financiare kryhet në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe duke respektuar Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Funksionet administrative, ekonomike dhe financiare realizohen nëpërmjet Zyrës së Financës. Zyra e Auditit të Brendshëm si njësi administrative e AU ka si mision kontrollin e procedurave dhe rregullave të vendosura në rregulloren e funksionimit të Zyrës së Financës dhe Auditit të Brendshëm. GVJ evidenton sipas deklarimit në RVB se pasqyrat financiare auditohen çdo vit nga një palë e tretë e pavarur (nga një kontabël i miratuar dhe i regjistruar), sipas kërkesave të akteve ligjore. [Evidencë: Rregullore e funksionimit të Zyrës së Financës dhe Auditit të Brendshëm – web AU].
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Sipas të dhënave në faqen web të AU zëri më i rëndësishëm është ai i shpenzimeve për mësimdhënie dhe shkencë, e cila nga një përlllogaritje zë mesatarisht rreth 90 % të përdorimit të fondeve. Ndërkohë kategoritë e tjera të mëdha, të cilat janë shpenzime të administrimit të përgjithshëm institucional dhe shpenzime të përgjithshme operative zënë përkatësisht 9% dhe 11% të fondeve.
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për	AU deklaron se ka garantuar qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit, sikurse dhe dëshmon

zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	se ka mundësi për gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen. AU shqyrton dhe analizon kostot duke kontrolluar ecurinë dhe vazhdimësinë konform rregullave dhe standarteve. AU llogarit koston për të gjithë institucionin dhe për programet e veçanta sipas metodologjisë standard, që ka për bazë llogaritjen e shpenzimeve në total/shpenzime të departamentit me numrin total të studenteve / numri i studenteve për departament. GVJ vlerëson se Bsc. në Inxhinieri Mekatronike është afër kuotave të planifikuara të studentëve dhe kjo gjë garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit, duke qenë se të ardhurat kryesore vijnë nga tarifat e studimit.
---	---

Konkluzione

- ✓ GVJ vlerëson se AU garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit bachelor në "Inxhinieri Mekatronike" dhe mbështetjen e studentëve.
- ✓ AU zhvillon aktivitetin si institucion privat i arsimit të lartë dhe çdo vit harton një raport financiar të gjendjes financiare të shoqërisë dhe fluksit të parasë në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe në pajtim me ligjin nr 9228/4 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".
- ✓ Institucioni ka kryer auditimin periodik çdo vit nga palë të treta, duke vlerësuar gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij, si edhe raporton çdo vit akademik pranë MAS lidhur me veprimtarinë e tij duke përfshirë ndër të tjera dhe administrimin e të ardhura financiare / bursave / fondeve kërkimore, etj.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e	GVJ evidenton se AU në drejtim të politikave në nivel institucioni, njësie kryesore e njësie bazë ka hartuar dhe zbaton plane strategjike, bazuar në legjislacionin në fuqi.

plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Kreu V i strategjisë të AU përcakton drejtimet zhvillimore (citim): <i>1. Përmirësimi i vazhdueshëm i kurrikulave mësimore, me përshtatje me kërkesat e tregut të punës dhe me nevojat aktuale të shoqërisë në një kontekst kombëtar, europian dhe botëror, duke promovuar dhe ofruar programe akademike në përputhje me kërkesat europiane dhe me nivelin aktual të dijes, zhvillimit dhe inovacionit; ...</i> Në bazë të DVV, GVJ evidenton se AU/FSHAE/DI kanë hartuar kuadrin ligjor si rregullore, udhëzime, procedura, të cilat zbatohen në të gjithë rrugëtimin e një studenti: informimin, pranimin, përparimin, transferimin/ njohjen e studimeve të mëparshme ose të pjesshme, vlerësimin e dijeve/ ankimimin dhe në fund diplomimin e tij, në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë dhe aktet e tjera rregullatore në zbatim të tyre, me qëllim mbulimin e plotë të cikleve të studimit. AU ka hartuar Manifestin akademik dhe Manualin e studentëve për programet e studimit, të cilat janë instrumente të rëndësishme në drejtim të informimit të studentit për të gjithë kohëzgjatjen e studimeve. [Evidencë: 1.4.a Plani strategjik i zhvillimit instituc në AU 2017-2022]; [Evidencë: 1.4.c Strategji për zhvillimin institucional të AU 2023-2028]; [Evidencë: 1.4.b Plani i masave të Rektoratit në AU në përmbushje të planit strategjik të zhvillimit institucional 2017-2022]. https://albanianuniversity.edu.al/sq/manuali-i-studenteve/[info@au.edu.al - studenti].
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Grupi i vlerësimit, evidenton se kriteret e pranimit të propozuar nga DI bëhen publike në website të AU dhe afishohen në vende të dukshme në mjediset e FSHAE duke garantuar barazitë në ofrimin e shërbimeve ndaj tyre si dhe duke mundësuar një konkurrencë të drejtë. Para procesit të pranimit të kandidatëve, komisioni i ankimimit i ngritur nga Dekani i FSHAE, shqyrton ankesat e studentëve. Regjistrimi i studentëve në programin e studimit Bsc. në Inxhinieri Mekatronike, kryhet pranë sekretarisë mësimore të FSHAE, duke zbatuar renditjen sipas listave të publikuara të studentëve fitues nëpërmjet një procesi transparent dhe jo diskriminues. https://albanianuniversity.edu.al/sq/category/regjistrime-ne-au-sq/
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për	Sipas DVV, kriteret e pranimit shpallen nga AU dhe vihen në dispozicion të QSHA dhe në portalin e RASH. Kriteret për pranim në programin e studimit Bsc. në Inxhinieri Mekatronike, jepen në

t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Rregulloren e këtij programi, në nenin 10 "kriteret dhe procedurat e pranimit të studentëve". Nga takimet me drejtuesit, GVJ evidenton se kriteret e veçanta për zgjedhjen e studentëve vendosen mbështetur në një analizë të kushteve konkrete në të cilat veprohet, duke synuar të tërhiqen kandidatët me rezultate më të larta. Në FSHAE, për programet inxhinierike të ofruara nga DI kriteret e përzgjedhjes janë: mesatarja e përgjithshme 70% dhe mesatarja e gruplëndëve 30%, ku: Informatikë 10%, Matematikë 10% e Fizikë 10%. Këto kriteret dhe procedurat përkatëse gjenden në faqet web të AU. [Evidencë: H.1 Rregullore e programit Bsc. në Inxhinieri Mekatronike]. https://albanianuniversity.edu.al/sq/kriteret-e-pranimit/
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin janë të përcaktuara në Rregulloren e regjistrimeve dhe transferimeve në AU [Kreu III, nenet 18-25]. Këto kushte janë publike dhe në faqen zyrtare të AU Platforma informatike Pitagora që ofrohet nga RASH e përdorur prej studentëve, u ofron atyre akses të plotë mbi procedurat e përparimit akademik në çdo kohë, si dhe marrjen e shërbimeve të tjera, etj. Për listën e notave dhe vërtetimet e studentit, ky i fundit mund të aplikojë në sekretarinë mësimore. GVJ, nga vlerësimi i dokumentave në faqen web të AU, konstaton se njohja e plotë dhe e pjesshme e krediteve të studentëve që vijnë me transferim nga programe të tjera studimi brenda ose dhe jashtë AU, mundësohet sipas Rregullores së regjistrimeve dhe transferimeve në AU dhe bëhet nga Zyra e transferimeve dhe ekuivalentimeve të studimeve, përmes aplikimit nga ana e studentit, me plotësimin e formularit dhe dorëzimin e dokumentacionit përkatës sipas kësaj Rregulloreje. https://albanianuniversity.edu.al/sq/rregullore-e-regjistrimeve-dhe-transferimeve/; https://au.pitagora.rash.al/login
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Përpara fillimit të çdo viti akademik AU informon maturanët në ditët e caktuara nga MAS. Më pas gjatë vizitave në shkolla të mesme. GVJ konstaton se të gjitha strukturat e AU që kanë lidhje direkt me informimin dhe pranimin e studentëve të rinj, si sekretaritë mësimore, zyra e koordinimit dhe mbështetjes për studentët, zyra e karrierës & alumnit dhe zyra e financës kanë të publikuara oraret e pritjes së studentëve për plotësimin e nevojave të tyre.



	GVJ evidenton se kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për pranimin e studentëve përshkruhen në Kreun II të Rregullores së regjistrimeve dhe transferimeve në AU [Kreu II, nenet 5-16]. Informacioni mbi kriteret dhe procedurat përkatëse aksesohet lehtësisht nga studentët në faqen web të AU.
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Sipas RVB, GVJ evidenton se Senati Akademik i “Albanian University” përpara fillimit të çdo viti akademik miraton kriteret dhe kuotat, ku përfshihen edhe kategoritë e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave, kandidatëve nga trojet dhe shtresat e marginalizuara. Nuk ka evidencë për kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve të këtyre kategorive.
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Përpara fillimit të çdo viti akademik AU miraton dhe publikon kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve në faqet web të AU Nuk ka evidencë për kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. https://albanianuniversity.edu.al/sq/kriteret-e-pranimit/
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimin në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Sipas RVB, GVJ evidenton se “Albanian University” harton politika për të ndihmuar studentët që i përkasin shtresave në nevojë dhe atyre të kategorive të veçanta. Me propozim të Senatit Akademik dhe miratim të Bordit të Administrimit, përcaktohen kategoritë e studentëve, të cilët përfitojnë bursa të ndryshme studimi. Në faqen web të AU janë shfaqur bursat e përfituara nga studentët ndër vite. https://albanianuniversity.edu.al/sq/bursat/
Konkluzione ✓ GVJ vlerëson se AU/FSHAE/DI kanë hartuar, ndjekin dhe zbatojnë politika, strategji dhe procedura për të gjithë rrugëtimin e studentëve të ciklit të parë që nga faza kur janë akoma kandidatë për studentë dhe pastaj për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Mekatronike”. ✓ GVJ vlerëson si shumë të dobishme 2 dokumenta bazë për studentët: guidën “Manifestin akademik” dhe “Manualin e studentëve”, që sjellin informimin e të interesuarve për programet e studimit që ofrohen në AU. ✓ GVJ evidenton se AU/FSHAE/DI kanë hartuar kuadrin ligjor si rregullore, udhëzime, procedura, të cilat zbatohen në të gjithë rrugëtimin e një studenti. Nga bërja publike e këtyre rregulloreve dhe procedurave në website të AU garantohen transparencë dhe barazi në ofrimin e shërbimeve ndaj tyre, duke mundësuar një konkurrencë të drejtë bazuar në vlerat individuale të gjithësecilit student.	

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Nga informacioni në RVB, DVV dhe nga takimet në AU, GVJ konstaton se studentët, janë njohur dhe të qartë, lidhur me kriteret në përparimin akademik, kalimin nga një vit në tjetrin dhe kriteret për kalimin në çdo lëndë. Këto kritere përcaktohen në neni 12, pika d) të Rregullores së programit të studimit Bsc. në Inxhinieri Mekanike ku citohet: <i>Studenti lejohet të regjistrohet në vitin pasardhës, kur ka fituar të paktën 50% të krediteve të detyrueshme të vitit paraardhës. Lëndët, të cilave u përkasin kreditet e mbetura, konsiderohen detyrime të mbartura. Kushtet dhe rendin e shlyerjes së detyrimeve të mbartura për fitimin e krediteve të mbetura i cakton Departamenti përkatës, në zbatim të rregullores së Fakultetit.</i> Nga vizita në sekretari, grupi i vlerësimit konstatoi se Platforma Pitagora që ofrohet nga RASH u ofron studentëve akses të plotë mbi procedurat e përparimit akademik në çdo kohë. [Evidencë: H.1 Rregullore e programit Bsc. në Inxhinieri Mekanike, neni 12 Kohëzgjatja e studimeve]. https://albanianuniversity.edu.al/sq/forma-e-vleresimit-brenda-sistemit-shqiptar-dhe-europian/ https://au.pitagora.rash.al/login
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.	Sipas RVB, AU mund të njohë si kredite të formimit universitar, në programet e veta të studimit, njohuri dhe aftësi profesionale të certifikuara sipas akteve ligjore në fuqi, si dhe njohuri të veprimtarive formuese, të nivelit të ciklit të parë dhe që janë në përputhje me objektivat specifike të programit bachelor në Inxhinieri Mekanike. Këto kritere përcaktohen në nenet 18-25 të Kreut III të Rregullores së regjistrimeve dhe transferimeve në AU dhe bëhen publike dhe të aksesueshme nga studentët në faqen zyrtare web të AU. https://albanianuniversity.edu.al/sq/rregullore-e-regjistrimeve-dhe-transferimeve/
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të	GVJ konstaton se rregulloret dhe procedurat e miratuara të AU/FSHAE kanë të përcaktuara qartë kriteret, mënyrën, modalitetet dhe kërkesat për vlerësimin e dijeve, njohurive dhe

dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	aftësive të studentëve. Këtu përfshihen procedurat që duhen ndjekur, rregullat e hartimit të tezave, monitorimi, e drejta e studentit për të hyrë në provim, vlerësimi i studentëve (vlerësimi shprehet në notë dhe gurmë). Këto kritere dhe procedura janë të aksesueshme dhe në faqen web të AU Nga takimet me stafin akademik, GVJ konstatoi se pedagogët, në fillim të çdo semestri, nëpërmjet prezantimit të syllabusit informojnë studentët në mënyrë më specifike për peshën e secilës mënyrë vlerësimi (provim i ndërmjetëm, vlerësimi i projektit/detyrës së kursit, vlerësim i punëve të laboratorit, provim përfundimtar) në lëndët që zhvillojnë mësim në programin e studimit Bsc. në Inxhinieri Mekatronike. Studentët mund t'i sigurojnë informacionet e mësipërme edhe nëpërmjet Sekretarisë mësimore. <i>[Evidencë: H.1 Rregullore e programit Bsc. në Inxhinieri Mekatronike, neni 24 Kontrolli dhe vlerësimi i dijes].</i> https://albanianuniversity.edu.al/sq/forma-e-vleresimit-brenda-sistemit-shqiptar-dhe-europian/
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	GVJ konstaton se AU/FSHAE/DI ndjekin një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit. Në nenet 28-30 të Kreu-t Diplomimi të Rregullores së programit të studimit Bsc. në Inxhinieri Mekatronike janë parashikuar kriteret e përgjithshme dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit, të cilat janë të aksesueshme dhe në faqen web të AU. FSHAE ka hartuar dhe zbaton një procedurë të veçantë për diplomimin, e aksesueshme për stafin akademik dhe studentët në faqen web të institucionit. Studentët informohen në lidhje me këto kritere dhe procedura edhe nga stafi i Departamentit të Inxhinierive, përmes faqes së internetit, etj. Në nenin 29 të Rregullores së programit të studimit citohet: <i>brenda një muaji nga data e fillimit të vitit akademik, Përgjegjësi i Departamentit u bën të njohur studentëve, të cilët diplomohen atë vit, programin e provimit të formimit ose të temave të diplomave.</i> Gjatë semestrit të parë të vitit të tretë studentët mbajnë marrëdhënie më të ngushta me profesorët dhe zgjedhin nga temat që janë depozituar nga ato pranë departamentit. Studenti diplomant informohet e drejtohet në këtë proces nga udhëheqësi i tij. https://albanianuniversity.edu.al/sq/manuali-per-punimin-e-temes-se-diplomes/
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në	GVJ nga takimet në institucion evidenton se Zyra e Koordimit dhe Mbështetjes për studentët (Tutoriat & Mentorimi) harton dhe

mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	publikon çdo fillim viti guidën Manifestin akademik, për t'u ardhur në ndihmë studentëve lidhur me vendosjen e godinave, programet e studimit që ofrohen, mundësinë e marrjes së shërbimeve të dedikuara për to, etj. FSHAE dhe Zyra e Karrierës & Alumnit organizojnë takime informuese për studentët si në fillim viti, ashtu edhe përgjatë gjithë periudhës së studimeve. https://albanianuniversity.edu.al/sq/category/studenti/manuale-dhe-udhezime/
---	--

Konkluzione

- ✓ GVJ vlerëson se AU/FSHAE/DI vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm mbi programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri Mekatronike", syllabuset, përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.
- ✓ Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, AU publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri Mekatronike".
- ✓ Faqja zyrtare ueb është burim i rëndësishëm informacioni të nevojshëm në lidhje me programin mësimor. AU/FSHAE/DI informojnë studentët dhe publikun edhe përmes broshurave, fletëpalosjeve dhe fushatave të informimit.
- ✓ Informim tek studentët jep edhe Sekretaria Mësimore, në drejtim të rregullave për frekuentimin, kalimin në vitet pasardhëse, etj.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	GVJ në bazë të DVV, evidenton se struktura, organizimi dhe kohëzgjatja e programit të studimit Bsc. në Inxhinieri Mekatronike, janë të përcaktuara në Rregulloren e këtij programi. Nga takimi me studentët GVJ konstatoi se ato informohen që në momentin e regjistrimit e në vazhdim pranë Sekretarisë mësimore, si dhe gjatë javës së parë të mësimit nga pedagogu i lëndës. Informacioni në lidhje me programin e studimit, stafin akademik që e mbështet, detyrimet e të dy palëve, etj, është detyrë e Koordinatorës së programit IM, pedagogëve të çdo lënde, Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për studentët (Tutoriati & Mentorimi), Zyrës së Karrierës & Alumnit.

(Signature)

	[Evidencë: H.1 Rregullore e programit Bsc. në Inxhinieri Mekatronike, Kreu II Elementet e programit mësimor, nenet 4-8].
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	GVJ konstaton si një praktikë të mirë publikimin nga AU të 3 dokumenteve “Manifesti Akademik”, “Manuali i studentëve” e “Udhëzuesi i Karrierës” që shërbejnë si guidë, ku studenti merr informacionet kryesore në lidhje me jetën e tij studentore. Sipas DVV e takimeve me stafin e studentët, GVJ evidenton se me fillimin e semestrit pedagogu bën publik informacionin mbi modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese, ky informacion pasqyrohet edhe në syllabusin e lëndës, si dhe publikohen në faqen ëeb (kurrikula). https://albanianuniversity.edu.al/sq/fakulteti-i-shkencave-te-aplikuara-dhe-ekonomike-2/ https://albanianuniversity.edu.al/sq/category/studenti/manuale-dhe-udhezime/
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	GVJ në bazë të DVV dhe takimeve në institucion evidenton se në AU, Zyra e Koordimit dhe Mbështetjes për studentët (Tutoriat & Mentorimi) dhe Zyra e Karrierës & Alumnit kanë përgjegjësinë institucionale të informimit dhe orientimit të studentëve, si dhe për të ofruar mundësi punësimi, këshillim karriere, etj. Ato në bashkëpunimin me industrinë, biznesin, kompanitë dhe institucionet, organizojnë takime të hapura me biznese, industri e organizata në grupe dhe individuale të cilët promovojnë mundësitë e karrierës pranë tyre për studentët e AU, bëjnë të mundur realizimin e praktikave mësimore të studentëve, e që shërbejnë edhe si mundësi për njohjen e tregut të punës dhe për intership-e, trajnime dhe punësimin e mëtejshëm të studentëve mbas diplomimit. Një rol të rëndësishëm luajnë dhe mobilitetet e studentëve pranë kompanive të huaja në vende të ndryshme të BE-së. [Evidencë: 5.2 Rregullore e Zyrës së Koordimit dhe Mbështetjes për studentët, nenet 2-4]; [Evidencë: 5.3 Rregullore e Zyrës së Karrierës & Alumnit, nenet 2-3]; [Evidencë: 5.1.a Panair pune 2024]; [Evidencë: 5.1.a Panair pune 2024]; [Evidencë: 5.1.b Si të punësohesh 2022]; [Evidencë: R.5.a Punësimi i studentëve Alumni 2023]; [Evidencë: Vizita TEC Vlorë 2019-2024]; [Evidencë: 3.10.a Studentë për eskursion CEEPUS]; [Evidencë: 3.11.b Aplikim studentë për mobilitet CEEPUS].
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e	GVJ nga takimet me studentët dhe DVV konstaton se AU/FSHA/EDI u jep studentëve informacion të gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, infrastrukturën e logjistikën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij nëpërmjet:



procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	✓ Stafit akademik që këshillon/informon çdo student të interesuar për programet e studimit; ✓ Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes për studentët (Tutoriati & Mentorimi) që e ka detyrë parësore ofrimin e shërbimit për studentët; ✓ Rregulloreve të AU/FSHAE/DI/Rregullores së programit të studimit Bsc. në Inxhinieri Mekatronike; ✓ Javës së Orientimit, që organizohet në fillim të çdo viti akademik. Koordinatori i programit të studimit mban kontakte të rregullta, njoftime elektronike me studentët që ndjekin këtë program, për azhurnimin e tyre mbi infrastrukturën, aktivitete të ndryshme, informacione që lidhen me oraret, bibliotekën, rregulloret dhe procedurat e ndryshme të institucionit, etj.
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Informacioni në lidhje me programin e studimit Bsc. në Inxhinieri Mekatronike u vihet në dispozicion studentëve në ambientet e Universitetit, në sekretarinë online, në klasat Microsoft Teams dhe në faqen e tij web info@au.edu.al Sipas DVV e vizitave në sekretari, GVJ evidenton se studentët marrin informacion edhe përmes platformës Pitagora të sekretarisë mësimore https://au.pitagora.rash.al/login Studentët me kredencialet personale mund të informohen on-line për përparimin e tyre akademik (notat e marra, lëndët që duhet të ndjekin, etj).
Konkluzione GVJ vlerëson se AU/FSHAE/DI kanë vënë në dispozicion të studentëve struktura dhe mjete për informim, orientim dhe ndihmë, përkatësisht: ✓ Zyrën e Koordinimit dhe Mbështetjes për studentët (Tutoriati & Mentorimi) që e ka detyrë parësore ofrimin e shërbimit për studentët; ✓ Stafin akademik që këshillon/informon çdo student të interesuar për programet e studimit, përmes konsultimeve, takimeve, Koordinatorin e programit të studimit, Drejtuesin e departamentit DI, Zv. Dekanit mësimor i FSHAE, etj. ✓ Rregulloreve të AU/FSHAE/DI/Rregullores së programit të studimit Bsc. në Inxhinieri Mekatronike, procedurave, etj; ✓ Platformës së Sekretarisë Mësimore PITAGORA https://au.pitagora.rash.al/login përmes përdorimit të "user name" dhe "passëord", me të cilin studentët pajisen në momentin e regjistrimit në programin e studimit; ✓ Komunikimit nëpërmjet platformës Microsoft TEAMS, në grupin (klasën) online të krijuar nga pedagogui lëndës; ✓ Informacioneve në faqet zyrtare web të AU info@au.edu.al	

✓ Informacionin në lidhje me studentët nëpërmjet 3 dokumenteve "Manifesti Akademik", "Manuali i studentëve" e "Udhëzuesi i Karrierës" https://albanianuniversity.edu.al/sq/category/studenti/manuale-dhe-udhezime/, etj. ✓ GVJ vlerëson se AU/FSHAE/DI kanë vënë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit Bsc. në Inxhinieri Mekatronike, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit. ✓ AU/FSHAE/DI informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4							
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.							
Kriteret		Vlerësimi i ekspertëve					
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.		GVJ evidenton se AU/FSHAE disponon statistika të plota (regjistrimet, transferimet, çregjistrimet, kalueshmërinë, cilësinë në hyrje dhe dalje, shkallën e punësimit) mbi ecurinë e studentëve. Programi i studimit Bsc. në Inxhinieri Mekatronike, është ofruar nga DI/FSHAE/AU për herë të parë në vitin 2011-2012 (Urdhër Ministër MASH nr. 488, datë 04.10.2011). Të dhëna për studentët sipas 3 viteve 2021-2024:					
		Bsc. në Inxhinieri Mekatronike		Të rregjistruar për herë të parë në vitin e parë (a)	Të transferuar (b)	Totali (a) + (b)	Nota mes në hyrje
			2021 -2022	20	16	36	7.41
			2022-2023	23	9	32	7.26
			2023-2024	20	9	29	7.38
[Evidencë: Anekset Tabelat përmbledhëse, tabela 21]							
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si		Në takime me GVJ u theksua roli i Sekretarisë mësimore që nëpërmjet sistemit Pitagora mban rekorde të detajuara për studentët e regjistruar, të çregjistruarit dhe të pezulluarit me numrin përkatës të matrikullimit për çdo program studimi. Të dhënat statistikore nxirren nga dokumentet bazë: Regjistri themeltar, Regjistri i arritjeve akademike, Regjistri i diplomave.					

dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Sipas DVV, GVJ evidenton se statistikën vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për programin Bsc. në Inxhinieri Mekatronike, pasqyrohen në Raportin e përvitshëm të analizës vjetore të DI. GVJ konstaton se AU në nivel institucioni, disponon statistika vjetore për numrin e studentëve dhe të të diplomuarve për çdo program studimi, për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve, të cilat raportohen në raportet vjetore të AU.
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Informacioni lidhur me ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre bazuar në (Ligjin e arsimit të lartë nr.80/2015, nenin 101) mbahet nga Sekretaria mësimore e FSHAE dhe ruhen në format fizik dhe elektronik, sipas rregullave në fuqi e mënyrës së përcaktuar nga udhëzimet e MAS. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. Platforma Pitagora ndihmon në lidhje me vlerësimet e stafit akademik për çdo provim, detyrimet e studentëve, realizohen menaxhimi i karrierës së studentëve si: hyrjen (regjistrimin e tyre në programe studimi) dhe lëvizjet (transferimet e tyre), faturimet, pagesat, menaxhimin e mësimdhënies, klasat, transkriptet e notave, etj. Nga DVV, GVJ konstaton se të dhënat menaxhohen me saktësi dhe kontrollohen vazhdimisht nga strukturat drejtuese.
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Sipas kërkesave ligjore, institucioni ka të detyrueshme ruajtjen e të dhënave si në Regjistrin themeltar, Regjistrin e arritjeve (notave) dhe Regjistrin e Lëshimit të Diplomave në dy forma: hardcopy dhe në formë dixhitale. GVJ konstatoi se për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në Inxhinieri Mekatronike, janë hedhur të dhënat në dy format. Në zbatim të nenit 3, të Rregullores së Sekretarisë mësimore të FSHAE kryesekretarja mbikqyr dhe kontrollon çdo dokumentacion në lidhje me studentët dhe veprimtarinë e tyre, në përfundim të çdo semestri, përgatit dhe dorëzon pranë Dekanit dhe Rektorit, një raport të veçantë me të dhëna të detajuara mbi realizimin e detyrave të fushave që mbulon. [Evidencë: 4.7 Rregullore e Sekretarisë mësimore, neni 3, pika 14].



Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.

Sipas DVV, GVJ konstaton se në Raporti i analizës vjetore të DI hartuar në përmbushje të kërkesave të Udhëzimeve të MAS jepen të dhëna mbi numrin e studentëve të regjistruar, të diplomuar, transferuar, reregjistruar; nota mesatare në hyrje dhe në përfundim të programit, shkallën e punësimit të tyre, etj., si dhe masat në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.

Studentë Vitet	Gjithsej të regjistruar	Regjistruar për herë të parë	Të transferuar	Stazhier të konfirmuar
Viti akademik 2023-2024, semestri i parë				
Viti i parë	24	20	4	0
Viti i dytë	26	24	2	0
Viti i tretë	27	22	3	2
Viti akademik 2022-2023				
Viti i parë	26	22	4	0
Viti i dytë	24	22	2	0
Viti i tretë	35	32	3	2
Viti akademik 2021-2022				
Viti i parë	26	20	6	0
Viti i dytë	35	28	6	1
Viti i tretë	29	24	4	1

Studentë Vitet	Të diplomuar	Kalueshmëria në %	Nota mesatare
Viti akademik 2023-2024, semestri i parë			
Viti i parë		83.6	5.7
Viti i dytë		91.8	6.4
Viti i tretë	1*	98.5	7.1
Viti akademik 2022-2023			
Viti i parë		90.5	6.6
Viti i dytë		100.0	6.8
Viti i tretë	31**	96.7	7.7
Viti akademik 2021-2022			
Viti i parë		92.0	6.3
Viti i dytë		91.4	6.7
Viti i tretë	33***	99.3	7.2

* - 1 i diplomuar në sezonin e mbartjes v.a. 2023-2024

** - 1 i diplomuar në sezonin e mbartjes v.a. 2022-2023

*** - 7 të diplomuar në sezonin e mbartjes v.a. 2021-2022

Ndërsa gjurmimi i punësimit të studentëve ndiqet dhe përditësohet nga Zyra e Karrierës dhe Alumni.

[Evidencë: 1.1.a Raporti vjetor i DI për v.a. 2021-2022];

[Evidencë: 1.1.b Raporti vjetor i DI për v.a. 2022-2023];

[Evidencë: 1.1.c Raporti vjetor i DI për 2023-2024, semestri i parë]; [Evidencë: R.5.a Punësimi i studentëve Alumni 2023].				
Konkluzione				
✓ GJV konstaton struktura të ngritura brenda institucionit në lidhje me menaxhimin e të dhënave të studentëve. Sekretaria mësimore këto të dhëna i disponon në formë të shkruar (hard copy) dhe në formë elektronike në Regjistrin themeltar, Regjistrin e arritjeve (notave) dhe Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave, sipas mënyrës së përcaktuar në udhëzimet përkatëse të MAS. ✓ Përmes platformës Pitagora, Sekretaria Mësimore realizon online menaxhimin e karrierës së studentëve si: hyrjen (regjistrimin e tyre në programe studimi) dhe lëvizjet (transferimet e tyre), çregjistrimet e diplomimit, pagesat, vërtetimet e notave, suplementet e diplomave, etj. Këto të dhëna menaxhohen me saktësi dhe kontrollohen vazhdimisht nga strukturat drejtuese (Dekani i FSHAE, Rektori i AU). ✓ GJV vlerëson se DI/FSHAE/AU nëpërmjet këtyre strukturave mbledhin, administrojnë, përditësojnë dhe ruajnë të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin, profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre. ✓ DI e FSHAE dhe AU përmes Zyrës përkatëse, disponojnë statistika vjetore dhe hartojnë raporte analitike vjetore mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	GJV konstatoi se në nenin 19 të Statutit, AU ka parashikuar përfshirjen dhe angazhimin e studentëve (përfaqësuesve të tyre) në organet vendimmarrëse dhe këshilluese, sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit dhe organiogramës së saj. Strukturat më të larta ku përfshihen studentët janë: në SA (1 student – Kryetari i Këshillit Studentor) dhe sipas nenit 25 të Statutit kanë përfaqësuesit e tyre në 3 komisionet e përhershme: Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin, Komisioni për Vlerësimin Institucional e Komisioni për kërkimin Shkencor dhe Botimin. Studentët janë pjesë e Zyrës e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (ZSBC), si edhe përfshihen në Grupin e Vlerësimit të Brendshëm (GVB) të programeve të studimit si dhe të vlerësimit institucional. [Evidencë: 1.2 Statuti i AU, [nenet 19, 25, 67]; [Evidencë: H.2 Shkresë Dekan i FSHAE dhe Drejtues i DI për ngritjen e GVB].

Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	AU garanton përfshirjen reale të studentëve në vendimarrje, këshillim, vlerësim, etj., përmes Këshillave Studentorë. GVJ nga takimet me studentët dhe DVV konstaton se është 1(një) student përfaqësues në SA, 1(një) student në Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin, 1(një) student në Komisioni për Vlerësimin Institucional, 1(një) student në Komisioni për kërkimin Shkencor dhe Botimin, 1(një) student në GVB, të cilët japin opinionet e tyre për çdo vendimarrje që influencon direkt apo indirekt në veprimtarinë e tyre. [Evidencë: 1.2 Statuti i AU, neni 49]. [Evidencë: 6.2 Vendim SA për ngritjen e komisionet e përhershme].
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Sipas DVV, programi i studimit i ciklit të parë Bsc. në Inxhinieri Mekatronike, është hartuar në përputhje dhe zbatim të bazës ligjore në fuqi. GVJ nga takimet me studentët dhe DVV konstaton se studentët përmes përfshirjes në GVB, si dhe pjesëmarrjes në anketimet shprehin mendime dhe propozime për planet dhe programet e studimeve. Gjithashtu studentët, me anë të pjesëmarrjes në anketimet periodike të realizuara në nivel institucional, përfshihen në këshillimet e nevojshme për përmirësimin e cilësisë, si dhe shprehin mendime dhe propozime për planet dhe programet e studimeve. Përfaqësuesit e studentëve janë prezent në mbledhjet e departamentit. [Evidencë: 6.9.a Rezultate pyetësori për stud për 2021-2022, sem I]; [Evidencë: 6.9.b Rezultate pyetësori për stud për 2021-2022, sem II]; [Evidencë: 6.9.c Rezultate pyetësori për studentët për 2022-2023]; [Evidencë: 6.9.d Rezultate pyetësori për stud për 2023-2024, sem I]; [Evidencë: 5.4 Shembull proces-verbal mbledhje e DI].
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	GVJ evidenton se sipas rregullores, neni 23, studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit Argumentimi i vlerësimit nga pedagogu, zhvillimi i seancave sqaruese dhe mundësia e kërkesës për rivlerësim, ku studentët kanë mundësi të parashtrojnë kërkesat e tyre duke plotësuar formularët përkatës, janë tregues të transparencës dhe barazisë së procesit të vlerësimit. Nëse ankesa e studentit ka lidhje me standardet dhe cilësinë e mësimdhënies, shkeljen e rregullave akademike, probleme të tjera



	të procesit mësimor, ankimuesit mund t'i drejtohen drejtuesit të njësisë bazë, drejtuesit të njësisë kryesore apo drejtuesit të institucionit në varësi të kompetencës së shkeljes së vërejtur. Studenti mund të drejtohet për ankesë edhe në Këshillin e Etikës së AU. [Evidencë: H 1 Rregullore e programit të studimit Bsc. në IM, neni 23, Korrigjimi].
--	---

Konkluzione


- ✓ GVJ vlerëson se AU, me akte ligjore, përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese.
- ✓ GVJ konstaton se përfshirja e tyre është reale, si anëtarë në Senatin Akademik, në 3 komisionet e përhershme të SA të AU dhe në ZSBC.
- ✓ Gjithashtu studentët përfshihen në kuadër të miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bsc. në Inxhinieri Mekatronike, metodave të mësimdhënies, saktësisë dhe ndershmërisë në vlerësimin e dijeve dhe cilësisë së shërbimeve ndaj tyre. Kjo përfshirje realizohet me pyetësorët që realizohen çdo vit , etj.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	GVJ konstaton se strukturat në funksion të orientimit, informimit dhe shërbimit të studentëve në AU janë 2: a) Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për studentët (Tutoriati & Mentorimi) në AU që ofron shërbime për informimin, organizimin e jetës studentore, etj; b) Zyra e Karrierës dhe Alumnit në shërbim të studentëve për lehtësimin e lidhjes ndërmjet karrierës akademike dhe mundësive të punësimit dhe promovimin e tyre, etj. Këto njësi/struktura kanë procedura gjithë vjetore në shërbim të studentëve dhe rregullore të funksionimit të tyre, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të vetë universitetit. Në vijim studentët marrin informacion për përdorimin e platformave, etj në AU nëpërmjet komunikimeve me zyrën IT dhe materialeve të përgatitura nga sekretaria. [Evidencë: 5.2 Rregullore e Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes për studentët (Tutoriati & Mentorimi), neni 2]; [Evidencë: 5.3 Rregullore e Zyrës së Karrierës dhe Alumnit, neni 2].



Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Studenti njihet me informacionin kryesor në lidhje me jetën e tij studentore nëpërmjet 3 dokumenteve: “Manifesti Akademik”, “Manuali i studentëve” e “Udhëzuesi i Karrierës”. Sipas DVV e takimeve në institucion, GVJ konstaton se AU ofron tutoriatin gjatë gjithë vitit akademik, sipas semestrave dhe orareve të përshtatshme për pedagogët dhe studentët. Departamenti DI ndihmon studentët që hasin vështirësi për përvetësimin e lëndëve, apo plotësimin e detyrimeve të ndryshme, nëpërmjet orëve të konsultimit të zhvilluara me pedagogët. GVJ evidentoi se përmes Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes për studentët (Tutoriati & Mentorimi) ofron (citim): <i>“shërbime për studentët e “Albanian University”, të cilët kanë për qëllim orientimin e edukimit profesional, lehtësimin e zhvillimit të karrierës, përgatitjen për tregun e punës dhe mbështetje për të vazhduar aftësimin e tyre profesional nëpërmjet të mësuarit gjatë gjithë jetës”</i>. Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për studentët (Tutoriati & Mentorimi) organizon, menaxhon dhe drejton këshillimin e studentëve në lidhje me procesin akademik dhe çështje të tjera të lidhura me to, si dhe bashkëpunon ngushtë me departamentet për organizimin dhe realizimin e praktikave profesionale të studentëve. Kjo lidh dhe lehtëson integrimin e studentëve në tregun e punës dhe i shërben realizimit të këshillimit për karrierë. https://albanianuniversity.edu.al/sq/zyra-e-koordinimit-dhe-mbeshtetjes-ndaj-studentit/
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Nga organigrama dhe nga DVV, kontatojme se strukturat që kanë këtë detyrë në AU janë: Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për studentët (Tutoriati & Mentorimi) dhe Zyra për Karrierën dhe Alumni. Zyra e Karrierës dhe Alumni ka si qëllim (citim) (neni 2 i Regullores): ➤ <i>Organizimin e aktivizimit të studentëve pas përfundimit të programit të studimit në veprimtari jashtë mësimore me karakter shkencor, profesional, social dhe kulturor;</i> ➤ <i>Shkëmbimin e ideve me studentët e diplomuar, diskutime rreth temave aktuale, organizimi i aktiviteteve kompetitive, organizimi i tureve, përfshirja në konferenca shkencore, fushata humanitare dhe ato me karakter ndërgjegjëses;</i> ➤ <i>Lehtësimin e lidhjes ndërmjet karrierës akademike dhe mundësive të punësimit dhe promovimin e tyre në kompanitë, organizatat dhe shoqëritë e ndryshme të interesuara për punëmarrës. Gjithashtu synon të drejtojë studentin në zhvillimin e karrierës, nëpërmjet vlerësimit të interesave personale dhe harmonizimin e tyre me pozicione pune, paga</i>



	<i>dhe kushte pune të dëshiruara nga të 2 palët e marrëveshjes së punësimit.</i> GVJ konstaton se AU është gjithmonë i hapur për aktivitete të përbashkëta me industrinë dhe mbështet aktivisht zhvillimin e aftësive praktike të studentëve. AU ofron shërbime me pikësnyim integrimin e të diplomuarve të tij në tregun e punës. ALUMN-it shërben si urë lidhëse midis studentëve dhe tregut të punës, duke krijuar kontaktet e duhura me punëdhënësit potencial. [Evidencë: 5.1.b Si të punësohesh]; [Evidencë: 5.1.a Panair pune].			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	GVJ, mbi bazën e DVV, evidenton se Zyra e Karrierës dhe Alumni në FSHAE ka krijuar një databazë dhe komunikon vazhdimisht me studentët për mundësitë për punësimin e tyre. GVJ nga takimet e palëve të ndryshme në institucion konstaton gjithashtu se të gjitha strukturat, profesorati, laborantët, etj., angazhohen për krijimin e mundësive për punësim të studentëve. Zyra mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar për të ndjekur ecurinë e tyre të punësimit, për ata që janë të punësuar dhe për të ofruar mundësi punësimi dhe këshillim karriere për ata që nuk janë punësuar ende. Kjo Zyrë mban një databazë me të dhënat e çdo studenti të diplomuar, mban statistikën përkatëse; përpunon statistikën dhe gjeneron raporte në lidhje me to dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. [Evidencë: 5.3 Regulloret e Zyrës së Karrierës dhe Alumnit, neni 8]. [Evidencë: R.5.a Punësimi i studentëve Alumni 2023].			
Konkluzione ✓ <i>GVJ vlerëson se AU ka procedurë e njësi të posaçme (Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për studentët (Tutoriati & Mentorimi) dhe Zyra e Karrierës dhe Alumnit; Dekani i FSHAE; Sekretaria mësimore; Koordinatorin e Programit të Studimit; Sistemin e tutorazhit përmes pedagogëve për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave.</i> ✓ <i>Këto njësi e ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</i> ✓ <i>Zyra e Karrierës dhe Alumni në AU i ndjek studentët pas diplomimit, mban të dhëna mbi shkallën e punësimit të studentëve të programit të studimit, dhe informon organet e autoritetet drejtuese/ose politikëbërëse.</i>				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Sipas DVV, GVJ evidenton se 2 strukturat përgjegjëse të AU: Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, të cilat janë përgjegjëse për mësimdhënien dhe sigurimin e cilësisë së brendshme, zhvillojnë mekanizma të monitorimit, vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. Institucioni me qëllim sigurimin e cilësisë në mësimdhënie në AU, gjatë periudhës së pandemisë COVID-19, ka hartuar manual dhe video ilustruese për zhvillimin e mësimin në distancë dhe ka zhvilluar trajnime për përdorimin e platformave informatike, për të mbështetur mësimin online. [Evidencë: 6.6 Regullore për mbarëvajtjen e kurrikulave dhe procesit mësimor në AU (Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave)]; [Evidencë: 6.10 Regullore për organizimin dhe funksionimin e NjSBC]; [Evidencë: 3.4.a Manual për realizimin e procesit mësimor në distancë]; [Evidencë: 3.4.c Video ilustruese për mësimin online]; [Evidencë: 3.2. Klasat në Microsoft Teams për mësim në distancë].
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Konstatojnë se në AU, strukturat përgjegjëse kanë krijuar instrumentat për monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë periodike të aftësitë mësimdhënëse dhe inovative: ➤ Pyetësorë të studentëve, ➤ Fokus grupe me studentët, ➤ Raporte vetëvlerësimi nga pedagogët, ➤ Formular i veprimtarisë kërkimore – shkencore për secilin pedagog, ➤ Formular i Drejtuesit të departamentit për secilin pedagog, ➤ Raport vjetor vetëvlerësimi për zhvillimin e programit, ➤ Pyetësor drejtuar stafit akademik, ➤ Raportet semestrale & vjetore të njësive bazë dhe kryesore.

	Mbi bazën e dokumentave të VV, GVJ evidenton se, strukturat përgjegjëse në bashkëpunim me njësitë bazë, monitorojnë në vazhdimësi plotësimin e standardeve të cilësisë në mësimdhënie nga stafi akademik dhe ai ndihmës akademik, përmes vlerësimeve semestrale të studentëve dhe raporteve semestrale të vetë pedagogëve. [Evidencë: 6.8.a Fokus grupe për v.a. 2021-2022]; [Evidencë: 6.8.b Fokus grupe për v.a. 2022-2023]; [Evidencë: 6.8.c Fokus grupe për v.a. 2023-2024, deri prill 2024]; [Evidencë: 6.7 Vlerësime specifike për programin Inxh. Mekatronike].
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	GVJ evidenton se ZSBC është përgjegjëse kundrejt hartimit të kalendarit të procesit të vlerësimit nga studentët në nivel institucional, ndjek realizimin e tij, si dhe bashkëpunon me drejtuesit e FSHAE e të DI për realizimin e këtij procesi dhe ecurinë e veprimtarisë mësimore. [Evidencë: 6.9.a Rezultate pyetësori për stud 2021-2022, sem I]; [Evidencë: 6.9.b Rezultate pyetësori për studen 2021-2022, sem II]; [Evidencë: 6.9.c Rezultate pyetësori për studentët 2022-2023]; [Evidencë: 6.9.d Rezultate pyetësori për studen 2023-2024, sem I].
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	GVJ nga takimet në institucion, konstatoi se ZSBC ka kryer rregullisht anketimin semestral studentor mbi cilësinë në mësimdhënie dhe mbi bazën e tyre ka përgatitur raportin për cilësinë e mësimdhënies për çdo program studimi në AU, i cili gjendet dhe online në faqen web. https://forms.office.com/Pages/AnalysisPage.aspx/?/
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Të dhënat pasi përpunohen nga ZSBC, i vihen në dispozicion departamentit, i cili i diskuton në tërësi në mbledhjen e radhës. Vlerësimi personal i bëhet i ditur pedagogëve individualisht përmes e-mailit dhe në Departamentin e Inxhinierive. GVJ nga DVV dhe takimet me drejtuesit dhe stafin konstaton se pedagogët e rankuar me vlerësime më të mira në pyetësorët e studentëve, rezultateve të kërkimit shkencor e metodave inovative të mësimdhënies promovohen para gjithë stafit akademik për t'i ndjekur si shembuj pozitiv.
Konkluzione ✓ GVJ vlerëson se AU ka struktura të caktuara si Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, të cilat janë përgjegjëse për mësimdhënien dhe sigurimin e cilësisë së brendshme, zhvillojnë mekanizma të monitorimit, vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	

- ✓ Këto njësi kanë miratuar pyetësorët/procedura të posaçme për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe mbi bazën e tyre përgatiten raportet për cilësinë e mësimdhënies për çdo program studimi në AU. Rezultatet e anketimeve të kryera janë publike dhe të aksesueshme online, ku studentët dhe stafi mund të njihen me to.
- ✓ Në AU shembujt e praktikave më të mira, që evidentohen nga rezultatet e anketimeve si dhe nga raportet e aktivitetit mësimor, marrin vlerësime dhe promovohen para gjithë stafit akademik.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Konstatohet se AU që në fillimet e veprimtarisë së saj ka hartuar strategji dhe krijuar Njësi për Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, të cilën e vlerësojmë si një praktikë të mirë. Në objektivat strategjike të sigurimit të cilësisë citojmë: ✓ Rritja e vazhdueshme e cilësisë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor si dhe implementimi i metodologjive bashkëkohore; ✓ Zhvillimi i vazhdueshëm i programeve të studimit në përputhje me tregun e punës, nevojat social – ekonomike të vendit, si dhe strategjinë për zhvillim të institucionit. Për përçimin dhe zbatimin e politikave të saj, për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, AU ka në strukturë 2 Zyra: të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (ZSBC) dhe të Zhvillimit të Kurrikulave (ZZHK), që koordinojnë e bashkëpunojnë me njësinë kryesore FSHAE dhe të 3 tre njësitë bazë të saj, pra edhe të DI, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. [Evidencë: 6.4 Strategjia për Sigurimit e Cilësisë 2018-2021].
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Sipas DVV, GVJ evidenton se AU në përputhje me politikat e saj ka ngritur 2 njësi: Komisioni për vlerësimin institucional dhe Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (ZSBC). ZSBC harton standardet institucionale të cilësisë bazuar në Kodin e Cilësisë në Republikën e Shqipërisë dhe Udhëzimet e ASCAL për proceset vlerësuese, si Manuali “Procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit”. Komisioni për vlerësimin institucional ka në përbërje të tij dhe 1 përfaqësues të studentëve.


	Njësia e Sigurimit të Cilësisë bashkëpunon me grupet e sigurimit të cilësisë në nivel departamenti, në të cilin është anëtar dhe një përfaqësues i studentëve. Këto grupe të sigurimit të cilësisë në nivel njësie bazë janë ngritur me Vendim Senati Akademik nr. 157/3 datë 08.09.2016, dhe çdo vit përditësohen anëtarët e tyre. Departamenti i Inxhinierive në funksion të sigurimit të cilësisë, në procesin e vlerësimit të brendshëm përfshin studentët dhe bashkëpunëtorët. Sipas DVV, GVJ evidenton se NjSBC bashkëpunon edhe me ekspertë të jashtëm, të angazhuar pranë tij: 1 konsulent juridik dhe 1 konsulent për zhvillimin dhe përmirësimin e kurrikulave. [Evidencë: 1.2 Statuti i AU, Kreun VII Sigurimi i cilësisë, nenet 65-67]; [Evidencë: 6.1 Vendim Rektorati i AU për krijimin e ZSBC, 23.07.2010]; [Evidencë: 6.2 Vendim SA i AU për krijimin e Komisionit për vlerësimin institucional, me nr. 4, datë 22.12.2016]; [Evidencë: 1.4.a Plani strategjik i zhvillimit institucional 2017-2022, Kreu IV Sigurimi i brendshëm i cilësisë]; [Evidencë: 6.3.b Përfaq e DI për sigurimin e cilësisë 2021-2022]; [Evidencë: 6.3.c Përfaq e DI për sigurimin e cilësisë 2022-2023]; [Evidencë: 6.3.d Përfaq e DI për sigurimin e cilësisë 2023-2024]; [Evidencë: 6.5.a Vendim Rektor dhe BA i AU për konsulent juridik]; [Evidencë: 6.5.b Vendim Rektor dhe BA i AU konsulent për kurrikulat]; [Evidencë: H.2 Shkresë / FSHAE /DI për ngritjen e GVB].
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	GVJ evidenton se sipas dokumentave të DVV, në 2023, AU, ishte objekt i vlerësimit të jashtëm institucional (për herë të tretë - Vendim i BA nr. 55, datë 26.05.2023 "Për akreditimin institucional të IAL, Universiteti Privat "Albanian University", me kohëzgjatjen prej 4 (katër) vite deri me 25.05.2027), me qëllim vlerësimin e shkallës së përmbushjes së Standarteve Shqiptare Shtetërore të Cilësisë, i cili përfundoi me vlerësimin përmbushur plotësisht 3 standarte dhe 1 përmbushur kryesisht, për rrjedhojë BA dha akreditim katërvjeçar, në dallim nga akreditimi i dytë trevjeçar. Për kryerjen me sukses të këtij procesi, si dhe të akreditimeve të programeve të studimit një rol të rëndësishëm pati bashkëpunimi me specialistët e ASCAL. Konstatojmë se edhe Njësia e Sigurimit të Cilësisë kryen trajnime të regullta vjetore mbi proceset e akreditimeve.

	Këtij qëllimi i shërben si instrument edhe sondazhi kombëtar i studentëve. [Evidencë: Vendimi i BA nr. 55, datë 26.05.2023 për akred e AU]; [Evidencë: 3.1.a NjSBC - Trajtime stafi për v. 2021-2022]; [Evidencë: 3.1.b NjSBC - Trajtime stafi për v. 2022-2023]; [Evidencë: 3.1.c NjSBC - Trajtime stafi për v. 2023-2024].			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira ne programin e studimit.	GVJ sipas DVV e RVB, konstaton se NjSBC, në fund të çdo semestri dhe në fund të çdo viti, organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për çdo program studimi NJSBC-ja raporton në mënyrë periodike dhe informon drejtuesit e njësive bazë dhe kryesore dhe përmes tyre të gjithë stafin e AU mbi rezultatet e monitorimeve dhe vlerësimeve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performances së institucionit, njësive të tij bazë dhe individëve në të ardhmen. Këto raporte krahasohen me standardet e cilësisë të parashikuara në Kodin e Cilesisë së Arsimit të Lartë. GVJ mbi bazën e DVV evidenton se procesi mësimdhënies dhe kërkimit shkencor është objekt analize në departament, fakultet dhe në SA të AU, e cila bëhet në përfundim të çdo viti akademik.			
Konkluzione ✓ <i>GVJ vlerëson se AU ka struktura të caktuara si Komisioni për vlerësimin institucional dhe Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (ZSBC), e ngritur në Rektoratin e AU dhe Njësitë e Sigurimit të Cilësisë (NJSC) në çdo njësi kryesore të AU , që veprimtarinë e tyre e mbështetin në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe standardet e cilësisë të parashikuara në Manualin “Procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit”.</i> ✓ <i>Këto njësi kanë hartuar standardet institucionale të cilësisë bazuar në Kodin e proceseve vlerësuese. Zbatimi i standardeve të cilësisë nënkupton zbatimin e standardeve akademike, kërkimore, menaxhuese, infrastrukturore, etj., me qëllim që të arrihen nivele maksimale në procesin mësimor dhe kërkimor-shkencor.</i> ✓ <i>Departamenti i Inxhinierive që mbulon programin e studimit Bsc. në Inxhinieri Mekatronike, operon në koherencë të plotë me procedurat e AU, në funksion të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, duke respektuar procedurat që janë përcaktuar nga strukturat, në të cilat garantohet dhe përfshirja e stafit dhe studentëve.</i> ✓ <i>AU në zbatim të detyrimit ligjor për çdo IAL (për sigurimin e jashtëm cilësisë) ka kryer Akreditimin Institucional si dhe Akreditimin e Programeve të Studimit, proces i cili po kryhet edhe për programin e studimit Bsc.në Inxhinieri Mekatronike.</i>				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	GVJ konstaton se për rishikimin e programeve të studimit bazuar në Rregulloren për mbarëvajtjen e kurrikulave dhe procesit mësimor në AU (neni 9) janë përcaktuar procedurat dhe dokumentacioni shoqërues, që kalon në disa hallka: hartimi i draftit nga grupi nismëtar i njësive bazë; diskutimi i ndryshimeve në departament dhe përcjellja tek Dekani, i cili i dërgon propozimin Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave për vlerësim teknik (për përputhshmërinë e programit të studimit me misionin, vizionin, planin strategjik të zhvillimit dhe në analizën e kapaciteteve infrastrukturore e akademike), si edhe NjSBC për vlerësim të përmbushjes së standardeve shtetërore të cilësisë; këto i dërgohen Komisionit për Kurrikulat dhe Mësimin, i cili del me vendim dhe ja përcjell SA për miratim. Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin është organ kolegjal vendimmarrës dhe këshillimor dhe ka në përbërje të tij 5 (pesë) anëtarë, ku 4 (katër) anëtarët e këtij komisioni, janë staf akademik dhe anëtari i pestë është student dhe zgjidhet nga Këshilli Studentor. Mbi bazën e DVV, GVJ konstaton se Njësia Bazë me grupet e sigurimit të cilësisë harton raportin vjetor duke vlerësuar në mënyrë periodike të gjitha programet që ofron. Ky raport i përcillet Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, si dhe Njësive Kryesore përkatëse, e cila këtë informacion e përfshin në raportin vjetor të saj. Në këtë mënyrë informacioni përcillet deri në Rektorat e SA, si dhe paraqitet në raportin e vlerësimit të brendshëm në rastet kur programi kalon vlerësimin periodik. Në raportet vjetore përfshihen edhe të dhëna mbi masat e marra nga plan veprimi i vitit të kaluar dhe planin e veprimit për vitin e ardhshëm akademik. [Evidencë: 6.6 Rregullore për mbarëvajtjen e kurrikulave dhe procesit mësimor në AU (Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave)]; [Evidencë: 2.6 Procedurë e rishikimit të kurrikulave të progr Bsc.].
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e	GVJ nga takimet me drejtuesit dhe stafin, si dhe DVV, konstaton se për të garantuar cilësinë në mësimdhënie dhe përmirësimin e vazhdueshëm të saj, personeli akademik i DI i nënshtrohet vlerësimit periodik duke filluar nga departamenti. GVJ evidentoi se ZSBC organizon në mënyrë periodike pyetësorë adresuar studentëve për vlerësimin e pedagogut, ku raporti i rezultateve të pyetësorëve si dhe rekomandimet e përpiluara prej NjSBC-së ju bëhen publike dhe ju përcillen njësive kryesore të cilat



arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	realizojnë më tej një diskutim të gjerë në çdo departament me stafin akademik. Nga takimet me stafin e studentët, GVJ konstaton se pavarësisht përpjekjeve pozitive, transparencë dhe gjithë përfshirja kërkojnë një angazhim të drejtpërdrejtë në informimin e studenteve dhe pedagogëve, debat të hapur dhe diskutim me ata. Kështu në v. 2023-2024 nga FSHAE kanë marrë pjesë në pyetësor rreth 35% e studentëve, nga DI rreth 25% e tyre, ndërsa për programin Bsc. në Inxhinieri Mekatronike, sipas viteve janë 63% viti parë, 69% i dyti dhe 50% i treti. [Evidencë: 6.7 Vlerësime specifike për program Inxhinieri Mekatronike]
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	GVJ bazuar në DVV dhe takimet me drejtuesit evidenton se vlerësimi i programit bëhet në analizën mësimore në fund viti akademik në nivel stafi, departamenti DI dhe fakulteti FSHAE. GVJ nga takimet dhe DVV konstaton se në çdo fillim viti akademik në DI nën drejtimin e Përgjegjësit kontrollohen dhe vlerësohet përmbajtja e syllabuseve, të diskutuara në grupin mësimor, e që në fund aprovoen nga titullari i lëndës. Pjesë e metodave të vlerësimit janë edhe vlerësimet e drejtpërdrejta nëpërmjet nxjerrjes së statistikave të kalueshmërisë së studentëve, notës mesatare, rishikimit të vazhdueshëm të syllabuseve të lëndëve, si dhe rishikimit të kurrikulave, në përputhje me aktet ligjore në fuqi, kërkesat e tregut të punës, apo edhe kërkesave të personelit akademik. Metodat e drejtpërdrejta, bazuar kjo edhe në rregulloren e njësive së SBC, neni 8, (Evidencë nr.6.10, cituar në RVB), janë përkatësisht: - Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (psh provimi i shtetit për profesionet e rregulluara); - Dëgjime në auditor; - Vlerësimi me nota/pikë - Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module; - Vlerësimi i detyrave të studentëve (detyra kursi, për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet); - Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; [Evidencë: 1.1.a Raporti vjetor i DI për v.a. 2021-2022]; [Evidencë: 1.1.b Raporti vjetor i DI për v.a. 2022-2023]; [Evidencë: 1.1.c Raporti vjetor i DI për v.a. 2023-2024, semestri i parë].
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të	Sipas DVV, GVJ evidenton se NJSBC përpilon raportin e analizës së pyetësorëve i cili ka për qëllim matjen dhe vlerësimin e cilësisë




realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	së mësimdhënies, duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, si dhe praktikat më të mira. Të dhënat e pasqyruara në këtë raport shërbejnë si një instrument i rëndësishëm për njësitë kryesore/bazë për përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë akademike dhe programeve mësimore aty ku shihet e nevojshme. Sipas DVV, evidentojmë se AU përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista me studentët aktualë, me ato të diplomuar (alumni), me personelin akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe disponon të dhëna, për punësimin e studentëve të vet, me të cilët mban kontakte të vazhdueshme.
---	--

Konkluzione


- ✓ *GVJ vlerëson se programet e studimit në AU bazuar në ligjin 80/2015 kalojnë procedura të caktuara për hapje/riorganizim, duke filluar nga grupi i sigurimit të cilësisë, në departament DI, fakultet FSHAE dhe rektorat.*
- ✓ *AU ka struktura të caktuara si Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave e Rektoratit, që ka për detyrë të verifikojë përputhshmërinë e programit të studimit (të rishikuar/hapur) me standardet e cilësisë, si dhe si edhe hartimin e një raport teknik në lidhje me të, për t'a kaluar për miratim nga Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin në Senatit Akademik.*
- ✓ *GVJ vlerëson se Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), në AU dhe Njësia e Sigurimit të Cilësisë (NJSC) në FSHAE, përpilojnë raportin e analizës së pyetësorëve, me qëllim matjen dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, si dhe praktikat më të mira.*
- ✓ *Departamenti i Inxhinierive që mbulon programin e studimit Bsc. në Inxhinieri Mekatronike, përdor disa metoda të drejtpërdrejta, duke konsistuar në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit si dhe vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve.*
- ✓ *AU përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si fokus grupe, sondazhe e intervista me studentët aktualë, me ato të diplomuar (alumni), me personelin akademik, ndihmës akademik e administrativ.*
- ✓ *GVJ evidenton si praktikë të mirë krijimin nga AU nëpërmjet projektin GRADUA, të një databazë të rëndësishme të studentëve dhe kompanive, ku studentët regjistrohen dhe publikojnë CV në këtë databazë, ndërsa kompanitë e ndryshme në bazë të kriterëve të tyre përzgjedhin drejtpërdrejtë studentët e regjistruar në sistem.*

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Sipas dokumentave të VV, GVJ evidenton se në nenin 25 e 67 të Statutit të AU, në nenin 3 të Rregullores për organizimin dhe funksionimin e NjSBC dhe në Strategjinë për zhvillimin institucional të AU 2023-2028, parashikohet përfshirja e stafit akademik, studentëve, personelit administrativ si edhe e bashkëpunëtorëve të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Për vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit ngrihet GVB, ku merr pjesë edhe një përfaqësues nga studentët, si dhe një përfaqësues ekspert i jashtëm. [Evidencë: 1.4.c Strategji për zhvill instituc. të AU 2023-2028]; [Evidencë: 1.4.a Plani strategjik i zhvill instit. të AU 2017-2022]; [Evidencë: 1.4.b Plani i masave/Rektorati të AU për 2021-2022].
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	GVJ nga DVV e takimet konstaton se AU në nenin 12 “Grupi i sigurimit të cilësisë në nivel departamenti” të Rregullores mbi organizimin dhe funksionimin e DI në AU, si dhe në Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e NjSBC përcakton organizimin strukturor me detyrat përkatëse për sigurimin e cilësisë për program studimi. Studentët me pjesëmarrjen e tyre në njësitë e sigurimit të cilësisë dhe në GVB japin një kontribut të vlefshëm në këtë drejtim. Evidencë: 6.10 Rregullore për organizimin/funksionimin e NjSBC] [Evidencë: 6.1 Vendim Rektorati i AU për krijimin e ZSBC/2010]; [Evidencë: 6.2 Vendim SA i AU për krijimin e Komisionit për vlerësimin institucional, me nr. 4/2016].
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Konstatohet se, sipas neneve 6-8 të Rregullores për organizimin dhe funksionimin e NjSBC për vlerësimin e sigurimit të cilësisë në rang institucional, janë ngritur dhe funksionojnë GVB në përbërje të të cilëve janë personel akademik i FSHAE dhe studentë. Njësia bazë, personeli akademik dhe administrativ, si dhe studentët, luajnë një rol të rëndësishëm bashkëpunues me strukturat e sigurimit të cilësisë në nivel institucional. Për vlerësimin e sigurimit të cilësisë në çdo program janë ngritur GVB, të cilët në përbërje të tyre kanë dhe 1 student. [Evidencë: 6.10 Rregullore organizimi/funksionimi i NjSBC]. [Evidencë: H.2 Shkresë Dekan / Drejtues i DI për ngritjen e GVB].

Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	GVJ në bazë të DVV si dhe takimeve me staf e studentë konstaton se vlerësimi i cilësisë së programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Mekatronike, realizohet nga studentët përmes fokus grupeve dhe pyetësorëve, duke ruajtur anonimin e tyre. Institucioni respekton të drejtat themelore të çdo pale të përfshirë në jetën universitare, si dhe respekton Kodin e Etikës të “Albanian University”. GVJ eidenton se (si na u pohua edhe në takimet në institucion), në FSHAE nuk ka asnjë praktikë ankimi nga ana e studentëve apo stafit akademik dhe administrativ në shërbim të tyre për diskriminim dhe pabarazi.
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	GVJ eidenton se nuk ekziston një praktikë periodike vjetore e marrjes së feedback-ut nga ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit, duke përfshirë biznesmenë, institucione publike dhe private, ku të diplomuarit e një programi studimi janë punësuar. Por, GVJ eidenton se në AU sipas DVV, NJSBC bashkëpunon edhe me ekspertë të jashtëm, të angazhuar pranë tij: 1 konsulent juridik dhe 1 konsulent për zhvillimin dhe përmirësimin e kurrikulave. Konstatohet se, zhvillimi i praktikave mësimore pranë kompanive partnere shërben për vlerësimin cilësor të programit të studimit, i cili është i dyanshëm, nga kompanitë të cilat vlerësojnë aftësitë personale të studentëve, por edhe përputhshmëria e formimit të programit të studimit në lidhje me kërkesat e tregut të punës. Një praktikë e mirë për tërheqjen e mendimit praktik dhe nevojat e tregut është përmes shoqatës Alumni të DI.
Konkluzione ✓ GVJ vlerëson se në dokumentet (Statutin e AU, Rregulloren e për organizimin dhe funksionimin e NJSBC dhe në Planin Strategjik për zhvillimin institucional të AU 2023-2028) parashikohet dhe garantohet përfshirja e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. ✓ AU në këto dokumente përcakton qartë përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në SBC së programit të studimit. ✓ GVJ vlerëson se studentët janë anëtarë jo vetëm të NJSBC në AU dhe NJSC në FSHAE, por edhe të Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin për monitorimin në vijimësi të programit të studimit Bsc. në Inxhinieri Mekatronike, dhe GVB për vlerësimin e sigurimit të cilësisë së këtij programi. ✓ GVJ eidenton se nuk ekziston një praktikë periodike vjetore e marrjes së feedback-ut nga ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit. Por NJSBC bashkëpunon edhe me ekspertë të jashtëm, të angazhuar pranë tij: 1 konsulent juridik dhe 1 konsulent për zhvillimin dhe përmirësimin e kurrikulave. ✓ GVJ eidenton si praktikë të mirë lidhur me marrjen e mendimit dhe ekspertizës së jashtme ka qenë dhe vijon të jetë ajo përmes shoqatës ALUMNI të AU.	



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	GVJ në bazë të DVV, konstaton se AU i bën transparente dhe publike në Statutin e rregulloret, si dhe çdo dokument a procedurë të nevojshme në lidhje me programin e studimit Bsc. në Inxhinieri Mekanike, për studentët dhe të gjithë të interesuarit, në kuadër të sistemit të SBC. https://albanianuniversity.edu.al/sq/ https://albanianuniversity.edu.al/sq/strategjia-e-zhvillimit-institucional/
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Konstatohet se, AU ka publikuar online në web-in zyrtar Raportin e analizës së pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies të çdo programi studimi, në zbatim të VKM nr. 824, datë 24.12.2021 “Për Miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, Raportin vjetor institucional, Raport vlerësimi të ZSBC, Raport vetëvlerësimi për akreditimin institucional. Informacioni i publikuar respekton lirinë dhe etikën akademike si dhe Ligjin nr. 9887/2008, ndryshuar me ligjin nr. 48/2012 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. https://albanianuniversity.edu.al/sq/sigurimi-i-brendshem-i-cilesise/
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Sipas RVB e DVV, GVJ evidenton rezultatet e pyetësorit të kryer rregullisht çdo semestër mbi cilësinë në mësimdhënie nga Zyra e SBC, i përcillen Rektorit së bashku me një analizë statistikore mbi indikatorët. Këto analiza u përcillen njëjësive kryesore dhe atyre bazë për të zhvilluar analiza të mëtejshme e për të vijuar punën mbi përmirësimin e cilësisë. Raporti vjetor i departamentit DI përfshin edhe të dhëna mbi masat e marra nga plan veprimi i vitit të kaluar dhe planin e veprimit për vitin e ardhshëm akademik.
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të	GVJ nga takimet me drejtuesit dhe stafin, e në bazë të DVV, evidenton se një nga funksionet kryesore të ZSBC sipas neneve 6-8 të Rregullores për organizimin dhe funksionimin e NjSBC për vlerësimin e sigurimit të cilësisë së programit të studimit (citim): në


monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	<i>AU siguri i cilësisë së programit të studimit realizohet nga NjSBC në bashkëpunim me NjSC të ngritura në nivel departamenti, si dhe me Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave.</i>
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	GVJ konstaton se AU me qëllim ngritjen e kulturës së cilësisë organizon aktivitete dhe seminare informuese me studentët, për ndërgjegjësimin e tyre mbi rëndësinë e pjesëmarrjes në procesin e përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit dhe shërbimeve administrative që ata marrin në institucion GVJ eidenton se në mënyrë periodike AU e realizon ngritjen e kulturës së cilësisë nëpërmjet: takimeve të drejtpërdrejta me studentët në auditore; publikimit të njoftimit në rrjetet promovuese online të universitetit; publikimit të njoftimeve në llogaritë personale. [Evidencë: 3.1.a NjSBC - Trajnime stafi për v. 2021-2022]; [Evidencë: 3.1.b NjSBC - Trajnime stafi për v. 2022-2023]; [Evidencë: 3.1.c NjSBC - Trajnime stafi për v. 2023-2024].

Konkluzione

- ✓ *GVJ vlerëson se AU i bën transparente dhe publike strategjinë, organizimin dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit Bsc. në Inxhinieri Mekanike, , nëpërmjet postimit në faqen zyrtare elektronike të tij.*
- ✓ *GVJ vlerëson se mbi bazën e indikatorëve që dalin si perceprime të performancës nga studentët, hartohen analiza për të evidentuar pikat e forta dhe problematikat specifike në programin e studimit Bsc. në Inxhinieri Mekanike, për vlerësimin e sigurimit të cilësisë së këtij programi.*
- ✓ *GVJ eidenton se AU me qëllim ngritjen e kulturës së cilësisë organizon aktivitete dhe seminareve informuese me studentët, kryesisht në trajtën e fushatave informuese me qëllim ndërgjegjësimin e studentëve mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në procesin e përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit dhe shërbimeve administrative që ata marrin në institucion.*
- ✓ *GVJ eidenton si praktikë të mirë Njësitë e sigurimit të cilësisë në rang departamenti që kanë si funksion kryesor menaxhim më të mirë të procesit të hapjes dhe riorganizimit të programeve të studimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të tyre.*

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri Mekatronike”, të ofruar nga “Albanian University.”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Mekatronike” është një program studimi që ka treguar qëndrueshmëri në tërësinë e programeve që ofrohen nga Departamenti i Inxhinierive në Universitetin Albanian University, dhe që realizohet në përputhje me nevojat e tregut të punës.
2. Fakulteti/Departamenti kanë informacion të plotë, të nevojshëm për programin e studimit. Dosja e programit të studimit ka dokumentacion të plotë, që tregon punën cilësore të strukturave/ organeve përkatëse të AU.
3. Departamenti i Inxhinierive ka bashkëpunime efektive në kuadër të praktikave mësimore të programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Mekatronike”, duke mundësuar realizimin e plotë të tyre për të gjithë studentët e këtij programi.
4. Konferenca Studentore “Inovacion në Inxhinieri, Shkencë dhe Teknologji”, që Departamenti i Inxhinierive organizon prej vitesh ka treguar sukses edhe për studentët e programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Mekatronike” të cilët kanë marrë pjesë me punimet e tyre të shoqëruara me prototipe.
5. Departamenti është i angazhuar në zgjerimin e bashkëpunimeve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar me qëllim përfshirjen në projekte kërkimore – shkencore dhe mobiliteti në të gjitha fushat inxhinierike që mbulon.
6. Departamenti i Inxhinierive është i angazhuar në kërkim shkencor në drejtim të përdorimit të Teknologjive të Informacionit në mësimdhënie, me qëllim përmirësimin e këtij procesi në kwtë program studimi.

Pika të dobta:

- 1) GVJ konstaton se **nuk janë plotësuar rekomandimet a) dhe d)**, dhënë nga Bordi i Akreditimit në *Vendimin e tij VBA nr. 38, datë 12.03.2021*. GVJ mendon se DUHEN rivendosur ato edhe në këtë vlerësim. Këto rekomandime kanë në fokus raportin orë në auditor/orë jashtë auditorit dhe mbingarkesën e stafit akademik.
- 2) Nga Raportet analitike të zhvillimit të praktikave profesionale rezulton se disa prej marrëveshjeve nuk kanë afatet e vlefshmërisë së tyre. Këto marrëveshje duhen rishikuar, ose të rivendosen afate të reja. [Standardi I.2, Kriteri 4]
- 3) Sipas Rregullores së AU, personeli ndihmës akademik me karakter mësimor (laborantët, asistentët) shërbejnë si asistentë pedagogë për praktikat mësimore. Në fakt personeli ndihmës akademik, i deklaruar si laborantë janë të ngarkuar edhe në mësimdhënie. [Standardi 2.2, kriteri 2]
- 4) Detyra e Koordinatorit të programit të studimit nuk është përcaktuar në asnjë akt ligjor të AU, si Statut, rregullore. [Standardi II.2 kriteri 3]



- 5) Ngarkesa e lëndëve në Matematikë (5 lëndë), Fizikë (2 lëndë) dhe Kimi (1 lëndë) që së bashku kanë 36 kredite, është e madhe për këtë program studimi, që edhe në thelb harmonizon 3 fusha inxhinierike. [Standardi II.3, Kriteri 5]
- 6) Në disa lëndë (psh Matematikë) janë shtuar njohuritë për softet inxhinierike të fushës së programit të studimit, për të rritur aftësitë e studentëve në drejtim të dixhitalizimit të njohurive, por nuk janë reflektuar në syllabuset përkatëse. [Standardi II.3, Kriteri 5]


Rekomandime/Sugjerime

1. *GVJ rivendos rekomandimet e dhëna nga Bordi i Akreditimit në Vendimin e tij VBA nr. 38, datë 12.03.2021, sepse nuk janë plotësuar nga Institucioni:*
 - a) *Institucioni, të marrë masa për uljen e ngarkesës mësimore në numër orësh dhe lëndësh të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi.*
 - b) *Të rrisë numrin e orëve në auditor për leksion dhe seminare, për këtë program studim, duke respektuar kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi.*
2. *Të përcaktohet në dokumenta rregullatore (psh Rregullore), detyra e Koordinatorit të programit të studimit dhe kualifikimi minimal që duhet të ketë kjo detyrë (tituj/gradë/apo kualifikim Msc/MP).*
3. *Grupi i Rishikimit të Kurrikulës në AU të rishikojë ngarkesën e lëndëve Matematikë, Fizikë dhe Kimi, që së bashku kanë 36 kredite. GVJ mendon se duhen reduktuar/ sistemuar njohuritë që jepen në këto 8 lëndë, duke futur lëndë të profesionit (psh të Robotikës, Automatikës, si fusha që përafrohen me këtë program studimi). Mund të rishikohet edhe heqja e lëndës së Kimisë sepse mjaftojnë njohuritë e marra në shkollë të mesme.*
4. *Të shtohen edhe njohuritë për softet inxhinierike të fushës së programit të studimit, për të rritur aftësitë e studentëve në drejtim të dixhitalizimit të njohurive (aty ku janë tashmë të implementuara të reflektohen në syllabuset përkatëse).*
5. *Marrëveshjet e bashkëpunimit për praktikat mësimore duhen rishikuar në afatet e vlefshmërisë së tyre, ose të rivendosen afate të reja.*

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor in "Mechatronic Engineering." provided by "Albanian University."

Strengths and affirmations

- 1) The Bachelor's degree program in "Mechatronic Engineering" is a study program that has shown sustainability in the entirety of the programs offered by the Department of Engineering at the Albanian University, and that is implemented in accordance with the needs of the labor market;
- 2) The Faculty/Department has complete information, necessary for the study program. The study program file has complete documentation, which shows the qualitative work of the relevant structures/bodies of the AU;




- 3) The Department of Engineering has effective collaborations within the framework of the teaching practices of the Bachelor's degree program in "Mechatronic Engineering", which enables their full implementation, for all students of this program.
- 4) The Student Conference "Innovation in Engineering, Science and Technology", which the Department of Engineering has been organizing for years, has also shown success for students of the Bachelor's degree program in "Mechatronic Engineering", who have participated with their papers, accompanied by prototypes.
- 5) The Department is committed to expanding collaborations at the national and international level, with the aim of being involved in research and scientific projects and mobility, in all engineering fields it covers.
- 6) The Department of Engineering is committed to scientific research, in terms of the use of Information Technologies in teaching, with the aim of improving this process in this study program.

Weaknesses

- 1) GVJ finds that recommendations a) and d) given by the Accreditation Board in its Decision no. VBA No. 38, dated 12.03.2021, have not been met. GVJ believes that they **MUST** be reinstated in this assessment as well. These recommendations focus on the ratio of hours in the classroom/hours outside the classroom and the overload of academic staff.
- 2) From the analytical reports on the development of professional practices, it results that some of the agreements do not have their validity periods. These agreements should be reviewed, or new periods should be reinstated. [Standard I.2, Criterion 4]
- 3) According to the AU Regulation, academic support staff with a teaching character (Laboratory assistants, assistants) serve as teaching assistants for teaching practices. In fact, academic support staff, declared as laboratory assistants, are also responsible for teaching some subjects. [Standard 2.2, criterion 2]
- 4) The duty of the coordinator of the study program is not defined in any legal act of the AU, such as the Statute, regulations. [Standard II.2 criterion 3]
- 5) The load of subjects in Mathematics (5 subjects), Physics (2 subjects), and Chemistry (1 subject) which together have 36 credits, is large for this study program, which essentially harmonizes 3 engineering fields. [Standard II.3, Criterion 5]
- 6) In some subjects (e.g., Mathematics) knowledge of engineering software of the field of the study program has been added, to increase students' skills in terms of digitalization of knowledge, but they have not been reflected in the relevant syllabi. [Standard II.3, Criterion 5];

Recommendations/Suggestions

- 1) GVJ resets the recommendations given by the Accreditation Board in its Decision VBA No. 38, dated 12.03.2021, because these **have not been fulfilled** by the Institution:



- a. The Institution, should take measures to reduce the teaching load in number of hours and subjects, of the academic staff engaged in this study program.
 - b. The Institution should increase the number of hours in the auditorium for lectures and seminars, for this study program, respecting the requirements of the applicable legal framework.
- 2) To define in regulatory documents (e.g. Regulations), the duty of the Coordinator of the study program and the minimum qualification that this duty must have (titles/degree/or qualification Msc/MP)
 - 3) The Curriculum Review Group at AU to review the load of the subjects Mathematics, Physics and Chemistry, which together have 36 credits. GVJ believes that the knowledge given in these 8 subjects should be reduced/systematized, by introducing professional subjects (e.g. Robotics, Automation, as fields that are aligned with this study program). The removal of the Chemistry subject could also be reviewed because the knowledge obtained in high school is sufficient.
 - 4) Knowledge of engineering software in the field of the study program should also be added, to increase students' skills in terms of digitalization of knowledge (where they are already implemented, they should be reflected in the relevant syllabi).
 - 5) Cooperation agreements for teaching practices should be reviewed within their validity periods, or new deadlines should be established.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E				X

PROGRAMIT TË STUDIMIT				
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

